



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 22 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave

Simon Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

PËRMBAJTJA

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	4
II.	PARASHTRIMET E PALËVE	9
A.	Zbatueshmëria e të drejtës zakonore ndërkombëtare	9
1.	Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin	9
2.	Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në	10
3.	Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në.....	12
4.	Kundërpërgjigjja Shtesë e ZPS-së lidhur me DZN-në	13
5.	Parashtrimet e Veselit lidhur me Kundërpërgjigjen Shtesë të ZPS-së lidhur me DZN-në	14
B.	Raporti i Këshillit të Evropës.....	14
1.	Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin	14
2.	Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim).....	16
3.	Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin	16
4.	Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në	17
5.	Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në	19
6.	Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në.....	20
C.	Ndalimi arbitrar	22
1.	Mocioni i Veselit lidhur Juridiksionin.....	22
2.	Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në	23
3.	Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në.....	23
D.	Zhdukja me forcë e personave	24
1.	Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin	24
2.	Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në	24
3.	Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në.....	25
E.	Ndërmarrja kriminale e përbashkët	26
1.	Mocionet e Mbrojtjes për Juridiksionin lidhur me NKP-në	26
2.	Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në.....	30

3.	Kundërpërgjegjja e Mbrojtjes ndaj Përgjegjës së ZPS-së lidhur me NKP-në	33
F.	Përgjegjësia eprore	36
1.	Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin	36
2.	Përgjegjja e ZPS-së lidhur me DZN-në	36
3.	Kundërpërgjegjja e Veselit lidhur me DZN-në.....	37
III.	DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE	37
A.	Zbatueshmëria e të drejtës zakonore ndërkombëtare	37
B.	Raporti i Këshillit të Evropës.....	39
C.	Ndalimi arbitrar	39
D.	Zhdukja me forcë e personave	40
E.	Ndërmarrja kriminale e përbashkët	40
F.	Përgjegjësia eprore	40
IV.	DISKUTIM	40
A.	Zbatueshmëria e të drejtës zakonore ndërkombëtare	40
1.	Burimet ligjore të zbatueshme në DHS	40
2.	A e shkel neni 12 i Ligjit parimin e mosprapaveprueshmërisë	41
3.	A ishte e drejta zakonore ndërkombëtare e disponueshme dhe e parashikueshme	47
4.	Zbatueshmëria dhe fushëveprimi i parimit <i>lex mitior</i>	48
B.	Raporti i Këshillit të Evropës.....	49
1.	Lidhja me Raportin e Këshillit të Evropës	49
2.	Fushëveprimi i Raportit të Këshillit të Evropës.....	56
3.	Përfundim.....	63
C.	Juridiksioni lëndor	65
1.	Ndalimi arbitrar si krim lufte në konflikte të armatosura jondërkombëtare	65
2.	Zhdukja me forcë e personave si krim kundër njerëzimit	77
D.	FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE	83

1.	Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët.....	83
2.	Përgjegjësia e prore	103
V.	VENDIM.....	105

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 22, 33(1) dhe 162(1) të Kushtetutës së Kosovës (“Kushtetuta”), neneve 1(2), 3(2), 6-9, 12, 13(1)(i), 14(1)(c), 16, 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 97 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën (“Vendimi i Konfirmimit” dhe “Aktakuza”) kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) (së bashku “të akuzuarit”).²

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetari, *Vendim mbi Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, konfidencial. Një version i redaktuar publik u protokollua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale. Më 4 nëntor 2020 u parashtrua një version i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar, F00045/A01, F00045/A02, F00045/A03.

2. Më 4 dhe 5 nëntor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,³ të akuzuarit u arrestuan⁴ dhe transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁵
3. Më 10 shkurt 2021, Mbrojtja e z. Selimi (“Mbrojtja e Selimit”) dorëzoi një mocion paraprak me anë të së cilit kundërshtonte juridiksionin e DHS-së në lidhje me Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët (“NKP”) (“Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP)”)⁶.
4. Më 12 mars 2021, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi një mocion paraprak me anë të së cilit kundërshtonte juridiksionin e DHS-së në lidhje me, ndër të tjera, NKP-në dhe akuzat e ngritura kundër z. Thaçi me arsyetimin se këto akuza dilnin jashtë Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi “Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore

³ KSC-BC-2020-06, F00027, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versione të korigjuara të shtojcave 7 dhe 8 u dorëzuan më 28 tetor 2020, F00027/A07/COR dhe F00027/A08/COR. Versione të redaktuara publike të Shtojcave (F00027/A01/RED, F00027/A02/RED, F00027/A03/RED, F00027/A04/RED, F00027/A05/RED, F00027/A06/RED, F00027/A07/COR/RED, F00027/A08/COR/RED) dhe të vendimit (F00027/RED) u protokolluan përkatësisht më 5 nëntor 2020 dhe 26 nëntor 2020.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Jakup Krasniqit, sipas Rregullës 55(4)*, 4 nëntor 2020, publik; F00049, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Rexhep Selimit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00050, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00051, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Hashim Thaçit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Jakup Krasniqit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 4 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publik; F00053, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe Caktimi i Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00054, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Kadri Veselit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe Caktimi i Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00055, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Rexhep Selimit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00198, Mbrojtja e Selimit, *Kundërshtim i Mbrojtjes së Selimit lidhur me Juridiksionin – Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët*, 10 shkurt 2021, publik.

në Kosovë, Dok. 12462, 7 janar 2011 (“Raporti i Këshillit të Evropës” ose “Raporti”) (“Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin”).⁷

5. Më 15 mars 2021, Mbrojtja e Selimit dorëzoi një mocion paraprak kundër juridiksionit të DHS-së në lidhje me strukturën dhe përbërjen e personelit të punësuar (“Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim)”), në të cilin paraqet më tej argumente të ndryshme në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, që parashtrohen në Mocionin e Thaçit lidhur me Juridiksionin.⁸

6. Më 15 mars 2021, Mbrojtja e z. Krasniqi (“Mbrojtja e Krasniqit”) dorëzoi një mocion paraprak me anë të të cilit kundërshton juridiksionin e DHS-së në lidhje me NKP-në dhe disa nga krimet e paraqitura në akuza, me arsyetimin se këto krime nuk lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës (“Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin”).⁹ Mbrojtja e Krasniqit mbështet gjithashtu kundërshtimet lidhur me juridiksionin e DHS-së parashtruar nga Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Veselit, nëse këto kundërshtime nuk janë në mospërputhje me Mocionin e Krasniqit lidhur me Juridiksionin.¹⁰

7. Më 15 mars 2021, Mbrojtja e z. Veseli (“Mbrojtja e Veselit”) dorëzoi një mocion paraprak me anë të të cilit kundërshtonte juridiksionin e DHS-së në lidhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare, NKP-në, përgjegjësinë eprore, arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe zhdukjen me forcë (“Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin”).¹¹ Mbrojtja e Veselit gjithashtu mbështet parashtrimet e Mbrojtjes

⁷ KSC-BC-2020-06, F00216, Mbrojtja e Thaçit, *Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit*, 12 mars 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00219, Mbrojtja e Selimit, *Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit – Diskriminim*, 15 mars 2021, publik, para. 4.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00220, Mbrojtja e Krasniqit, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Krasniqit lidhur me Juridiksionin me shtojcë publike 1*, 15 mars 2021, publik.

¹⁰ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 3.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00223, Mbrojtja e Veselit, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Kadri Veselit për Kundërshtimin e Juridiksionit të DHSK-së*, 15 mars 2021, publik.

së Thaçit nëse këto parashtrime nuk janë në mospërputhje me Mocionin e Veselit lidhur me Juridiksionin.¹²

8. Më 23 prill 2021, pas afatit të vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹³ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) iu përgjigj, ndër të tjera, mocioneve paraprake që ngrinin kundërshtime ndaj juridiksionit të DHS-së në lidhje me: (i) Raportin e Këshillit të Evropës (“Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në”);¹⁴ (ii) të drejtën zakonore ndërkombëtare (“DZN”), përgjegjësinë eprore, arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe zhdukjen me forcë (“Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në”);¹⁵ dhe në lidhje me (iii) NKP-në (“Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në”).¹⁶

9. Më 14 maj 2021, Mbrojtja e Krasniqit iu kundërpërgjigj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me KE-në (“Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në”) dhe përgjigjes së ZPS-së lidhur me NKP-në (“Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në”);¹⁷ Mbrojtja e Selimit iu kundërpërgjigj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me NKP-në (“Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në”);¹⁸ dhe Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me KE-në (“Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në”) dhe Përgjigjes së ZPS-së lidhur me NKP-në (“Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në”).¹⁹

¹² Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, poshtëshënimi 1.

¹³ KSC-BC-2020-06, Transkripti (rish.), 24 mars 2021, f. 391, rreshtat 11-18, publik.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00259, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, Afatin e Hetimit dhe Mandatin Kohor, 23 prill 2021, publike.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00262, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit Paraprak në lidhje me Zbatueshmërinë e Të Drejtës Zakonore Ndërkombëtare, 23 prill 2021, publike.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00263, Prokurori i Specializuar, Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake që Ngrënë Kundërshtime lidhur me Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët (NKP), 23 prill 2021, publike.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00299, Mbrojtja e Krasniqit, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, Afatin e Hetimit, dhe Mandatin Kohor, 14 maj 2021, publike; F00302, Mbrojtja e Krasniqit, Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë për Mocionet Paraprake që Ngrënë Kundërshtime lidhur me Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët (NKP), 14 maj 2021, publik.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00301, Mbrojtja e Selimit, Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Kundërshtimin e Mbrojtjes për Juridiksionin – Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët, 14 maj 2021, publike.

¹⁹ F00304, Mbrojtja e Thaçit, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, Afatin e Hetimit dhe Mandatin Kohor, 14 maj 2021,

10. Më 17 maj 2021, në vijim të zgjatjes së afatit të vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,²⁰ Mbrojtja e Veselit iu kundërpërgjigj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me NKP-në (“Kundërpërgjigja e Veselit lidhur me NKP-në”) dhe Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Të Drejtën Zakonore Ndërkombëtare (“Kundërpërgjigja e Veselit lidhur me DZN-në”).²¹

11. Më 1 qershor 2021, pas autorizimit të dhënë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,²² ZPS-ja parashtroi një kundërpërgjigje shtesë ndaj Kundërpërgjigjes së Veselit lidhur me DZN-në (“Kundërpërgjigja Shtesë e ZPS-së lidhur me DZN-në”).²³

12. Më 4 qershor 2021, Mbrojtja e Veselit dorëzoi parashtrimet e veta në lidhje me Kundërpërgjigjen Shtesë të ZPS-së lidhur me DZN-në (“Parashtrimet e Veselit mbi Kundërpërgjigjen Shtesë të ZPS-së lidhur me DZN-në”).²⁴

13. Më 19 maj 2021 dhe 24 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatin për vendimin mbi mocionet paraprake më 22 korrik 2021.²⁵

14. Më 21 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vuri në dukje se: (i) vendimi mbi mocionet për mosnjohje të juridiksionit të DHS-së sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores dhe vendimi mbi mocionet që pretendojnë mangësi në formën e

publik; F00306, Mbrojtja e Thaçit, *Kundërpërgjigja e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë lidhur me Mocionet Paraprake që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët (NKP)*, 14 maj 2021, publike.

²⁰ KSC-BC-2020-06, F00296, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Afatit*, 14 maj 2021, publik.

²¹ KSC-BC-2020-06, F00310, Mbrojtja e Veselit, *Kundërpërgjigja e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë lidhur me Mocionet Paraprake që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët (NKP)*, 17 maj 2021, publike; F00311, Mbrojtja e Veselit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Kadri Veselit për Kundërshtimin e Juridiksionit të DHSK-së (E Drejta Zakonore Ndërkombëtare)*, 17 maj 2021, publike.

²² KSC-BC-2020-06, F00326, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Leje për Kundërpërgjigje Shtesë*, 28 maj 2021, publik.

²³ KSC-BC-2020-06, F00333, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigja Shtesë e Prokurorisë*, 1 qershor 2021, publike.

²⁴ KSC-BC-2020-06, F00342, Mbrojtja e Veselit, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Kundërpërgjigjes Shtesë të Prokurorisë*, 4 qershor 2021, publike.

²⁵ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 19 maj 2021, publik, f. 451, rreshtat 15-17; F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtyrjen e Afateve kohore për të bërë Njoftim të Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2020, publik, para. 15, 16(f).

aktakuzës, sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores, do të lëshohet më 22 korrik 2021;
(ii) afati i një kërkesë për leje për apel do të zgjatet deri pas pushimit të Gjykatës; dhe
(iii) vendimi i tretë mbi kundërshtimet kushtetuese do të lëshohet pas pushimit të Gjykatës.²⁶

II. PARASHTRIMET E PALËVE

A. ZBATUESHMËRIA E TË DREJTËS ZAKONORE NDËRKOMBËTARE

1. Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin

15. Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin mbështetet në argumentin se DHS-ja nuk është tribunal ndërkombëtar, por gjykatë e Kosovës, e cila për këtë arsye duhet të zbatojë ligjet vendore në pajtim me Kushtetutën.²⁷ Mbrojtja e Veselit parashtron se neni 33 i Kushtetutës, së bashku me nenin 7 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (“KEDNJ” ose “Konventa”), sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ), e ndalojnë DHS-në që të ushtrojë juridiksion për krime vetëm sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, përveç nëse këto krime kanë qenë të përfshirë në legjislacionin jugosllav në fuqi në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve që përmenden në akuza, konkretisht në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (“RSFJ” dhe “Kushtetuta e RSFJ-së”) dhe në Kodin Penal të RSFJ-së të 1976 (“Kodi Penal i RSFJ-së”).²⁸

16. Mbrojtja e Veselit pretendon se as ndonjë traktat ndërkombëtar as e drejta zakonore ndërkombëtare nuk mund të krijojnë vepra penale në rendin juridik të një vendi pa ratifikim që u jep efekt ligjor në legjislacionin e brendshëm, që në rastin e DHS-së duhej të ishte Kodi Penal i RSFJ-së, i cili përbën *lex specialis* përkundrejt të drejtës zakonore ndërkombëtare.²⁹ Me fjalë të tjera, Mbrojtja e Veselit pretendon se, në

²⁶ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 21 Korrik 2021, publik, f. 457, rreshtat 5-16.

²⁷ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 40-90.

²⁸ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 31, 40-77.

²⁹ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 12, 16(vi).

pajtim me nenet 33 dhe 53 të Kushtetutës, duhet të demonstrohet se sjellja e pretenduar ose ka qenë vepër penale sipas Kodit Penal të RSFJ-së, në fuqi gjatë juridiksionit kohor të DHS-së; ose ka qenë vepër penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe është përfshirë në legjislacionin e Jugosllavisë që ishte në fuqi në Kosovë në kohën në fjalë.³⁰ Në rast se do të gjykohej se e drejta zakonore ndërkombëtare është drejtpërdrejt e zbatueshme në DHS, së pari DHS-ja duhet të zbatojë të drejtën vendore në përputhje me parimin e ligjit më të favorshëm (*lex mitior*) dhe t'i referohet të drejtës ndërkombëtare vetëm si një bazë plotësuese.³¹ Mbrojtja e Veselit parashtron gjithashtu se epërsia që i jepet të drejtës zakonore ndërkombëtare nga neni 12 i Ligjit nuk është kushtetues, sepse këtë e bën duke u mbështetur gabimisht në nenin 7(2) të KEDNJ-së, në lidhje me të cilin GJEDNJ-ja është shprehur qartësisht se zbatohet vetëm për krimet e Luftës së Dytë Botërore.³²

2. Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në

17. ZPS-ja përgjigjet se është e qartë që hartuesit e Ligjit synonin t'i jepnin DHS-së juridiksion për krimet kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, të përkufizuara nga e drejta zakonore ndërkombëtare nga 1998 deri më 2000.³³ Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes së Veselit në lidhje me standardin e dualizmit janë të papërshtatshme, sepse Ligji nuk krijon krime të reja apo ndryshon krimet e vjetra, por thjesht çel një rrugë juridiksionale për të ndjekur penalisht krimet që pretendohen se janë kryer në Kosovë nga 1998 deri më 2000.³⁴ Si neni 162 i Kushtetutës, po ashtu dhe Ligji, i cili përcakton juridiksionin e DHS-së, ishin të nevojshëm për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare të Kosovës që rridhnin nga Shkëmbimi i Letrave me Bashkimin

³⁰ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin , para. 16(vii).

³¹ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin , para. 16(vii), 32, 76.

³² Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin , para. 17-30.

³³ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 2, 19.

³⁴ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 24.

Evropian.³⁵ ZPS-ja parashtron se neni 33 i Kushtetutës është në pajtim me nenin 7 të KEDNJ-së (sipas interpretimit të GJEDNJ-së)³⁶ dhe nenin 15 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("KNDCP"), të cilat lejojnë që personat të mbahen penalisht përgjegjës për krime sipas të drejtës vendore apo të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së tyre.³⁷

18. ZPS-ja parashtron se për të akuzuarit ishte e disponueshme dhe e parashikueshme dijenia mbi ekzistencën e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, duke pasur parasysh se: (i) instrumente të ndryshme ndërkombëtare që nga koha e Luftës së Dytë Botërore i parashikonin krime të tilla; (ii) RSFJ-ja kishte ratifikuar traktate që kanë të bëjnë me krime të tilla; (iii) krimet e përfshira në akuza ishin shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe, për këtë arsye, është e paimagjinueshme që të akuzuarit të mos ishin në gjendje të parashikonin përgjegjësinë penale individuale që mund të rridhte nga një sjellje e tillë; (iv) Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") kishte të drejtë të ushtronte juridiksion ndaj krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës; dhe (v) veprimet e ndaluara në Kodin Penal të RSFJ-së pasqyrojnë veprimet bazë që akuzohen sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare. Për më tepër, ZPS-ja pretendon se pozitat që mbajtën të gjithë të akuzuarit gjatë periudhës së mbuluar nga akuzat, kërkonin që ata të njiheshin me krimet e ndaluara të luftës dhe krimet kundër njerëzimit.³⁸

19. ZPS-ja parashtron më tej se parimi *lex mitior* nuk përbën problem, sepse Ligji zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe jo të drejtën vendore, siç pretendon

³⁵ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 3.

³⁶ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 3, 5.

³⁷ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 4.

³⁸ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 9-16.

Mbrojtja e Veselit.³⁹ Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të krahasohet Ligji me të drejtën e Kosovës apo të drejtën ndërkombëtare.⁴⁰

3. Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në

20. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet⁴¹ se z. Veseli është akuzuar para një gjykate plotësisht vendore, në shkelje të parimit të mosprapaveprueshmërisë së ligjit për krime që nuk ekzistonin në të drejtën e Kosovës më 1998 dhe 1999.⁴² Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Veselit i referohet një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë të vitit 2020 (“Aktgjykimi i 2020 i GJK-së serbe”), ku thuhet se e drejta penale e zbatueshme në Kosovë në 1998-1999, është burimi i vetëm i përgjegjësisë penale për krime të pretenduara të kryera gjatë asaj kohe dhe, rrjedhimisht, vetëm e drejta ndërkombëtare nuk mund të përbëjë bazë për përgjegjësi penale, kur kjo nuk është e përfshirë në të drejtën vendore.⁴³ Duke marrë parasysh se në 1998-1999, Kosova ishte pjesë e Serbisë, do të ishte një shkelje e Kushtetutës nëse DHS-ja do ta trajtonte çështjen e prapaveprueshmërisë në një mënyrë më pak të favorshme për të akuzuarit, krahasuar me të pandehur të tjerë në gjykatat serbe, për krime të kryera në të njëjtin kontekst nga persona që janë objekt i të njëjtit ligj në atë kohë.⁴⁴ Gjithashtu, duke marrë parasysh Aktgjykimin e GJK-së serbe të vitit 2020, Mbrojtja e Veselit argumenton se neni 7(2) i KEDNJ-së nuk përbën shmangje të përhershme nga parimi i mosprapaveprueshmërisë së nenit 7(1) të KEDNJ-së.⁴⁵ Mbrojtja e Veselit pretendon se, sipas një opiniononi ekspert të përgatitur nga dy prej hartuesve kryesorë të Kushtetutës (“Opinion ekspert”), traktatet ndërkombëtare dhe e drejta zakonore ndërkombëtare nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë në çështje penale në Kosovë dhe neni 33(4) i

³⁹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 28.

⁴⁰ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 29.

⁴¹ Mbrojtja e Veselit përfshin gjithashtu para. 2-32 të Kundërpërgjigjes së Veselit lidhur me NKP-në.

⁴² Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 2.

⁴³ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 3, 11.

⁴⁴ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 10, 12-15.

⁴⁵ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 7.

Kushtetutës vepron si *lex specialis* kundrejt çdo norme ligjore që përcakton ndëshkimin ligjor për një vepër penale të caktuar.⁴⁶

21. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Veselit rithekson qëndrimin e vet se sipas Kushtetutës së RSFJ-së që ishte në fuqi në kohën e krimeve të përfshira në akuza, ishte e ndaluar mbështetja në të drejtën zakonore ndërkombëtare si burim përgjegjësie penale, kur një vepër penale apo një formë përgjegjësie penale konkrete, nuk ishte e përfshirë drejtpërsëdrejti në të drejtën vendore në fuqi atë kohë.⁴⁷ Në lidhje me këtë aspekt, Mbrojtja e Veselit përsërit argumentin e vet se neni 33(1) i Kushtetutës pasqyron nenin 7(2) të KEDNJ-së, i cili sipas GJEDNJ-së tani është i vjetruar dhe nuk mund të përbëjë përjashtim nga parimi i mosprapaveprueshmërisë.⁴⁸

22. Në lidhje me parimin *lex mitior*, Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se ZPS-ja shpërfill nenin 33 të Kushtetutës i cili i kërkon drejtpërdrejt DHS-së të bëjë vlerësimin e ligjit më të përshtatshëm për të akuzuarin.⁴⁹ Nenet 12 dhe 15(1) të Ligjit parashikojnë, më së paku, zbatimin e njëkohshëm të së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe të së drejtës vendore.⁵⁰

4. Kundërpërgjigjja Shtesë e ZPS-së lidhur me DZN-në

23. ZPS-ja parashtron se Aktgjykimi i GJK-së serbe i vitit 2020 nuk ka efekt mbi juridiksionin e gjykatave të sistemit gjyqësor të Kosovës.⁵¹ ZPS-ja parashtron më tej se, meqenëse DHS-ja zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare që ekzistonte në kohën e akuzave, konstatimet e Aktgjykimit të GJK-së serbe të vitit 2020 janë pa lidhje dhe, rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes lidhur me pabarazinë e pretenduar midis të

⁴⁶ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në , para. 16(a).

⁴⁷ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në , para. 8.

⁴⁸ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në , para. 17-25.

⁴⁹ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në , para. 29.

⁵⁰ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në , para. 30.

⁵¹ Kundërpërgjigjja shtesë e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 2.

akuzuarve dhe personave të tjerë të ndjekur penalisht për krime të ngjashme para gjykatave serbe hidhen poshtë.⁵²

5. Parashtrimet e Veselit lidhur me Kundërpërgjigjen Shtesë të ZPS-së lidhur me DZN-në

24. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet duke ripërsëritur dhe shtjelluar më tej argumentet e veta në lidhje me diskriminimin e pretenduar lidhur me ndjekjen penale të personave serbë dhe shqiptarë në bazë të dy legjislacioneve të ndryshme, për të njëjtët lloje krimesh të pretenduara, në dëm të të akuzuarve.⁵³ Sipas argumentimit të Mbrojtjes së Veselit, ndjekja penalisht e të akuzuarve për krime që nuk kanë qenë krime të përfshira në legjislacionin vendor, do të rezultonte në diskriminim flagrant midis dy palëve etnike të ndryshme në të njëjtin konflikt.⁵⁴

B. RAPORTI I KËSHILLIT TË EVROPËS

1. Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin

25. Mbrojtja e Thaçit i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të deklarojë që DHS-ja nuk ka juridiksion për krimet që përfshihen në Aktakuzë, duke qenë se asnjë nga akuzat nuk lidhen me pretendimet e ngritura në Raportin e Këshillit të Evropës kundër z. Thaçi.⁵⁵

26. Mbrojtja e Thaçit parashton se hetimi i Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”) shkoi përtej akuzave për trafikim organesh dhe trajtim çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri, të cilat ishin fokusi i Raportit të Këshillit të Evropës.⁵⁶ Ajo shton se Kuvendi e kufizoi fushëveprimin e juridiksionit të DHS-së, duke e lidhur qëllimin dhe

⁵² Kundërpërgjigjja shtesë e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 4-5.

⁵³ Parashtrimet e Veselit ndaj Kundërpërgjigjes Shtesë të ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 8-10.

⁵⁴ Parashtrimet e Veselit ndaj Kundërpërgjigjes Shtesë të ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 11.

⁵⁵ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 1(a), 75.

⁵⁶ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 9-10, 13-22, 28.

ekzistencën e saj me respektimin e detyrimeve ndërkombëtare për sa i takon Raportit dhe se një kufizim i tillë konfirmohet nga debatet në Kuvend.⁵⁷ Gjithashtu, Mbrojtja është e mendimit se përdorimi i fjalës “dhe” në nenin 1(2) të Ligjit nuk lë hapësirë për procedimin penal të krimeve që janë jashtë pretendimeve të ngritura në Raportin e Këshillit të Evropës, apo që rrjedhin nga hetimet e mëtejshme të ZPS-së.⁵⁸ Ajo argumenton gjithashtu se koha, vendndodhja dhe mungesa e lidhjes me konfliktin e armatosur i vendos krimet e pretenduara në Raportin e Këshillit të Evropës jashtë juridiksionit të TPNJ-së dhe se synimi dhe hartimi i juridiksioni të DHS-së ishte që të trajtohej kjo zbrazëti.⁵⁹

27. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, Aktakuza është hartuar duke shpërfillur kufizimet e vendosura nga Kushtetuta dhe të konfirmuara në legjislacionin themelues të DHS-së.⁶⁰ Së pari, Mbrojtja e Thaçit pretendon se të vetmet vendndodhje të renditura për të cilat jepet ndonjë detaj në Raportin e Këshillit të Evropës janë objektet e ndalimit në territorin e Shqipërisë, ndërsa krimet e pretenduara në Aktakuzë kanë ndodhur thuajse vetëm në Kosovë.⁶¹ Së dyti, Mbrojtja e Thaçit pohon se kuadri kohor i Aktakuzës kufizohet së paku nga marsi 1998 deri në shtator 1999, kurse Raporti i Këshillit të Evropës ka të bëjë me veprime që pretendohet se kanë ndodhur më së shumti nga vera e 1999 e më tej.⁶² Së treti, sipas Mbrojtjes së Thaçit, megjithëse Raporti i Këshillit të Evropës përshkruan kornizën e veprimtarisë së pretenduar kriminale në formën e krimit të organizuar dhe jo si krime lufte, apo krime kundër njerëzimit, Aktakuza nuk përmend krime të organizuara në Kosovë apo gjetiu.⁶³

⁵⁷ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 23-24, 29-30.

⁵⁸ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 25-26.

⁵⁹ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 31-32.

⁶⁰ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 33.

⁶¹ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 34-36.

⁶² Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 37-38.

⁶³ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 39-41.

2. Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim)

28. Mbrojtja e Selimit mbështet dhe u bashkohet argumenteve të Mbrojtjes së Thaçit të parashtruara më sipër.⁶⁴ Mbi këtë bazë, Mbrojtja e Selimit deklaron se ZPS-ja kreu një hetim penal kundër z. Selimi pa pasur bazë ligjore, duke qenë se ai nuk ka qenë kurrë objekt i pretendimeve në Raportin e Këshillit të Evropës.⁶⁵

3. Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin

29. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se DHS-ja nuk ka juridiksion mbi shumicën e krimeve të parashtruara në Aktakuzë sepse, në kundërshtim me nenin 6(1) të Ligjit, ato nuk kanë të bëjnë me Raportin e Këshillit të Evropës.⁶⁶

30. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se Raporti i Këshillit të Evropës u autorizua për hetimin e pretendimit konkret të trafikimit të organeve, si një veprimtari e organizuar kriminale nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") pas përfundimit të konfliktit të armatosur në Shqipëri.⁶⁷ Ajo shton se TFHS-ja kuptoi se ishte ngarkuar me detyrë të hetonte këto krime duke qenë se çfarëdo krimesh që pretendohej se ishte kryer nga marsi 1998 deri në prill 1999 në Kosovë, ishin nën juridiksionin e TPNJ-së.⁶⁸ Për mendimin e Mbrojtjes së Krasniqit, synimi ishte që fushëveprimi i proceseve penale në DHS të kufizohej në pretendimet që përmbante Raporti i Këshillit të Evropës.⁶⁹ Në lidhje me këtë, ajo argumenton se, meqenëse pretendimet për krime të kryera në qendrat e ndalimit në Kosovë gjatë konfliktit ishin hetuar ndërkohë nga TPNJ-ja dhe EULEX-i, neni 103(7) i Kushtetutës, sikurse është konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese, i ka dhënë ligjvënësit të drejtën vetëm të themelojë DHS-në për të

⁶⁴ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), para. 4, poshtëshënimi 5.

⁶⁵ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), f. 4, poshtëshënimi 16.

⁶⁶ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 2, 55, 69, 71.

⁶⁷ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 57-60, 67.

⁶⁸ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 61, 65(b).

⁶⁹ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 62.

proceduar penalisht pretendimet që përmban Raporti.⁷⁰ Mbrojtja e Krasniqit argumenton se, nëse hartuesit do të kishin pasur synim të lejonin një gamë më të gjerë krimesh për ndjekje penale, Ligji apo Rregullorja do të kishin ofruar orientim ligjor për kuptimin e frazës “që kanë të bëjnë me” në nenin 6(1) të Ligjit.⁷¹ Ajo pretendon gjithashtu se, si një çështje që ka të bëjë me të drejtën për të drejtat e njeriut, DHS-ja nuk duhet të miratojë një interpretim të gjerë të juridiksionit të vet në dëm të të akuzuarit.⁷²

31. Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit është e mendimit se, megjithëse Raporti i Këshillit të Evropës ngre pretendimin për një politikë sipas të cilës, në periudhën prill – qershor 1999, në territorin e Shqipërisë, u mbajtën të ndaluar për t’u marrë në pyetje njerëz të cilët dyshoheshin si bashkëpunëtorë dhe përcakton se kishte individë për të cilët dyshohej që ishin bashkëpunëtorë me arsyetimin se spiunonin për serbët, apo mbështetnin rivalët politikë dhe ushtarakë të UÇK-së, kjo nuk ka të bëjë aspak me Aktakuzën në çështjen aktuale.⁷³

4. Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në

32. ZPS-ja përgjigjet se argumentet e Mbrojtjes duhen hedhur poshtë, sepse të gjitha akuzat e ngritura në Aktakuzë kanë të bëjnë me Raportin e Këshillit të Evropës dhe rrjedhimisht janë brenda juridiksionit lëndor të DHS-së.⁷⁴

33. ZPS-ja parashtrohet se, nëse neni 162(1) i Kushtetutës do të ishte hartuar për të ngushtuar apo korrigjuar fushëveprimin e hetimeve të TFHS-së, do të kishte qenë e nevojshme që gjuha e përdorur të përcaktonte shprehimisht mënyrën në të cilën do të duhej të lexohej Raporti i Këshillit të Evropës, apo të identifikoheshin pretendimet

⁷⁰ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 63, 65(a), 66.

⁷¹ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 65(c).

⁷² Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 65(d).

⁷³ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 68.

⁷⁴ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 1, 33.

konkrete që përcaktojnë fushëveprimin e lejueshëm të juridiksionit lëndor të DHS-së.⁷⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se mbështetja në historinë e hartimit të ligjit kundrejt formulimit të qartë ligjor nuk është interpretim i duhur ligjor.⁷⁶ Ajo gjithashtu parashtron se interpretimi i Mbrojtjes kundërshtohet drejtpërdrejt nga formulimi tekstual i Ligjit.⁷⁷

34. Gjithashtu, sipas ZPS-së, interpretimi i Ligji nuk duhet bërë duke përjashtuar çdo përkim juridiksioni me çështjet që janë brenda juridiksionit të TPNJ-së, duke qenë se kur i referohen TPNJ-së, as Kushtetuta dhe as Ligji nuk e shmangin juridiksionin e DHS-së, por duket se Ligj parashikon konkretisht mundësinë e një përkimi material.⁷⁸ Ajo shton se nuk ka gjasa sikurse sugjerohet se u krijua një mandat reciprokisht përjashtues me TPNJ-në, duke qenë se ai tribunal ishte në fazë të avancuar të strategjisë përmbyllëse të vet kur Ligji ishte në shqyrtim e sipër.⁷⁹

35. Gjithashtu, sipas ZPS-së, përmendja e krimeve që “kanë të bëjnë me” Raportin e Këshillit të Evropës në Ligj bën të qartë se nuk kërkohet një përkim i plotë.⁸⁰ ZPS-ja shton se neni 1(2) i Ligjit ka karakter përshkrues dhe jo juridiksionale.⁸¹ Ajo argumenton më tej se do të kishte qenë e paarsyeshme që juridiksioni i DHS-së të kufizohej rreptësisht vetëm në ato incidente përpara kryerjes së hetimeve penale.⁸²

36. ZPS-ja gjithashtu argumenton se akuzat e ngritura në Aktakuzë janë brenda fushëveprimit të çështjeve të trajtuara shprehimisht në Raportin e Këshillit të Evropës.⁸³ Për mendimin e saj, Raporti përmban pretendime të qarta për krime ndërkombëtare, dhe po ashtu identifikon edhe aspekte të tjera të çështjes së ngritur

⁷⁵ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 7.

⁷⁶ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 8.

⁷⁷ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 9-10.

⁷⁸ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 11.

⁷⁹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 12.

⁸⁰ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 13.

⁸¹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, poshtëshënimi 24.

⁸² Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 13.

⁸³ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 15.

kundër të akuzuarve.⁸⁴ Gjithashtu, ZPS-ja deklaroi se Raporti i Këshillit të Evropës nuk fokusohet vetëm te krimet e kryera në Shqipëri, sepse ai përmend shprehimisht krime në pjesë të ndryshme të Kosovës.⁸⁵ Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se pikërisht fraza “në pjesën më të madhe” tregon se ky Raport përfshin krime përtej verës së vitit 1999.⁸⁶ Së fundi, ZPS-ja parashtron se Raporti i Këshillit të Evropës përshkruan kryes të mundshëm në mënyrë joshteruese.⁸⁷

5. Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në

37. Mbrojtja e Krasniqit kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk mund të vërtetojë se akuzat e ngritura në Aktakuzë lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës.⁸⁸

38. Mbrojtja e Krasniqit nuk pajtohet me ZPS-në se çdo lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, sado e dobët, është e mjaftueshme për t'i dhënë juridiksion DHS-së.⁸⁹ Për mendimin e saj, arsyeja e vetme e përfshirjes së frazës “që kanë të bëjnë me” në nenin 6(1) të Ligjit është për ta ngushtuar juridiksionin e DHS-së, me qëllim që ajo të ketë juridiksion vetëm për krimet që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës, i cili përputhet me interpretimin harmonik të Ligjit dhe Kushtetutës.⁹⁰ Mbrojtja e Krasniqit shton se, në shqyrtimin e vlefshmërisë të nenit 6(1) të Ligjit duke mbajtur parasysh nenin 162 të Kushtetutës, ZPS-ja nuk arrin të trajtojë parashtrimin e vet të bazuar në nenin 103(7) të Kushtetutës.⁹¹

⁸⁴ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 16, 17, 18.

⁸⁵ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 19.

⁸⁶ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 20.

⁸⁷ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me KE-në, para. 21.

⁸⁸ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 1, 20, 21.

⁸⁹ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 4.

⁹⁰ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 5-6.

⁹¹ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 6.

39. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se përveç akuzave për Cahanin dhe Kukësin, ZPS-ja nuk arrin të demonstrojë se pjesa e mbetur e akuzave në Aktakuzë ka të bëjë me Raportin e Këshillit të Evropës.⁹²

40. Sipas Mbrojtjes së Krasniqit, interpretimi nga ZPS-ja i nenit 6(1) të Ligjit nuk ndihmohet duke iu referuar dispozitave të tjera të Ligjit.⁹³ Së pari, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se në pretendimet e ngritura në Raportin e Këshillit të Evropës përmendet se viktimat ishin transportuar nga Kosova në Shqipëri, kështu që për hetimin e plotë të atyre raste do të nevojitej juridiksion për krimet në Kosovë.⁹⁴ Së dyti, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se fakti Ligji parashikon juridiksion për krime ndërkombëtare nuk do të thotë që juridiksioni i DHS-së e tejkalon fokusin e Raportit të Këshillit të Evropës tek krimet e kryera në Shqipëri pas prillit 1999.⁹⁵ Së treti, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se fakti që Ligji parashikon që provat e mbledhura nga TPNJ-ja të jenë të pranueshme, është në pajtim me qëndrimin e Mbrojtjes, duke qenë se provat për ekzistencën e një konflikti të armatosur dhe për strukturat komanduese ushtarake janë qartazi me rëndësi për çështjet nën juridiksion e DHS-së.⁹⁶ Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit është e mendimit se dispozitat *non-bis-in-idem* veprojnë posaçërisht për të përjashtuar disa përkime me hetimet e TPNJ-së, dhe jo për të dëshmuar një juridiksion më të gjerë.⁹⁷

6. Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në

41. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se ZPS-ja e shtrembëron fushëveprimin juridiksional të DHS-së të përcaktuar nga neni 162 i Kushtetutës dhe Kreu III i Ligjit,

⁹² Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 7-14.

⁹³ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 15.

⁹⁴ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 16.

⁹⁵ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 17.

⁹⁶ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 18.

⁹⁷ Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me KE-në, para. 19.

duke i shkëputur gabimisht këto dispozita nga kufizimi i vendosur nga neni 6(1) i Ligjit sipas të cilit krimet duhet të kenë të bëjnë me Raportin e Këshillit të Evropës.⁹⁸

42. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, megjithëse parametrat juridiksionalë të DHS-së mund të jenë më të gjera, një krim i pretenduar duhet të ketë të bëjë edhe me Raportin.⁹⁹ Ajo shton se do të kishte qenë e paarsyeshme nga ana e ligjvënësve të pajtoheshin me fushëveprimin juridiksional të propozuar nga ZPS-ja.¹⁰⁰ Gjithashtu, sipas Mbrojtjes së Thaçit, Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve nuk ka vlerë për interpretimin e një ligji shtetëror dhe është një fakt i mirënjohur se në interpretimin e sistemeve shtetërore merren parasysh historia legislative dhe debatet parlamentare.¹⁰¹

43. Mbrojtja e Thaçit parashton më tej se neni 17 i Ligjit është i tepërt, sepse i referohet një norme që ndërkohë ekziston në Kushtetutë dhe se neni 37 i Ligjit thjesht parashikon pranueshmërinë e disa lloje provash.¹⁰² Ajo pretendon gjithashtu se shumica e akuzave të ngritura në Aktakuzë kanë të bëjnë me incidente apo ngjarje që ndërkohë janë ndjekur penalisht dhe gjykuar ose nga TPNJ-ja, UNMIK-u, ose nga EULEX-i.¹⁰³

44. Për mendimin e Mbrojtjes së Thaçit, ZPS-ja veçon fjalë dhe fraza nga Raporti i Këshillit të Evropës, duke pretenduar se përmbajnë pretendime të qarta për krime ndërkombëtare, duke mos u marrë me pretendimet dhe incidentet faktike të trajtuara në Raport.¹⁰⁴ Ajo deklaron se paragrafët në Raportin e Këshillit të Evropës që kanë të bëjnë me krime ndërkombëtare të shfrytëzuara nga ZPS-ja u referohen rrethanave të përgjithshme që kanë të bëjnë me hetime apo akuza të mëparshme.¹⁰⁵ Mbrojtja e Thaçit gjithashtu pretendon se fakti që katër paragrafë të Raportit të Këshillit të Evropës u

⁹⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 1.

⁹⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 2.

¹⁰⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 3- 4.

¹⁰¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 5.

¹⁰² Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 6-7.

¹⁰³ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 8.

¹⁰⁴ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 10.

¹⁰⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 11-12, 21.

referohen krimeve të kryer në Kosovë, apo që titulli i tij përmend Kosovën, nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimet kufizohen në ngjarjet e ndodhura në Shqipëri.¹⁰⁶ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtron se përmendja e veprimeve të ndodhura “në pjesën më të madhe” nga vera e vitit 1999 e këtej ka të bëjë me trajtim çnjerëzor gjatë mbajtjes në ndalim të diskutuar në Raportin e Këshillit të Evropës dhe nuk çel derën për pretendime juridiksionale mbi çfarëdo veprimi apo të gjitha veprimet apo krimet e pretenduara gjatë konfliktit të mëparshëm të armatosur.¹⁰⁷

C. NDALIMI ARBITRAR

1. Mocioni i Veselit lidhur Juridiksionin

45. Mbrojtja e Veselit parashtron se krimi i luftës i ndalimit arbitrar nuk ka bazë ligjore në nenin 14(1)(c) të Ligjit.¹⁰⁸ Po ashtu, parashtrohet se ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk përbën shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Katër Konventave të Gjenevës së 1949 (“Neni i Përbashkët 3”, “Konventat e Gjenevës” ose “KGJ-të”), as nuk shkel të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën e akuzave.¹⁰⁹ Si rrjedhojë, çdo zgjerim i akuzave përmes analogjisë, pa një bazë të qartë dhe të fortë në ligj, shkel parimin e ligjshmërisë të mishëruar në nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të KEDNJ-së.¹¹⁰ Gjithashtu, Mbrojtja e Veselit parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gabimisht është mbështetur në Studimin e të Drejtës Humanitare Zakonore Ndërkombëtare të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (“DHN-ja Zakonore”, “Studimi i DHN-së

¹⁰⁶ Kundërpërgjigja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 15, 18, 21.

¹⁰⁷ Kundërpërgjigja e Thaçit lidhur me KE-në, para. 19-21.

¹⁰⁸ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 131-132, 135-136.

¹⁰⁹ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 131-132, 139-142, 144-147.

¹¹⁰ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 134, 137.

Zakonore”¹¹¹ dhe “KNKK”) për të identifikuar një rregull të së drejtës zakonore ndërkombëtare e cila nuk lejon ndalimin arbitrar.¹¹²

2. Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në

46. ZPS-ja përgjigjet se moslejimi i ndalimit arbitrar përfshihet në fushëveprimin e nenit 14(1)(c) të Ligjit, qoftë sipas një interpretimi tekstual të formulimit të tij të hapur, qoftë sepse një sjellje e tillë është në kundërshtim me parimin e trajtimit njerëzor të mishëruar në Nenin e Përbashkët 3.¹¹³ Rrjedhimisht, ZPS-ja pretendon se ndalimi arbitrar përbën një shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3, i cili synon të mbrojë së pari, të drejtat themelore të jetës, lirisë dhe sigurisë së personit, duke përfshirë integritetin fizik.¹¹⁴ ZPS-ja parashtron se ekziston një praktikë e mjaftueshme në mbështetje të ekzistencës së një rregulle të së drejtës zakonore ndërkombëtare në lidhje me ndalimin arbitrar në konflikte të armatosura jondërkombëtare.¹¹⁵

3. Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në

47. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se praktika në mbështetje të një rregulle zakonore për ndalimin arbitrar është qartësisht e pamjaftueshme.¹¹⁶ Gjithashtu, Mbrojtja e Veselit parashtron se përkthimi në shqip i nenit 14(1)(c) të Ligjit mbështet argumentin e Mbrojtjes se faktikisht kjo dispozitë nuk hap rrugën për përfshirjen e një sjelljeje që nuk përmendet shprehimisht në nenin 14 të Ligjit.¹¹⁷

¹¹¹ Henckaerts J.-M., Doswald-Beck L., *Customary International Humanitarian Law*, Volume I (Rules), Volume II (Practice), Cambridge University Press 2005

¹¹² Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 143.

¹¹³ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 49-51.

¹¹⁴ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 57.

¹¹⁵ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 52-53.

¹¹⁶ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 47-51.

¹¹⁷ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 41.

D. ZHDUKJA ME FORCË E PERSONAVE

1. Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin

48. Mbrojtja parashtron se DHS-ja nuk ka juridiksion lidhur me zhdukjen me forcë të personave si krim kundër njerëzimit, duke qenë se kjo nuk njihet shprehimisht në Ligj apo në të drejtën e Kosovës.¹¹⁸ Mbrojtja parashtron më tej se, edhe nëse do të konstatohej se e drejta zakonore ndërkombëtare ka efekt të drejtpërdrejtë, ky krim nuk ishte përcaktuar mjaftueshëm në legjislacionin e kohës së incidenteve të pretenduara në Aktakuzë.¹¹⁹ Për mendimin e Mbrojtjes, shumica e instrumenteve të cituara në Vendimin e Konfirmimit janë miratuar pas ngjarjeve të pretenduara në Aktakuzë,¹²⁰ dhe burimet e mbetura janë të papërshtatshme.¹²¹ Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se një numër burimesh provojnë se më 1998 ky krim nuk kishte statusin e të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹²² Gjithashtu, për mendimin e Mbrojtjes, konstatimi se “nuk është e nevojshme të demonstrohet apo edhe të supozohet synimi konkret i kryesit për ta nxjerrë viktimën jashtë mbrojtjes ligjore” është i mangët, duke qenë se burimet e cituara ose u referohen dokumenteve vijuese të periudhës kohore përkatëse, ose lidhen me një përkufizim “të ardhshëm” të këtij krimi.¹²³ Mbrojtja shton se, gjithsesi, burimet e cituara thjesht nuk e mbështesin përfundimin e lartpërmendur.¹²⁴

2. Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në

49. ZPS-ja përgjigjet se DHS-ja ka juridiksion ndaj zhdukjes me forcë si krim kundër njerëzimit.¹²⁵ Sipas ZPS-së, parashtrimet e Mbrojtjes nuk e zbehin dhe në një masë të madhe e shpërfillin faktin se marrja gjithnjë e më shumë parasysh e praktikës së

¹¹⁸ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 37.

¹¹⁹ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 38, 158.

¹²⁰ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 151.

¹²¹ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 152-153.

¹²² Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 154-157.

¹²³ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 159-160, 162.

¹²⁴ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 161.

¹²⁵ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 1, 82.

vazhdueshme shtetërore dhe *opinio juris* së paku që nga viti 1946, si dhe mungesa e vazhdueshme e praktikës së kundërt apo e kundërshtimeve, tregojnë se më 1998, zhdukja me forcë ishte krim kundër njerëzimit sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹²⁶ Ajo shton se statutet dhe jurisprudenca pas vitit 1999 konfirmojnë se veprimet e zhdukjes me forcë të kryera përpara dhe gjatë juridiksionit kohor të DHS-së përbënin krime kundër njerëzimit.¹²⁷ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se, edhe duke supozuar *arguendo* se zhdukja me forcë nuk ishte krim i njohur shprehimisht në të drejtën zakonore ndërkombëtare më 1998, duke u nisur nga vetë lloji i saj, ajo ngrihet në nivelin e krimeve të tjera kundër njerëzimit, pra, është një veprim tjetër çnjëzor.¹²⁸ Për më tepër, për mendimin e ZPS-së, argumentet lidhur me synimin konkret të zhdukjes me forcë trajtojnë konturet e këtij krimi dhe parashtrohen në mënyrë të papërshtatshme si kundërshtime lidhur me juridiksionin.¹²⁹ ZPS-ja shton se, gjithsesi, synimi për ta nxjerrë viktimën nga mbrojtja ligjore, ndërkohë që kjo mbrojtje gjendet në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) nuk është kriter sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe nga ana tjetër, argumentet e Mbrojtjes lidhur me përdorimin e një standardi më të favorshëm për të akuzuarit janë pa vend dhe të pabazuara.¹³⁰

3. Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në

50. Mbrojtja kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk u është përgjigjur argumenteve të mëposhtme: (i) Grupi i Punës i Kombeve të Bashkuara (“KB”) për Zhdukjet e Detyruara dhe Jovullnetare u deklarua lidhur me statusin e të drejtës zakonore ndërkombëtare të zhdukjeve me forcë vetëm më 2009; (ii) asnjë gjykatë apo tribunal penal ndërkombëtar nuk ka shpallur kurrë njeri fajtor, apo qoftë edhe të ketë nisur një

¹²⁶ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 62-74, 78.

¹²⁷ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 75-77.

¹²⁸ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 79.

¹²⁹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 80.

¹³⁰ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 81.

hetim kundër një personi të dyshuar për kryerjen e zhdukjes me forcë të dikujt; (iii) zhdukja me forcë nuk njihet si krim kundër njerëzimit nga statutet e TPNJ-së, Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën ("TPNR"), Dhomave të Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias ("DHJGJK") dhe Gjykatës Speciale për Sierra Leonen ("GJSSL"); (iv) ZPS-ja nuk është në gjendje të tregojë se sa shtete e kanë penalizuar zhdukjen me forcë përpara vitit 1998 dhe sa e penalizuar është ajo si krim kundër njerëzimit; (v) ZPS-ja nuk arrin të japë qoftë edhe një përkufizim të vetëm të zhdukjes me forcë si një krim kundër njerëzimit nga një instrument juridik ndërkombëtar; dhe (vi) fakti që gjatë hartimit të Statutit të GJPN-së pati fillimisht shumë kundërshtime lidhur me përfshirjen e zhdukjes me forcë dhe polemika të konsiderueshme lidhur me përkufizimin.¹³¹ Mbrojtja pretendon gjithashtu se ZPS-ja nuk ka marrë parasysh se që nga 2005, nuk ka pasur ndonjë përkufizim aq të gjerë për zhdukjen me forcë sa të mbulonte edhe aktorët joshtetërorë.¹³²

E. NDËRMARRJA KRIMINALE E PËRBASHKËT

1. Mocionet e Mbrojtjes për Juridiksionin lidhur me NKP-në

51. Mbrojtja e kundërshton juridiksionin e DHS-së lidhur me NKP-së në bazë të këtyre linjave argumentuese: (i) neni 16(1)(a) i Ligjit nuk e përfshin NKP-në; (ii) NKP-ja nuk është pjesë e të drejtës penale të Kosovës; (iii) NKP-ja nuk është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare; (iv) NKP-ja nuk ishte e parashikueshme apo e disponueshme për të akuzuarit në kohën e kryerjes së krimeve të akuzuara; dhe (v) NKP-ja është kundër parimeve *in dubio pro reo*, *lex mitior*, të fajësisë dhe nuk lidhet me krime me synim konkret.

52. Për sa i takon nenit 16(1)(a) të Ligjit, Mbrojtja parashtron se mospërfshirja e qartë e NKP-së në tekst duket se është një zgjedhje e qëllimshme për refuzimin e NKP-së si

¹³¹ Kundërpërgjigja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 56.

¹³² Kundërpërgjigja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 57.

formë përgjegjësie penale në DHS.¹³³ Mbrojtja parashtron se nuk duhet të ndiqet jurisprudenca përkatëse e TPNJ-së sepse është e qartë se Ligji, i hartuar më shumë se njëzetë vjet pas Statutit të TPNJ-së, pasqyron një vendim të qëllimshëm për mospërfshirjen e NKP-së.¹³⁴ Më tej parashtrohet se për shkak të mospërmendjes konkretisht të NKP-së në nenin 16(1)(a) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të hulumtojë edhe një herë statusin e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e ngjarjeve të pretenduara në Aktakuzë dhe të dalë me një konstatim nëse NKP-ja e kishte marrë statusin zakonor në 1998-1999 dhe nëse po, në çfarë forme dhe me çfarë fushëveprimi.¹³⁵ Mbrojtja parashtron gjithashtu se është detyrim i ZPS-së që të arsyetojë nëse NKP-ja përfshihet brenda fushëveprimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit,¹³⁶ dhe se ZPS-ja nuk e ka bërë këtë.¹³⁷

53. Për sa i takon të drejtës penale të Kosovës, Mbrojtja parashtron se asnjë nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal të RSFJ-së nuk parashikon ndonjë formë përgjegjësie penale e cila do të mund të barazohej me NKP-në.¹³⁸ Mbrojtja parashtron më tej se sipas legjislacionit të Kosovës, NKP-ja ndryshon si nga bashkëkryerja, ashtu edhe nga përgjegjësia e dikujt si ndihmës.¹³⁹

54. Sa i takon të drejtës zakonore ndërkombëtare, Mbrojtja parashtron se NKP-ja nuk njihet në të drejtën zakonore ndërkombëtare, por edhe nëse sot do të njihet si e tillë, më 1998 dhe 1999 nuk ishte e drejtë zakonore ndërkombëtare.¹⁴⁰ Mbrojtja parashtron se Dhomat e Apelit të TPNJ-së dhe të DHJGJK-së nuk ndërmorën ndonjë shqyrtim

¹³³ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 22, 26-27; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 61; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 17-18, 21; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 95.

¹³⁴ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 21; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 95.

¹³⁵ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 96-97.

¹³⁶ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 23-25.

¹³⁷ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 61.

¹³⁸ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 29-30.

¹³⁹ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 31-32.

¹⁴⁰ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 2, 36-40, 44-55; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 63-66, Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 1, 24.

rigoroz në lidhje me formën e saj bazë¹⁴¹ dhe/ose të zgjeruar kur konstatuan se NKP-ja ishte një e drejtë zakonore ndërkombëtare.¹⁴² Mbrojtja është e mendimit se Karta e Tribunalëve Ushtarakë Ndërkombëtarë – Shtojcë e Marrëveshjes për Procedimin dhe Ndëshkimin e Kriminelëve të Mëdhenj të Luftës të Boshtit Evropian (“Karta e Nurembergut”)¹⁴³ dhe Ligji nr. 10 i Këshillit të Kontrollit, *Ndëshkimi i Personave Fajtorë për Krime Luftë, Krime kundër Paqes dhe Njerëzimit* (“CCL10”)¹⁴⁴ u miratuan pas kryerjes së krimeve dhe nuk parashikojnë përgjegjësi penale për NKP-në.¹⁴⁵ Mbrojtja parashtron gjithashtu se duke pasur parasysh polemikën e vazhdueshme lidhur me faktin nëse NKP-ja ose bashkëkryerja, siç mishërohet në Statutin e GJPN-së, është forma e parapëlqyer e përgjegjësisë penale, nuk ka sesi NKP-ja të ketë bazë të konsoliduar në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹⁴⁶ Në veçanti, në lidhje me formën e zgjeruar të NKP-së, Mbrojtja parashtron se çështjet pas Luftës së Dytë Botërore tregojnë një praktikë jo të njëtrajtshme shtetërore e cila e bën të pamundur ekzistencën e rregullës së të drejtës zakonore në lidhje me NKP III.¹⁴⁷ Mbrojtja gjithashtu mendon se jurisprudenca e DHJGJK-së, mungesa e praktikës shtetërore në kohën nga periudha e mbuluar nga juridiksioni i DHJGJK-së dhe vendimi në çështjen *Tadiq*, jurisprudenca e kohëve të fundit e MB-së, deklaratat e gjykatësve (të mëparshëm) dhe literatura akademike hedhin dyshim mbi statusin zakonor të NKP III.¹⁴⁸ Mbrojtja parashtron

¹⁴¹ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 36-43, 44-55; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 63; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24.

¹⁴² Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 56-60; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 67-71; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24-27; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 98-105.

¹⁴³ [Charter of the International Military Tribunal](#) – Annex to the Agreement for the Prosecution and Punishment of the Major War Criminals of the European Axis, 82 UNTS 279, 8 August 1945.

¹⁴⁴ [Control Council Law No. 10](#), Punishment of Persons Guilty of War Crimes, Crimes Against Peace and Against Humanity, 20 December 1945, 3 Official Gazette Control Council for Germany 50-55 (1946).

¹⁴⁵ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 52; Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 49-52.

¹⁴⁶ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 63-66.

¹⁴⁷ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 28-38.

¹⁴⁸ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 56-68; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 68-71; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 25, 27, 46-47; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 98-105.

gjithashtu se NKP III nuk mbështetet as nga traktatet ndërkombëtare as nga parimet e përgjithshme të së drejtës të sistemeve shtetërore.¹⁴⁹

55. Sa i takon parashikueshmërisë dhe disponueshmërisë, Mbrojtja parashtron se edhe nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton që ndonjëra nga tre format e NKP-së ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, ai duhet të shqyrtojë gjithashtu nëse këto forma kanë qenë mjaftueshëm të parashikueshme dhe të disponueshme për dikë në Kosovë në kohën përkatëse.¹⁵⁰ Mbrojtja mendon gjithashtu se NKP-ja nuk ishte e parashikueshme, as e disponueshme, sepse nuk gjendej në legjislacionin e Kosovës dhe për shkak se aktgjykimi i apelit të TPNJ-së në çështjen *Tadiq* u lëshua në korrik 1999.¹⁵¹ Mbrojtja parashtron gjithashtu se në jurisprudencën e TPNJ-së dhe të TPNR-së nuk kishte përkufizim përputhës të NKP-së, kështu që ajo ngre një shqetësim lidhur me saktësinë e kërkuar nga parimi i ligjshmërisë.¹⁵² Në lidhje me NKP III, Mbrojtja shton se koncepti i përgjegjësisë penale për krime që dalin jashtë fushëveprimit të planit të përbashkët, por që kanë qenë të parashikueshme, nuk njihet në të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtën e Kosovës në kohën e kryerjes së krimeve.¹⁵³

56. Sa i takon parimit *in dubio pro reo*, Mbrojtja parashtron se neni 16(1)(a) i Ligjit duhet të interpretohet në favor të të akuzuarit dhe nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të tij, përmes përfshirjes së përgjegjësisë penale për NKP-në.¹⁵⁴ Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se NKP III nuk mund të përfshihet në kuptimin e

¹⁴⁹ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 43-48.

¹⁵⁰ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 70-71; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 50.

¹⁵¹ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 72-73; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 50-54.

¹⁵² Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 65.

¹⁵³ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 50-54.

¹⁵⁴ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 19-20; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 95.

fjalës “kryer” ose “ndihmuar dhe inkurajuar në nenin 16(1)(a) të Ligjit dhe se një përpjekje e tillë do të ishte një interpretim në dëm të të akuzuarit.¹⁵⁵

57. Sa i takon parimit *lex mitior*, Mbrojtja mbështet mendimin se edhe nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se NKP III ekzistonte në të drejtën zakonore ndërkombëtare gjatë periudhës së mbuluar nga Aktakuza, ai duhet të marrë parasysh ecurinë dhe zhvillimin e ligjit që prodhon një rezultat më të favorshëm për të akuzuarin.¹⁵⁶ Mbrojtja parashtrohet se miratimi i Statutit të GJPN-së, përparësia e bashkëkryerjes si formë përgjegjësie, vendimi i Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe në çështjen *R v. Jogee* të gjitha provojnë refuzimin e NKP III.¹⁵⁷

58. Sa i takon parimit të fajësisë, Mbrojtja parashtrohet se NKP III është një formë përgjegjësie penale që rrezikon parimin e përgjegjësisë dhe fajësisë individuale përmes formës kolektive të përgjegjësisë apo fajësisë për shkak të anëtarësisë.¹⁵⁸

59. Lidhur me krimet me synim konkret, Mbrojtja parashtrohet se vetëm TPNJ-ja mendonte se NKP III mund t’u bashkëngjitej krimeve të tilla dhe se Tribunali Special për Libanin (“TSL”) dhe GJSSL-ja janë larguar nga një qëndrim i tillë.¹⁵⁹

2. Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në

60. Sa i takon nenit 16(1)(a) të Ligjit, ZPS-ja përgjigjet se NKP-ja ekziston në kornizën ligjore të DHS-së, duke qenë se ky nen është faktikisht i njëjtë me statutet e TPNJ-së, TPNR-së, Mekanizmit Përmbyllës Ndërkombëtar të Tribunalëve Penalë (“MPNTP”), DHSSL-së dhe DHJGJK-së.¹⁶⁰ ZPS-ja parashtrohet më tej se në kohën e miratimit të Ligjit më 2015, secila prej gjykatave të lartpërmendura kishte konstatuar në mënyrë

¹⁵⁵ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 22.

¹⁵⁶ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 115.

¹⁵⁷ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 117-119.

¹⁵⁸ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 67; Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 33-36.

¹⁵⁹ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 106-114.

¹⁶⁰ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 14.

përputhëse se “kryerja” sipas kuptimit të statuteve të tyre e përfshinte NKP-në.¹⁶¹ Sipas ZPS-së, hartuesit e Ligjit ishin të lirë t’i formulonin format e zbatueshme të përgjegjesisë penale si të donin, por zgjodhën të njëjtin formulim me statutet e lartpërmendura. Po të kishin dashur të devijonin prej tij, do të ishin deklaruar konkretisht për këtë.¹⁶² ZPS-ja parashtron më tej se Ligji duhet të veprojë ndaj të gjithë kryesve, përfshirë ata që morën pjesë bashkërisht apo në grup në kryerjen e pretenduar të krimeve të rënda.¹⁶³

61. Lidhur me të drejtën penale të Kosovës, ZPS-ja përgjigjet se përgjegjësia penale për NKP-në është zbatuar në gjykatat e Kosovës që kanë gjykuar kryerjen e krimeve të luftës gjatë të njëjtës periudhë të krimeve që paraqiten në Aktakuzë.¹⁶⁴ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Gjykata Supreme e Kosovës e ka konfirmuar NKP-në si formë përgjegjësie penale.¹⁶⁵

62. Sa i takon të drejtës zakonore ndërkombëtare, ZPS-ja përgjigjet se përgjegjësia penale për NPK-në ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë të gjithë kohës që lidhej me Aktakuzën dhe statusi i saj zakonor është konfirmuar nga TPNJ-ja, TPNR-ja, GJSSL-ja, TSL-ja dhe DHJGJK-ja.¹⁶⁶ ZPS-ja parashtron se Karta e Nurembergut, CCL10 dhe jurisprudenca pas Luftës së Dytë Botërore tregojnë se personat e akuzuar u dënuan për krime ndërkombëtare mbi bazën e kontributeve të tyre për një qëllim të përbashkët apo projekt të përbashkët. ZPS-ja parashtron se edhe nëse këto burime nuk trajtojnë forma konkrete të përgjegjesisë penale, apo nuk përdorin terminologjinë e NKP-së, parimi i ligjshmërisë nuk kërkon një shkallë të tillë saktësie.¹⁶⁷ ZPS-ja gjithashtu paraqet një numër çështjesh pas Luftës së Dytë Botërore

¹⁶¹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 14.

¹⁶² Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 15.

¹⁶³ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 17-20.

¹⁶⁴ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 121.

¹⁶⁵ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 121.

¹⁶⁶ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 26-121.

¹⁶⁷ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 27-29.

që evidentojnë zbatimin e NKP I dhe NKP III.¹⁶⁸ ZPS-ja parashtron gjithashtu se parimet e Kartës së Nurembergut dhe Aktgjykimi i Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar u konfirmuan nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Rezolutën 95(I) të 1946 dhe se praktika gjyqësore pas Luftës së Dytë Botërore është njohur si burim i të drejtës zakonore ndërkombëtare nga tribunalët ndërkombëtarë.¹⁶⁹ ZPS-ja parashtron gjithashtu se dispozitat e Statutit të GJPN-së lidhur me bashkëkryerjen nuk kanë lidhje me kornizën ligjore të DHS-së.¹⁷⁰

63. Sa i takon parashikueshmërisë dhe disponueshmërisë, ZPS-ja përgjigjet se parimi i ligjshmërisë nuk kërkon një shkallë të lartë saktësie, por vetëm që një i akuzuar të jetë në gjendje të vlerësojë se sjellja e tij është kriminale në kuptimin e përgjithshëm.¹⁷¹ ZPS-ja parashtron më tej se veçantia e të drejtës ndërkombëtare duhet të merret parasysh në vlerësimin e kritereve për parashikueshmëri dhe disponueshmëri dhe se duhen shqyrtuar burime të ndryshme ligjore, përfshirë legjislacionin vendor.¹⁷² ZPS-ja vlerëson se, sikurse është konstatuar nga Dhoma e Apelit e TPNJ-së, neni 26 i Kodit Penal të RSFJ-së ka ngjashmëri të madhe me NKP-në.¹⁷³ ZPS-ja parashtron gjithashtu se nenet 11 dhe 13 të Kodit Penal të RSFJ-së përmbajnë synim kriminal të ngjashëm me përgjegjësinë penale për NKP III.¹⁷⁴ ZPS-ja shton se pesha e krimeve në diskutim mund të rrëzojë çdo pretendim të Mbrojtjes për mungesë dijenie lidhur me veprimet kriminale për të cilat akuzohen ata.¹⁷⁵

64. Sa i takon parimit *in dubio pro reo*, ZPS-ja përgjigjet se nuk ekziston ndonjë dyshim i arsyeshëm i cili do të përlligjte zbatimin e këtij parimi kur Ligji interpretohet në kontekst.¹⁷⁶

¹⁶⁸ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 44-93.

¹⁶⁹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 94-100.

¹⁷⁰ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 101-105.

¹⁷¹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 122-124.

¹⁷² Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 126-129.

¹⁷³ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 130-131.

¹⁷⁴ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 132-133.

¹⁷⁵ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 134.

¹⁷⁶ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 23-25.

65. Për parimin *lex mitior*, ZPS-ja parashtron se as dispozitat e Statutit të TPNJ-së, dhe as vendimet e Dhomave të TPNJ-së nuk janë materiale për juridiksionin e DHS-së lidhur me format e zbatueshme të përgjegjesisë penale.¹⁷⁷

66. Sa i takon parimit të fajësisë, ZPS-ja përgjigjet se argumenti i Mbrojtjes nuk qëndron, sepse nuk pranon kriterin themelor të NKP-së, pjesëmarrjen e domosdoshme të të akuzuarit në të.¹⁷⁸

67. Në lidhje me zbatueshmërinë e NKP III për krimet me synim konkret, ZPS-ja parashtron se, ndërsa përfundimi i Mbrojtjes është i pasaktë, ky argument nuk përbën kundërshtim lidhur me juridiksionin, sepse nuk ngre temën e mungesës së juridiksionit për një krim apo formë të caktuar përgjegjësie penale, por është më shumë një temë për t'u trajtuar gjatë gjykimit.¹⁷⁹

3. Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me NKP-në

68. Sa i takon nenit 16(1)(a) të Ligjit, Mbrojtja kundërpërgjigjet se, në dijëni të plotë të shkallës dhe kritikave të vazhdueshme ndaj NKP-së, hartuesit e Ligjit qëllimisht e formuluan këtë nen në mënyrë shteruese dhe parimi *expressio unius est exclusio alterius* e dobëson qëndrimin e ZPS-së.¹⁸⁰ Mbrojtja është e mendimit se argumenti i ZPS-së se hartuesit duhej ta kishin modifikuar formulimin e nenit 16(1)(a) të Ligjit po të kishin dashur ta përjashtonin NKP-në, nuk është logjik, duke pasur parasysh se rregulla e paraqitur në nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të KEDNJ-së ndalon çdo lloj interpretimi nëpërmjet analogjisë, në dëm të të akuzuarit.¹⁸¹ Mbrojtja parashtron gjithashtu se Ligji ndërkohë parashikon forma të tjera përgjegjësie penale, për të

¹⁷⁷ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 104-105.

¹⁷⁸ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 118.

¹⁷⁹ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me NKP-në, para. 9.

¹⁸⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 13-16.

¹⁸¹ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 34.

mundësuar ndjekjen penale të personave të tjerë që nuk janë kryes fizik të një krimi konkret, për ndihmë apo inkurajim, nxitje apo urdhërim të kryerjes së krimit.¹⁸²

69. Lidhur me të drejtën penale të Kosovës, Mbrojtja kundërpërgjigjet se ZPS-ja i ka shpërfillur vendimet e mëvonshme të Kosovës të cilat e hedhin poshtë NKP-në dhe se rastet e cituara nga ZPS-ja pasqyrojnë mendimin e pakicës.¹⁸³ Mbrojtja parashtron se termi “kryerje” duhet të interpretohet sipas legjislacionit të Kosovës dhe se ai është vetëm për bashkëkryerjen.¹⁸⁴ Mbrojtja parashtron më tej se Aktgjykimi i GJK-së serbe i vitit 2020 vlen edhe për NKP-në, në kuptimin që asnjë nga format e saj nuk ishte pjesë e legjislacionit të Kosovës në kohën e krimeve të pretenduara.

70. Sa i takon të drejtës zakonore ndërkombëtare, Mbrojtja përsërit disa nga argumentet e saj në kundërpërgjigjet përkatëse dhe beson se të gjitha çështjet mbi të cilat është mbështetur ZPS-ja për të provuar zbatimin e NKP III janë hedhur poshtë nga DHJGJK-ja si jobindëse ose pa lidhje.¹⁸⁵ Mbrojtja parashtron më tej se vendimet e tribunalëve ndërkombëtarë të lëshuara pas fakteve të Aktakuzës nuk mund të përdoren si prova të së drejtës zakonore ndërkombëtare për të provuar ekzistencën e NKP-së në atë kohë.¹⁸⁶ Mbrojtja parashtron gjithashtu se mund të thuhet se Statuti i GJPN-së shpreh *opinio juris* të shteteve që e mbështesin atë.¹⁸⁷

71. Sa i takon parashikueshmërisë dhe disponueshmërisë, Mbrojtja kundërpërgjigjet se përmendja prej ZPS-së e peshës së krimeve nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe se ajo që ka rëndësi është nëse përgjegjësia për këto krime në bazë të NKP-së do të ishte

¹⁸² Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 22; Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 10-11.

¹⁸³ Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 32-36; Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 41.

¹⁸⁴ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 24-26.

¹⁸⁵ Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 48-54, 61-67; Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 13-41; Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 17-23; Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 37.

¹⁸⁶ Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 60.

¹⁸⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 24-25.

e parashikueshme.¹⁸⁸ Mbrojtja parashtron më tej se mbështetja e ZPS-së në nenin 26 të Kodit Penal të RSFJ-së është e gabuar, duke qenë se ajo dispozitë u interpretua si bazë për përgjegjësi penale vetëm për krimet e kryera brenda kornizës së projektit kriminal, duke qenë kështu më e ngushtë se NKP III.¹⁸⁹ Mbrojtja parashtron gjithashtu se neni 22 i Kodit Penal të RSFJ-së është dispozita më e përgjithshme që parashikon fajësimin për përgjegjësi penale të anëtarëve të një grupi, mirëpo nuk ka bazë për të pretenduar se kjo dispozitë demonstroi se përgjegjësia penale për NKP III ishte mjaftueshëm e parashikueshme për të akuzuarit në kohën e krimeve të pretenduara.¹⁹⁰ Gjithashtu Mbrojtja i referohet pretendimit të ZPS-së se gjykatat ndërkombëtare që zbatojnë të drejtën ndërkombëtare mund të marrin parasysh se në përdorimin e terminologjisë duhet të lejohet fleksibilitet, por kjo ndalohej kategorikisht nga Kushtetuta e cila kërkon që të gjitha ligjet penale duhet të përfshihen përmes akteve ligjore të miratuara.¹⁹¹

72. Në lidhje me parimet *in dubio pro reo*, *lex mitior* dhe të fajësisë, Mbrojtja përsërit argumentet e saj në kundërpërgjigje.¹⁹² Sa u takon krimeve me synim konkret, Mbrojtja kundërpërgjigjet se aspekti nëse për një krim të përfshirë si akuzë, mund të zbatohet një formë përgjegjësie penale, është juridiksional dhe hyn në fushëveprimin e rregullës 97(1)(a) të Rregullores.¹⁹³

¹⁸⁸ Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 39.

¹⁸⁹ Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 44-47; Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 27.

¹⁹⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 28.

¹⁹¹ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 42.

¹⁹² Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para 12; Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 14, 35-36; Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 38.

¹⁹³ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 46-47.

F. PËRGJEGJËSIA EPRORE

1. Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin

73. Mbrojtja parashtron se DHS-ja nuk ka juridiksion për të bërë të zbatueshme përgjegjësinë eprore, sepse e drejta shtetërore në fuqi gjatë konfliktit të armatosur nuk e njihë përgjegjësinë eprore si formë përgjegjësie.¹⁹⁴ Mbrojtja parashtron gjithashtu se edhe nëse do të konstatohej se e drejta zakonore ndërkombëtare është e zbatueshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përsëri do të ishte i detyruar të shqyrtonte nëse e drejta ndërkombëtare apo e drejta e brendshme do të prodhonte një rezultat shumë më të favorshëm për të akuzuarit dhe do të zbatonte një standard më të butë.¹⁹⁵ Mbrojtja beson se e drejta në fuqi në atë kohë e Kosovës nuk e njihë përgjegjësinë eprore dhe në vend të saj duhet të zbatohet një formë kryerjeje përmes mosveprimit, e përfshirë në nenin 30(2) të Kodit Penal të RSFJ-së.¹⁹⁶ Mbrojtja parashtron më tej se, si rrjedhojë e zhvillimeve më të fundit ligjore dhe jurisprudencës, nocioni i përgjegjësisë eprore ka evoluar drejt një koncepti që është më në pajtim me parimin e ligjshmërisë.¹⁹⁷

2. Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në

74. ZPS-ja përgjigjet se përgjegjësia eprore është formë përgjegjësie e njohur në të drejtën zakonore ndërkombëtare më 1998 dhe se nuk është e nevojshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të zbatojë format e përgjegjësisë të RSFJ-së apo t'i krahasojë ato me të drejtën zakonore ndërkombëtare, duke qenë se kjo e dyta zbatohet në DHS. ZPS-ja parashtron më tej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të hedhë poshtë kundërshtimin e Mbrojtjes lidhur me përgjegjësinë eprore, duke qenë se argumentet e mbetura kanë të bëjnë me konturet e doktrinës së përgjegjësisë eprore dhe nuk

¹⁹⁴ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 35-36.

¹⁹⁵ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 36, 120, 124.

¹⁹⁶ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 121-122.

¹⁹⁷ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 125-130.

përbëjnë kundërshtim në lidhje me juridiksionin sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores.¹⁹⁸

3. Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në

75. Mbrojtja përsërit argumentet e saj në kundërpërgjigje dhe shton se është detyrë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të përcaktojë pa mëdyshje statusin “modern” të përgjegjësisë komanduese në të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe ta krahasojë atë me çdo ligj shtetëror për përgjegjësinë komanduese, e në këtë mënyrë të përcaktojë se cila është më mirë për të akuzuarit.¹⁹⁹

III. DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE

76. Sipas rregullës 97(1) të Rregullores, i akuzuari mund të paraqesë mocione paraprake që nuk njohin juridiksion e DHS-së, pretendojnë mangësi në formën e Aktakuzës dhe kërkojnë veçimin e akuzave sipas rregullës 89(2).

A. ZBATUESHMËRIA E TË DREJTËS ZAKONORE NDËRKOMBËTARE

77. Sipas nenit 22 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara në marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të mëposhtme garantohen nga kjo Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe, në rast konflikti, kanë epërsi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: [...] (2) KEDNJ; (3) KNDCP [...].

78. Sipas nenit 33 të Kushtetutës,

¹⁹⁸ Përgjigjja e ZPS-së lidhur me DZN-në, para. 36-47.

¹⁹⁹ Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me DZN-në, para. 36-40.

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare përbënin gjenocid, krime lufte, krime kundër njerëzimit.
 2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër se sa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.
 3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.
 4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.
79. Sipas nenit 3(2) të Ligjit, DHS-ja gjykon dhe funksionon në përputhje me,
- a. Kushtetutën e të Republikës së Kosovës,
 - b. këtë ligj si *lex specialis*,
 - c. dispozitat e tjera ligjore të Kosovës të përfshira shprehimisht në këtë ligj dhe të zbatuara nga ky ligj,
 - d. të drejtën zakonore ndërkombëtare, të cilës i është dhënë përparësi përkundrejt ligjeve vendase nga neni 19(2) i Kushtetutës, dhe
 - e. të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që përcakton standardet e drejtësisë penale përfshirë KEDNJ-në dhe KNDCP, të cilave u është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendore nga neni 22 i Kushtetutës.
80. Sipas nenit 12 të Ligjit, DHS-ja zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës nëse është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare, që kanë qenë të zbatueshme në kohën e kryerjes së krimeve, në pajtim me nenin 7(2) të KEDNJ-së dhe nenin 15(2) të KNDCP-së, të përfshira dhe të mbrojtura nga nenet 19(2), 22(2), 22(3) dhe 33(1) të Kushtetutës.

B. RAPORTI I KËSHILLIT TË EVROPËS

81. Sipas nenit 162(1) të Kushtetutës, për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Raportin e Këshillit të Evropës, Republika e Kosovës mund të themelojë DHS-në dhe një ZPS në kuadër të sistemit të drejtësisë së Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i DHS-së dhe ZPS-së rregullohen nga neni 162 i Kushtetutës dhe një ligj i posaçëm.

82. Sipas nenit 1(2) të Ligjit, DHS-ja brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe ZPS-ja janë të domosdoshme për të përmbushur obligimet ndërkombëtare të parapara në Ligjin nr. 04/L-274, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë si dhe për garantimin e procedurave penale në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, krime të cilat janë raportuar në Raportin e Këshillit të Evropës dhe të cilat janë objekt i hetimeve penale të kryera nga TFHS-ja.

83. Sipas nenit 6(1) të Ligjit, DHS-ja ka juridiksion mbi krimet e parapara në nenet 12-16 që kanë të bëjnë me Raportin e Këshillit të Evropës.

C. NDALIMI ARBITRAR

84. Sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, për qëllimet e këtij ligji, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të DHS-së, me krime të luftës nënkuptohen: [...]në rast të ndonjë konflikti të armatosur që nuk është i karakterit ndërkombëtar, shkeljet e rënda të nenit 3, duke i përfshirë veprat në vijim të kryera kundër personave që nuk janë pjesë aktive e luftimeve, përfshirë kundër pjesëtarëve të forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe atyre që janë kanë dalë jashtë luftimit për shkak të sëmundjeve, plagëve, paraburgimit apo ndonjë arsyeje tjetër [...].

D. ZHĐUKJA ME FORCË E PERSONAVE

85. Sipas nenit 13(1)(i) të Ligjit, për qëllimet e këtij Ligji, në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara, krime kundër njerëzimit janë veprat e paraqitura në vijim, kur ato kryhen si pjesë e ndonjë sulmi të gjerë ose sistematik të drejtuar kundër popullatës civile, duke qenë në dijeni: [...] zhdukja me forcë e personave [...].

E. NDËRMARRJA KRIMINALE E PËRBASHKËT

86. Sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, për krimet nga nenet 13-14 të Ligjit, personi i cili ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer, ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndihmuar dhe ka dhënë mbështetje për planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e këtij krimi, mban përgjegjësi individuale për krimin.

F. PËRGJEGJËSIA EPRORE

87. Sipas nenit 16(1)(c) i Ligjit, për krimet nga nenet 13-14 të Ligjit, fakti që ndonjëri prej veprimeve ose mosveprimeve është kryer nga një vartës nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale, në rast se ai e ka ditur apo ka pasur arsye ta dijë se vartësi kishte ndërmend t'i kryente ato veprime ose i kishte kryer dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për t'i parandaluar ato veprime, ose për t'i dënuar kryesit e tyre.

IV. DISKUTIM

A. ZBATUESHMËRIA E TË DREJTËS ZAKONORE NDËRKOMBËTARE

1. Burimet ligjore të zbatueshme në DHS

88. Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh se kundërshtimi i Veselit lidhur me të drejtën zakonore ndërkombëtare ka të bëjë me pyetjen nëse cili burim (ose cilat

burime) ligjor (ose ligjore) është (ose janë) i zbatueshëm (ose të zbatueshme) në DHS – e drejta zakonore ndërkombëtare, e drejta vendore, ose një kombinim i të dyjave - në gjykimin e krimeve nën juridiksionin e vet. Më konkretisht, argumentet e Mbrojtjes lidhen me të drejtën e zbatueshme kundrejt të cilit do të vlerësohet parimi i ligjshmërisë.

89. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, ndonëse Ligji është objekt i parimeve dhe garancive të parashikuara në Kushtetutë, ai është teksti kryesor juridik që rregullon mandatin dhe funksionimin e DHS-së dhe përmban edhe dispozita penale konkrete. Kjo pasqyrohet qartësisht në nenin 3(2) të Ligjit i cili, duke përcaktuar burimet ligjore të zbatueshme në DHS, si edhe lidhjen e tyre, tregon se Ligji është *lex specialis*. Si rrjedhojë, neni 3(2) i Ligjit kushtëzon se DHS-ja gjykon dhe funksionon në pajtim me:

- a. Kushtetutën;
- b. Ligjin, si *lex specialis*;
- c. dispozitat e tjera të ligjeve të Kosovës të përfshira shprehimisht në këtë Ligj dhe të zbatuara nga ky Ligj;
- d. të drejtën zakonore ndërkombëtare, të cilës i është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendore nga neni 19(2) i Kushtetutës; dhe
- e. të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilës i është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendore nga neni 22 i Kushtetutës.

2. A e shkel neni 12 i Ligjit parimin e mosprapaveprueshmërisë

90. Megjithëse Ligji është *lex specialis* lidhur me mandatin dhe funksionimin e DHS-së, zbatimi i tij, përfshirë mbështetjen në të drejtën zakonore ndërkombëtare, gjithsesi duhet të jetë në pajtim me garancitë kushtetuese, në veçanti, me dispozitën mbi

mosprapaveprueshmërinë, mishëruar në nenin 33 të Kushtetutës, nenin 7 të KEDNJ-së,²⁰⁰ dhe nenin 15 të KNDCP-së.²⁰¹

91. Neni 12 i Ligjit, i cili përfshihet në Kapitullin III, titulluar “Juridiksioni dhe ligji i zbatueshëm”, është dispozita qendrore që përcakton kornizën ligjore për shqyrtimin nëse akuzat e ngritura nga ZPS-ja pajtohen me parimin e ligjshmërisë dhe, përmes analogjisë, nëse përfshihen ligjërisht në juridiksionin e DHS-së. Gjuha e qartë e nenit 12 të Ligjit përcakton të drejtën zakonore ndërkombëtare si burim referimi, duke specifikuar se e drejta penale materiale e Kosovës zbatohet *vetëm përderisa është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare*. Rëndësia themelore e të drejtës zakonore ndërkombëtare konfirmohet nga përmendje të tjera të këtij burimi ligjor, kryesisht në nenet 3(2)(d), 3(2)(3), 13 dhe 14 të Ligjit, kundrejt rolit dytësor të së drejtës vendore (shih nenet 3(4) dhe 12 të Ligjit).

92. Mbrojtja e Veselit parashtrohet se neni 33 i Kushtetutës, së bashku me nenin 7 të KEDNJ-së, e ndalojnë DHS-në që të ushtrojë juridiksion për krime vetëm sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, përveçse kur këto krime kanë qenë të përfshira në të legjisllacionin jugosllav në fuqi në kohën e akuzave.

²⁰⁰ Neni 7 i KEDNJ-së parashtrohet si më poshtë:

1. Askush nuk shpallet fajtor për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës vendore ose ndërkombëtare. Po ashtu nuk jepet dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në kohën kur është kryer vepra penale.
2. Ky nen nuk paragjykon gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, cilësohet vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

²⁰¹ Neni 15 i KNDCP-së parashtrohet si më poshtë:

1. Askush nuk shpallet fajtor për veprime ose mosveprime të cilat nuk kanë qenë vepra penale sipas të drejtës shtetërore ose ndërkombëtare në kohën kur janë kryer. Po ashtu nuk jepet dënim më i rëndë se ai që mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale. Në qoftë se më vonë, pas kryerjes së vepërve penale, ligji parashikon një dënim më të lehtë, kryesi përfiton nga kjo.
2. Ky nen nuk paragjykon gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, cilësohet vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga bashkësia e kombeve.

93. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se dy pjesët përbërëse të nenit 7 të KEDNJ-së mund të lexohen dhe interpretohen vetëm së bashku dhe në mënyrë përfundimtare, sepse plotësojnë njëra-tjetrën.²⁰² Në këtë këndvështrim, neni 7(1) i KEDNJ-së përcakton rregullën e përgjithshme të mosprapaveprueshmërisë, ndërsa neni 7(2) i KEDNJ-së është thjesht një sqarim kontekstual i paragrafit të parë, i cili u përfshi kryesisht për të mbrojtur vlefshmërinë pas Luftës së Dytë Botërore, të procedimeve penale të krimeve të kryera gjatë atij konflikti të armatosur.²⁰³ Si pasojë, interpretimi ligjor i nenit 7 të KEDNJ-së nënkupton se nëse një veprim apo mosveprim përbën, sipas nenit 7(1) të KEDNJ-së, një vepër penale sipas “të drejtës ndërkombëtare”, e cila përfshin si të drejtën e traktateve, ashtu dhe të drejtën zakonore ndërkombëtare, nuk është e nevojshme të bëhet një vlerësim sipas nenit 7(2) të Konventës.²⁰⁴

94. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykatësit të Procedurës Paraprake i duhet të pajtojë përmendjen e nenit 7(2) të KEDNJ-së në nenin 12 të Ligjit, me ndalimin e mosprapaveprueshmërisë të së drejtës penale dhe përjashtimet e saj që parashikohen në Kushtetutë dhe KEDNJ, duke synuar dhënien e një interpretimi të efektshëm të kornizës ligjore në tërësi. Lidhur me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se përmendja e nenit 7(2) të KEDNJ-së në nenin 12 të Ligjit nuk e pengon DHS-në të mbështetet në të drejtën zakonore ndërkombëtare si burim i penalizmit të një sjellje konkrete, duke qenë se e gjithë dispozita e nenit 7 të KEDNJ-së, si edhe Konventa në tërësinë e vet, janë gjithsesi të zbatueshme para DHS-së për shkak të nenit 22 të Kushtetutës. Për këtë arsye, interpretimi më i përshtatshëm është se përmendja e nenit 7(2) të KEDNJ-së në nenin 12 të Ligjit, përfshin nenin 7 të KEDNJ-së në tërësinë e tij, pra, të gjithë konceptin e parimit të mosprapaveprueshmërisë të kuptuar si duhet

²⁰² ECtHR, *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC] (“*Vasiliauskas v. Lithuania* [GC]”), nr. 35343/05, [Judgement](#), 20 October 2015, para. 188-189.

²⁰³ ECtHR, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina* [GC], nr. 2312/08 and 34179/08, [Judgement](#), 13 July 2013, para. 72.

²⁰⁴ ECtHR, *Kononov v. Latvia* [GC] (“*Kononov v. Latvia* [GC]”), nr. 36376/04, [Judgement](#), 17 May 2010, para. 244-246.

sipas asaj dispozite dhe, për rrjedhojë, sipas nenit 33(1) të Kushtetutës (i cili pasqyron nenin 7 të KEDNJ-së). Në fakt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se vetë neni 12 i Ligjit vendos një lidhje me nenet 22 dhe 33(1) të Kushtetutës, duke anuar në favor të një interpretimi më logjik dhe gjithëpërfshirës të nenit 12 të Ligjit, i cili merr parasysh instrumentet e zbatueshme të të drejtave të njeriut. Nga sa më lart, del se në vlerësimin e parimit të ligjshmërisë, DHS-ja duhet të zbatojë nenin 7 të KEDNJ-së në tërësinë e vet dhe se si rrjedhojë, e drejta zakonore ndërkombëtare mund të konsiderohet si një burim i lejueshëm i penalizimit. Në këtë kuptim, argumenti i Mbrojtjes se neni 7(2) i KEDNJ-së ka dalë nga përdorimi, është i tepërt dhe rrëzohet. Gjithsesi, për sqarimin e parimit të ligjshmërisë në secilën rrethanë konkrete, është e nevojshme që DHS-ja të fillojë shqyrtimin e saj duke u nisur nga neni 7(1) i KEDNJ-së.

95. E njëjta gjë mund të thuhet për përmendjen në nenin 12 të Ligjit të nenit 15(2) të KNDCP-së, i cili në fakt vendos të njëjtat konture për parimin e mosprapaveprueshmërisë dhe, rrjedhimisht, duhet interpretuar se i referohet asaj dispozite në tërësinë e vet, duke përfshirë mundësinë për t'u mbështetur në të drejtën zakonore ndërkombëtare si një burim penalizimi. Gjithsesi, në sajë të nenit 22 të Kushtetutës, si neni 15 i KNDCP-së, po ashtu edhe KNDCP-ja në tërësinë e vet janë të zbatueshëm në DHS.

96. Për mendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, interpretimi i mësipërm i ndërveprimit midis nenit 12 të Ligjit, Kushtetutës dhe instrumenteve të zbatueshme të të drejtave të njeriut, është i vetmi interpretim që pajton të gjitha dispozitat përkatëse në diskutim, duke u dhënë atyre një efekt të dobishëm (*effet utile*) dhe si rrjedhojë duke i dhënë kuptim rendit juridik (vendor dhe ndërkombëtar) ku përfshihet DHS-ja.

97. Argumentet e Mbrojtjes së Veselit në lidhje me zbatueshmërinë e të drejtës vendore burojnë nga sugjerimi se DHS-ja është gjykatë vendore dhe se, rrjedhimisht, ajo mund të zbatojë vetëm të drejtën vendore që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se

Aktgjykimi i GJK-së serbe i vitit 2020, së bashku me Opinionin Ekspert, ofrojnë orientim ligjor përcaktues lidhur me fushëveprimin e të drejtës penale (vendore) të zbatueshme për krime nën juridiksionin e DHS-së dhe ndalimin kushtetues për të mbajtur dikë përgjegjës për krime vetëm sipas të drejtës ndërkombëtare, të patranspozuar shprehimisht në të drejtën vendore të kodifikuar, e zbatueshme në Kosovë në kohën e kryerjes së tyre.

98. Për mendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kategorizimi i një gjykate si vendore, ndërkombëtare, hibride, apo ndryshe, nuk përcakton ligjin që ajo zbaton në gjykimin e çështjeve gjyqësore. Në rastin e DHS-së, ligjvënësit kosovarë ngritën një gjykatë të specializuar sipas kuptimit të nenit 103(7) të Kushtetutës, në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës që dalin nga Shkëmbimi i Letrave.²⁰⁵ Si rrjedhojë, ligjvënësit kosovarë vendosën t'i jepnin DHS-së një burim konkret ligjor të zbatueshëm, sikurse pasqyrohet në nenin 3(2) të Ligjit.

99. Sikurse diskutohet më lart, burimi ligjor i zbatueshëm i zgjedhur nga ligjvënësit kosovarë për DHS-në përfshin, së pari, të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe, së dyti, të drejtën e Kosovës vetëm nëse ajo është e përfshirë shprehimisht në Ligj, siç kushtëzohet nga neni 3(2)(c) dhe (4) i Ligjit. E drejta vendore e përmendur në Ligj mund të zbatohet drejtpërdrejt për krime sipas nenit 15 të Ligjit, ndërsa për krime ndërkombëtare mund të zbatohet sipas nenit 13 dhe 14 të Ligjit vetëm nëse është në pajtim me të drejtën zakonore ndërkombëtare, siç kushtëzohet në nenin 12 të Ligjit. Kjo do të thotë se Kushtetuta e RSFJ-së dhe Kodi Penal i RSFJ-së nuk e kufizojnë juridiksionin e DHS-së në mënyrën e sugjeruar nga Mbrojtja. Rrjedhimisht, për proceset penale në DHS, e drejta zakonore ndërkombëtare është dhe mbetet burimi parësor i të drejtës në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin.

²⁰⁵ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar me 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318 8 ("Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese")*, KO 26/15, Aktvendim, 15 prill 2015, publik, para. 37, 39.

100. Nga ky këndvështrim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizon se DHS-ja nuk është e detyruar të ndjekë precedentë juridikë nga juridiksionet e tjera dhe se interpretimi i dhënë në Aktgjykimin e GJK-së serbe të vitit 2020 nuk është detyruar për Gjykatësin e Procedurës Paraprake. E njëjta gjë vlen edhe për Opinionin Ekspert, i cili nuk ka forcë detyruese për DHS-në. Për më tepër, në kundërshtim me pretendimin e Mbrojtjes, është plotësisht e kuptueshme që në ushtrimin e autoritetit të tyre për të miratuar dhe zbatuar ligjet që ata i gjykojnë të përshtatshme, juridiksione të ndryshme, përfshirë juridiksionet që e kanë zanafillën nga i njëjti subjekt paraardhës, ndjekin penalisht persona që pretendohet se janë përgjegjës për krime të ndodhura gjatë të njëjtës periudhë konflikti të armatosur në bazë të ligjeve të ndryshme.

101. Duke marrë parasysh faktorët e lartpërmendur, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se thelbi i dispozitave të nenit 7 të KEDNJ-së dhe nenit 15 të KNDCP-së, të pasqyruara në nenin 33(1) të Kushtetutës, qëndron në autoritetin e ligjvënësve kosovarë për të miratuar ligjërisht ligje të cilat parashikojnë shprehimisht krime ndërkombëtare, të cilat ndërkohë kanë ekzistuar sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së tyre. Rrjedhimisht, ligjvënësi mund të lejojë – ose edhe të bëjë të detyrueshme – ndjekjen penale për veprime që kanë ndodhur përpara penalizimit të tyre në legjislacionin e kodifikuar vendor. Në këto raste, në fakt nuk bëhet fjalë për prapaveprueshmëri: ligjvënësi thjesht transponon (në të drejtën vendore të kodifikuar) krime që, sipas të drejtës ndërkombëtare, ndërkohë kanë qenë pjesë e rendit juridik detyruar për individët në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve të paraqitura në akuza.

102. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vjen në përfundimin se DHS-ja zbaton në çdo kohë të drejtën zakonore ndërkombëtare. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu nxjerr përfundimin se, përveç vetë Ligjit, asnjë ligj tjetër vendor nuk është i zbatueshëm në DHS, përveçse kur përfshihet shprehimisht në Ligj, sikurse parashikohet në nenin 3(2)(c) dhe (4) të Ligjit dhe, në lidhje me krimet sipas neneve 13

dhe 14 të Ligjit, vetëm në qoftë se legjislacioni vendor, apo pjesë të tij, janë në pajtim me të drejtën zakonore ndërkombëtare.

3. A ishte e drejta zakonore ndërkombëtare e disponueshme dhe e parashikueshme

103. Lidhur me disponueshmërinë dhe parashikueshmërinë e së drejtës zakonore ndërkombëtare për të akuzuarit në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se të gjithë të akuzuarit mbanin poste të larta në UÇK, me një numër të madh përgjegjësish dhe kompetencash, të cilat u mundësonin informacion dhe njohuri publike të larmishme.²⁰⁶

104. Në këtë kontekst dhe duke marrë parasysh kornizën ligjore të përgjithshme pas Luftës së Dytë Botërore,²⁰⁷ ndjekjet penale prej TPNJ-së në atë kohë,²⁰⁸ traktatet përkatëse ndërkombëtare të ratifikuara nga RSFJ-ja,²⁰⁹ dhe veprimet e ndaluara me ligj në Kodin Penal të RSFJ-së (disa prej të cilëve pasqyrojnë krimet e përfshira në akuzat),²¹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në periudhën përkatëse, për të akuzuarit ishte e disponueshme dhe e parashikueshme dijenia se sjellja bazë, për të cilën akuzohen, mund të përbënte krim sipas të drejtës ndërkombëtare dhe se përfshirja në një sjellje të tillë mund të rezultojë në përgjegjësi penale individuale.

²⁰⁶ Vendimi i Konfirmimit, para. 455-472.

²⁰⁷ Nuremberg Charter (aderuar nga RSFJ-ja më 29 shtator 1945), Article 6; CCL10, Article II; International Law Commission, Principles of International Law Recognized in the Charter of the Nürnberg Tribunal and the Judgement of the Tribunal, 1950, Principle II.

²⁰⁸ Sipas dokumenteve të disponueshme në faqen e Internetit të TPNJ-së , në kohën e akuzave të paraqitura në Aktakuzë po zhvilloheshin çështje gjyqësore kundër disa dhjetra personave.

²⁰⁹ *Shih*, Protocol Additional to the Geneva Conventions of 12 August 1949, and relating to the Protection of Victims of Non-International Armed Conflicts (Protocol II), 1125 UNTS 609, 8 qershor 1977 ("PSHII"); Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman, or Degrading Treatment or Punishment, 1465 UNTS 85, 10 dhjetor 1984; Convention on the Non-Applicability of Statutory Limitations to War Crimes and Crimes Against Humanity, 754 UNTS 73, 26 November 1968.

²¹⁰ Neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së përfshin, për shembull, vrasjen, torturën, trajtimin çnjerëzor dhe arrestimet dhe ndalimet e paligjshme.

4. Zbatueshmëria dhe fushëveprimi i parimit *lex mitior*

105. Lidhur me argumentet e Mbrojtjes së Veselit për parimin *lex mitior*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se parimi *lex mitior* zbatohet në DHS në sajë të nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së. Kjo ndodh vetëm për sa i përket të drejtës penale materiale kundrejt të drejtës procedurale, kështu që një ndryshim në të drejtën penale materiale me fuqi prapavepruese në dëm të të akuzuarit, përbën shkelje të dispozitave të mësipërme.²¹¹ Mbi bazën e të njëjtit argumentim, një i akuzuar përfiton nga një ndryshim i mëvonshëm në të drejtën penale materiale kur, ose sjellja e akuzuar pushon së qeni sjellje kriminale pasi ka ndodhur (*abolitio criminis*), ose kur elementet përbërëse të një krimi në lidhje me të cilin është ngritur akuzë dhe/ose forma e përgjegjësisë penale, ndryshohen në favor të të akuzuarit.²¹²

106. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se aspekti i zbatueshmërisë së një parimi të tillë nuk është me karakter juridiksional. Përkundrazi, ai ka të bëjë me identifikimin e duhur, në rast mospajtimi, të ligjit që duhet përdorur nga një panel si më i favorshëm për të akuzuarin.²¹³ Për më tepër, kjo nuk ka ndikim mbi pikat e debatuar këtu, sepse burimi i vetëm i mëvonshëm, i zbatueshëm, i të drejtës që mund të vlerësohet për të gjetur një ligj më të favorshëm, nëse ka, është e drejta zakonore ndërkombëtare, nëse do të evoluonte në favor të të akuzuarit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se e drejta zakonore ndërkombëtare, e cila është rrjedhojë e praktikës së shteteve shoqëruar me *opinio juris* përkatës,²¹⁴ mund të

²¹¹ ECtHR, *G. v. France*, nr. 15312/89, [Judgement](#), 21 September 1995, para. 26; *Coëme and Others v. Belgium*, nos. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 and 33210/96, [Judgement](#), 18 October 2000, para. 148-149; ECmHR, *X. v. the United Kingdom*, nr. 6683/74, *Decision*, 10 December 1975, f. 96.

²¹² ECtHR, *Scofield v. Italy*, nr. 10249/03, [Judgement](#), 17 September 2009, para. 109-110.

²¹³ *Shih po ashtu*, ICTY, *Prosecutor v. Nikolić*, IT-94-2-A, Appeals Chamber, [Judgement on Sentencing Appeal](#), 4 February 2005, para. 80.

²¹⁴ *Shih për shembull* ICJ, *Asylum Case (Colombia v. Peru)* (“Asylum Case”), I.C.J. Reports 1950 (p. 266), [Judgment](#), 20 November 1950, pp 14-15; *Fisheries Case (United Kingdom v. Norway)* (“Fisheries Case”), I.C.J. Reports 1951 (p. 116), [Judgment](#), 18 December 1951, p. 131; *North Sea Continental Shelf Case (Denmark/the Netherlands v. Federal Republic of Germany)* (“North Sea Continental Shelf Case”), I.C.J. Reports 1969 (p. 3), [Judgment](#), 20 February 1969, para. 77; *Continental Shelf Case (Libya v. Malta)* (“Continental Shelf Case”), I.C.J. Reports 1985 (p. 13), [Judgment](#), 3 June 1985, para. 27; *Case Concerning Military and Paramilitary Activities in and against Nicaragua (Nicaragua v. United States)* (“Nicaragua

evluojë me kohë, në dëm apo në të mirën e personit të akuzuar, duke nxitur potencialisht nevojën për të marrë parasysh dhe zbatuar rregullën më të favorshme të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes për këtë pikë rrëzohen.

B. RAPORTI I KËSHILLIT TË EVROPËS

1. Lidhja me Raportin e Këshillit të Evropës

(a) Formulimi i nenit 162(1) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Ligjit

107. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se përmendja e Raportit të Këshillit të Evropës në nenin 162(1) të Kushtetutës paraprihet nga fraza “në lidhje me”. Ky formulim mund të përkufizohet si “që kanë lidhje me, sa i takon”.²¹⁵ Në nenin 6(1) të Ligjit përmendja e Raportit të Këshillit të Evropës paraprihet nga fraza “kanë të bëjnë me”.²¹⁶ Ky term ka pothuaj të njëjtin kuptim, pra, “ndërlidhen apo kanë lidhje me diçka tjetër”.²¹⁷

108. Të marra së bashku, kuptimi i thjeshtë i këtyre formulimeve do të thotë se, në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së, duhet të ekzistojë një lidhje midis akuzave kundër një individi dhe Raportit. Megjithatë, për shkak të fushëveprimit të përgjithshëm të këtyre formulimeve, akuza të tilla nuk kanë pse të kufizohen vetëm në pretendimet që përmban konkretisht Raporti. Kjo do të përbënte një kufizim shumë të veçantë dhe,

Case”), I.C.J. Reports 1986 (p. 14), [Judgment](#), 27 June 1986, para. 183; *Jurisdictional Immunities of the State (Germany v. Italy)* (“Jurisdictional Immunities Case”), I.C.J. Reports 2012 (p. 99), [Judgment](#), 3 February 2012, para. 55.

²¹⁵ *Oxford English Dictionary*, [relation, n.](#), Oxford University Press 2021.

²¹⁶ Neni 1(2) i Ligjit po ashtu parashikon, në pjesën përkatëse, se DHS-ja si pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe ZPS-ja janë të domosdoshme për përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të parapara në Ligjin nr. 04/L-274, për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe për garantimin e procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. *Shih gjithashtu*, para. 120-121 në poshtë.

²¹⁷ *Oxford English Dictionary*, [related, adj. and n.](#), Oxford University Press 2021.

si i tillë, do të duhej të ishte pasqyruar përmes një formulimi konkret në Kushtetutë dhe Ligj.²¹⁸

109. Më tej, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i referohet fushëveprimit të dispozitave juridiksionale të Ligjit. DHS-ja ka juridiksion, ndër të tjera, për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krimesh lufte (juridiksioni lëndor).²¹⁹ Gjithashtu, DHS-ja ka juridiksion mbi krimet që përfshihen në juridiksionin e vet lëndor, të cilat u kryen nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000 (juridiksioni kohor) dhe të cilat ose janë filluar ose kryer në Kosovë (juridiksioni territorial).²²⁰ Së fundi, krahas, juridiksionit të vet territorial, DHS-ja ka juridiksion, ndër të tjera, ndaj personave që kanë kryer krime brenda juridiksionit lëndor kundër personave me shtetësi të Kosovës/RFJ-së-së kudo ku këto krime janë kryer (juridiksioni individual).²²¹

110. Të lexuara bashkë, këto dispozita padyshim e lejojnë DHS-në të ushtrojë juridiksionin e vet ndaj akuzave që mund të përfshijnë, por sigurisht mund të tejkalojnë, trafikimin e organeve dhe trajtimin çnjerëzor që pretendohet se ka ndodhur në qendrat e ndalimit në Shqipëri. Kjo do të thotë se interpretimi i termave “në lidhje me” dhe “kanë të bëjnë me” në kuadër të dispozitave të Ligjit për juridiksionin e mbështet edhe më tej përfundimin e nxjerrë më lart. Nëse, në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së, akuzat e ngritura kundër një individi do të duhej të kufizoheshin në pretendimet për trafikim organesh dhe trajtim çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri, siç pretendon Mbrojtja, një kufizim i tillë do të duhej të ishte pasqyruar në mënyrë përrputhëse në parametrat juridiksionalë të përcaktuar prej Ligjit. Kjo mospërrputhje nuk mund të shpjegohet me pretendimin se dispozitat juridiksionale janë më të gjera se sa përmendjet e Raportit të Këshillit të Evropës. Nëse përmendjet e

²¹⁸ Kjo mund të ishte shprehur, për shembull, me anë të një kushti që çdo ndryshim nuk duhet të tejkalojë pretendimet në formë akuzash për trafikim organesh dhe trajtim çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri.

²¹⁹ Ligji, nenet 6, 13 dhe 14.

²²⁰ Ligji, nenet 7 dhe 8.

²²¹ Ligji, neni 9(2).

Raportit të Këshillit të Evropës do të kishin efekt kufizues të pretenduar nga Mbrojtja, dispozitat për juridiksionin nuk do të mund të zbatoheshin për faktin se ato i tejkalojnë akuzat për trafikim organesh dhe trajtim çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri. Kjo do t'i bënte dispozitat juridiksionale pak a shumë të pakuptimta.

111. Nga kjo del se duke pasur parasysh kuptimin bazë të frazave “në lidhje me” dhe “që kanë të bëjnë me”, të interpretuara në kuadër të dispozitave juridiksionale të Ligjit, neni 162(1) i Kushtetutës dhe nenit 6(1) i Ligjit kërkojnë që, në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së, duhet të ekzistojë lidhje midis akuzave të ngritura ndaj një individi dhe Raportit të Këshillit të Evropës, por nuk kushtëzojnë që akuzat të tilla të kufizohen vetëm në pretendimet për trafikimin e organeve dhe trajtimin çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri. Mbi këtë bazë, është i drejtë interpretimi se në këto dispozita kërkohet që akuzat e ngritura kundër një individi në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së duhet të jenë të lidhura në masë të mjaftueshme me Raportin.²²² Duke marrë parasysh llojin e përfundimeve në Raportin e Këshillit të Evropës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se një lidhje e tillë mund të mbështetet, por jo të kufizohet, në faktorët e mëposhtëm të marrë së bashku: kryesit,²²³ viktimat,²²⁴

²²² Duke pasur parasysh ndryshimet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se GJPN-ja kërkon një lidhje të ngjashme midis një çështjeje dhe fushëveprimit të situatës së referuar, *shih*, ICC, *Prosecutor v. Callixte Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-1, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Prosecutor's Application for a Warrant of Arrest against Callixte Mbarushimana](#), 28 September 2010, para. 6; *Prosecutor v. Callixte Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-451, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the "Defence Challenge to the Jurisdiction of the Court"](#), 26 October 2011, para. 16.

²²³ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 5, 7, 58, 67, 68, 70, 72, 82, 84, 86, 95, 97, 98, 101, 102, 103, 104, 114, 129, 130 (që u referohen pjesëtarëve të UÇK-së si kryer të pretenduar të krimeve).

²²⁴ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 4, 14 (poshtëshënimet 11-12), 103, 111, 139, 144 (që përshkruan viktimat si persona me përkatësi etnike serbe dhe personat me përkatësi etnike shqiptare që konsiderohen si “tradhtarë” ose “bashkëpunëtorë” ose se kanë rënë viktimat të armiqësive të brendshme në UÇK).

vendndodhja (vendndodhjet),²²⁵ afati kohor,²²⁶ *modus operandi*,²²⁷ lloji i sjelljes,²²⁸ synimi i sjelljes,²²⁹ dhe rrethanat e sjelljes^{230, 231}. Ky vlerësim nuk mund të bëhet në bazë të një faktori të vetëm të marrë veçazi, por nevojitet shqyrtim nëse në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së, në rrethanat e secilës çështje, vlerësimi i gjithë këtyre faktorëve së bashku jep një lidhje të mjaftueshme midis akuzave të ngritura kundër një individi dhe Raportit të Këshillit të Evropës. Rrjedhimisht, nëse një lidhje e tillë mund të vërtetohet dhe nëse plotësohen parakushtet juridiksionale sipas neneve 6-9 dhe 12-16 të Ligjit, në ushtrimin e juridiksionit të vet, DHS-ja mund të kryejë procese lidhur me akuza që tejkalojnë pretendimet e diskutuara shprehimisht në Raport.

112. Rrjedhimisht, parashtrimet e Mbrojtjes bien ndesh me kuptimin bazë të nenit 162(1) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Ligjit, lexuar në kuadrin e dispozitave juridiksionale të Ligjit.²³² Rrjedhimisht, këto parashtrim hidhen poshtë.

²²⁵ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 36, 38, 72, 74, 85, 87, 105, 108, 115, 130, 144 (ku specifikohet se krimet e pretenduara kanë ndodhur në mbarë Kosovën dhe në disa pjesë të Shqipërisë).

²²⁶ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 4, 56, 72, 102, 129 (ku tregohet se krimet e pretenduara ndodhën duke filluar nga 1998 dhe vazhduan deri pas verës së 1999).

²²⁷ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 72, 74, 98, 137, 138, 153-155 (ku parashtrohet pretendimi se si UÇK-ja shënjestroi viktimat në mbarë Kosovën dhe në Shqipëri, ndër të tjera duke rrëmbyer apo ndaluar persona dhe duke i çuar ata në një rrjet objektësh ndalimi ku ata persona u morën në pyetje dhe/ose u keqtrajtuat).

²²⁸ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 13, 25, 26, 31, 35, 37, 45, 53, 73, 95, 104 (ku përshkruhet se krimet u kryen nga UÇK-ja si një aktor joshitetëror, e formuar në bazë të hierarkisë, besnikërive dhe kodeve të nderit që mbizotërojnë në strukturën klanore shqiptare dhe që mbante lidhje me krimin e organizuar dhe strukturat e shërbimeve të zbulimit në Shqipëri).

²²⁹ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 4, 129, 139 (ku konstatohet se krimet e pretenduara u kryen kundër individëve për shkak të, ndër të tjera, veprimtarive, besimeve dhe/ose përkatësive të tyre etnike).

²³⁰ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 4, 29, 89, 90, 95, 102, 103, 105, 106, 111, 139 (ku krimet e pretenduara trajtohen në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe praktikën dhe strategjinë e shënjestrimit të personave për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe/ose politike).

²³¹ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka marrë parasysh, *mutatis mutandis*, nenin 1 të Statutit të TSL-së, i cili parashikon faktorë të ngjashëm për vendosjen e lidhjes midis sulmit kryesor që është nën juridiksionin e vet, pra, synimin (motivin) kriminal, qëllimin e sulmeve, llojin e viktimave të shënjestruara, llojin e sulmeve (*modus operandi*) dhe kryesit.

²³² Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 9-10, 13-22, 28; Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), para. 4; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 57-60, 62, 67.

(b) Debatet në Kuvend

113. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se në mungesë të treguesve për debatet konkrete në Kuvend, pretendimi i Mbrojtjes lidhur me debate të tilla është i pafaktuar. Gjithashtu, duke qenë se TFHS-ja kishte bërë të njohur se nuk i kishte kufizuar hetimet e veta në akuzat e trafikimit të organeve dhe trajtimin çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri që përpara miratimit të Amendamentit Kushtetues nr. 24 dhe të Ligjit,²³³ Kuvendi do ta kishte përcaktuar konkretisht një kufizim të tillë, nëse do të kishte dashur ta bënte këtë.

114. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, pavarësisht nga baza ligjore konkrete mbi të cilën mbështetet një pretendim i tillë, Mbrojtja pranon se historia e hartimit mund të përdoret nëse dispozita në fjalë është e paqartë.²³⁴ Por, sikurse përcaktohet më lart, kuptimi i qartë i fjalëve “në lidhje me” dhe “që kanë të bëjnë me” në nenin 162(1) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Ligjit, interpretuar në kuadër të dispozitave juridiksionale të Ligjit, e përjashtojnë kufizimin e akuzave vetëm në pretendimet për trafikim organesh dhe trajtim çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri, duke shmangur kështu nevojën për përdorimin e historisë hartuese të tij.

115. Për këto arsye, pretendimet e Mbrojtjes hidhen poshtë.²³⁵

(c) Juridiksioni i TPNJ-së dhe gjykatave të tjera

116. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se TFHS-ja kishte mandat për të hetuar dhe, nëse përlligje, për të ndjekur penalisht persona për krime të pretenduara në

²³³ UN Security Council, [Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, Annex II](#), S/2014/558, 1 August 2014 (“UNMIK Report”).

²³⁴ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 29.

²³⁵ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 29-30; Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), para. 4.

Raportin e Këshillit të Evropës.²³⁶ Ishte e qartë se mandati i saj u përcaktua pavarësisht nga juridiksioni i TPNJ-së apo gjykatave në Kosovë. Po ashtu, as Amendamenti Kushtetues nr. 24, as Ligji nuk i referohet juridiksionit të TPNJ-së, ose gjykatave në Kosovë lidhur me parametrat juridiksionale të DHS-së.

117. Për më tepër, interpretuar në kuadër të nenit 17(b) dhe (c) të Ligjit, i cili parashtron se asnjë person nuk duhet të gjykohet para DHS-së për veprime për të cilat ai ose ajo është gjykuar ndërkohë nga një gjykatë në Kosovë ose nga TPNJ-ja, është e qartë se dispozitat juridiksionale të Ligjit nuk mund të interpretohen sikur përjashtojnë tërësisht përkimin me juridiksionin e TPNJ-së apo të ndonjë gjykate në Kosovë. Nëse përkimi nuk do kishte qenë i mundur, një dispozitë e tillë nuk do të ishte përfshirë. Kjo konfirmohet më tej nga fakti se neni 54(1) i Ligjit kushtëzon se DHS-ja ka përparësi brenda juridiksionit lëndor të vet ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë. Për sa i takon pretendimit të Mbrojtjes se neni 17 i Ligjit është i tepërt, thjesht përfshirja në të e një dispozite sinjalizon se ajo ka një funksion. Sidoqoftë, ndërsa neni 34 i Kushtetutës është formuluar në mënyrë të përgjithshme, neni 17 i Ligjit shërben për të përcaktuar parimin *non bis in idem* lidhur me DHS-në dhe, ndër të tjera, me TPNJ-në.

118. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në nxjerrjen e përfundimit se themelimi i DHS-së u bë në pajtim me nenin 103(7) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese përmendi “një numër pretendime[sh] tejet konkrete për veprime kriminale” të përshkruara në Raportin e Këshillit të Evropës.²³⁷ Ky përshkrim i përgjithshëm nuk përjashton pretendimet që dalin nga Raporti të cilat shkojnë përtej trafikimit të organeve dhe të trajtimit çnjerëzor që pretendohet se janë kryer në qendrat e ndalimit në Shqipëri. Citimi prej Gjykatës Kushtetuese i konstatimit të GJEDNJ-së se “lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar mund të kërkojë

²³⁶ TFHS, [Factsheet](#). TFHS-ja gjithashtu vuri në dukje se do të kryente një hetim të gjithanshëm penal duke hetuar të gjithë gamën e krimeve në Raportin e Këshillit të Evropës.

²³⁷ Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese, para. 51.

masa, procedura dhe institucione të karakterit të specializuar” nuk e prek këtë përfundim.²³⁸ Përmendja e korrupsionit, që është një krim pa lidhje të drejtpërdrejtë me Raportin, provon se Gjykata Kushtetuese e përdori këtë rast për të ilustruar në përgjithësi se, sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së, gjykatat speciale mund të ngrihen për një numër qëllimesh me kusht që ato të jenë të mbështetura në ligj. Kjo konfirmohet më tej nga fakti se Gjykata Kushtetuese, në të njëjtin kontekst, i është referuar përgjithësisht themelimit të DHS-së “me qëllim të luftimit të krimeve specifike”.²³⁹

119. Nga kjo del se as Kushtetuta dhe as Ligji nuk bëhen shkas për kufizimet e identifikuar nga Mbrojtja dhe si rrjedhojë, këto argumente duhet të rrëzohen.²⁴⁰

(d) Neni 1(2) i Ligjit

120. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se neni 1 i Ligjit nuk vendos ndonjë kufizim juridiksional, duke qenë se merret vetëm me përkufizimin e fushëveprimit dhe qëllimit të Ligjit.

121. Gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përsërit se Ligji u miratua pasi TFHS-ja kishte bërë publike se hetimi i saj nuk ishte kufizuar vetëm tek pretendimet për trafikim organesh dhe trajtim çnjerëzor në qendrat e ndalimit në Shqipëri.²⁴¹ Kjo do të thotë se përmendja e këtij hetimi nuk nënkupton kufizimin e sugjeruar nga Mbrojtja. Rrjedhimisht, këto argumente hidhen poshtë.²⁴²

²³⁸ Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese, para. 52, që i referohet GJEDNJ-së, *Fruni v. Slovakia*, nr. 8014/07, [Judgement](#), 21 qershor 2011.

²³⁹ Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese, para. 71.

²⁴⁰ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 31-32; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 63, 65(a), 66.

²⁴¹ [UNMIK Report](#), Annex II .

²⁴² Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 25-26; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 64, 67.

(e) E drejta mbi të drejtat e njeriut

122. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se interpretimi i përshkruar më lart përbën të vetmin interpretim të duhur ligjor të përmendjeve të Raportit të Këshillit të Evropës në nenin 162(1) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Ligjit.

123. Rrjedhimisht, ky interpretim nuk bëhet shkas për krijimin e ndonjë paqartësie dhe për këtë arsye parashtrimi i Mbrojtjes rrëzohet.²⁴³

2. Fushëveprimi i Raportit të Këshillit të Evropës

(a) Korniza e veprimtarisë kriminale të pretenduar

124. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse Raporti i Këshillit të Evropës përmban një numër pretendimesh faktike që përshkruajnë veprimtarinë kriminale, ky raport nuk mëton se ka autoritetin e cilësimit ligjor të këtyre pretendimeve në mënyrë shteruese, e aq më pak në përvijimin e juridiksionit lëndor të DHS-së. Në fakt, Raporti i Këshillit të Evropës e ka zanafillën nga një organ jogjyqësor dhe autori i tij e specifikon shprehimisht se nuk kishte mandatin për kryerjen e një hetimi penal.²⁴⁴ Rrjedhimisht, nëse një veprim apo mosveprim plotëson kushtet për t'u cilësuar krim ndërkombëtar, kjo duhet të vendoset nga një gjykatë në bazë të provave që disponon.

125. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Raporti i Këshillit të Evropës përmend disa elemente kontekstuale për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, pra, ekzistencën e një konflikti të armatosur,²⁴⁵ dhe një praktikë dhe strategji të shënjestrimit të personave për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe/ose politike²⁴⁶. Rrjedhimisht, konstatimet e Raportit në të cilat pretendohet se janë kryer

²⁴³ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 65(d).

²⁴⁴ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 21, 175.

²⁴⁵ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 29, 95, 102, 103, 105, 106.

²⁴⁶ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 4, 14 (poshtëshënimet 11-12), 89, 90, 103, 111, 139, 144.

disa krime (ndërkombëtare), përfshirë vrasje, ndalime të paligjshme, tortura, trajtime çnjerëzore dhe poshtëruese, dhe zhdukje me forcë,²⁴⁷ nuk mund të shqyrtohen veçazi nga konstatimet që përcaktojnë rrethanat në të cilat u kryen veprime të tilla.

126. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Raporti i Këshillit të Evropës përmban pretendime konkrete për kryerjen e krimeve ndërkombëtare, të cilat sigurisht shkojnë përtej formulimeve të përgjithshme. Në veçanti, pjesa e titulluar “Objektet e ndalimit dhe trajtimi çnjerëzor i të ndaluarve” fillon me përshkrimin e disa karakteristikave të përgjithshme të ndalimeve të UÇK-së në kohën e luftës dhe deklaron se duket se disa prej këtyre ndalimeve e plotësojnë kriterin për t’u konsideruar krime lufte.²⁴⁸ Logjikisht del se konstatimet që vijnë për “nëngrupin e parë të të ndaluarve: ‘robërit e luftës’” kanë të bëjnë krejtësisht me pretendime për krime lufte.²⁴⁹ Kjo gjë konfirmohet më tej nga referencat më të përgjithshme të Raportit të Këshillit të Evropës për krime lufte.²⁵⁰ Gjithashtu, në lidhje me “ndalimet e kryera nga pjesëtarët dhe bashkëpunëtorët e UÇK-së pas konfliktit”, Raporti konstaton se shqiptarët e Kosovës vazhduan të ndalonin njerëz për një sërë motivesh, përfshirë hakmarrje, ndëshkim dhe përfitim.²⁵¹ Si rrjedhojë, veprimtaria kriminale e organizuar nuk përshkruhet si motivi i vetëm dhe, së bashku me konstatimet lidhur me personat e shënjestruar për shkak të përkatësisë së tyre etnike,²⁵² kjo pjesë e Raportit të Këshillit të Evropës ka të bëjë me shkelje të të drejtave të njeriut që bartin karakteristika të krimeve kundër njerëzimit.²⁵³ Fakti që Raporti bën dallim për “viktimat e krimit të organizuar”, si një nëngrup personash të ndaluar, e përforcon edhe më shumë këtë interpretim.²⁵⁴

²⁴⁷ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 72, 74, 112, 120, 124, 131, 137, 147, 153, 155, 174.

²⁴⁸ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 101.

²⁴⁹ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 102-128.

²⁵⁰ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, përmbledhje (para. 2), projektrezolutë (para. 11), para. 7, 68, 113.

²⁵¹ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 129.

²⁵² Raporti i Këshillit të Evropës, para. 4, 139.

²⁵³ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 130-155.

²⁵⁴ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 156-168.

127. Për më tepër, pretendimet në Raport mund të cilësohen si krime kundër njerëzimit dhe/ose krime lufte, pavarësisht nga përmendja e veprimtarisë kriminale të organizuar. Kujtohet se në lidhje me synimin kriminal, në përgjithësi, motivi nuk është i rëndësishëm.²⁵⁵ Më konkretisht, nuk ekziston ndonjë kusht që krimet kundër njerëzimit nuk duhet të jenë kryer për arsye personale.²⁵⁶ Po ashtu, duke parë se lidhja me konfliktin sa u takon krimeve të luftës kërkon që kryesi duhet të ketë vepruar për realizimin e konfliktit të armatosur apo në kontekstin e këtij konflikti,²⁵⁷ motivi i kryesit jo domosdoshmërisht e përjashton lidhjen midis veprimit të tij dhe konfliktit të armatosur.

128. Rrjedhimisht, konstatimi se kryesit kanë vepruar në kuadër të veprimtarisë kriminale të organizuar, pa konstatime të tjera, nuk do të vërtetonte se krimet që ata kanë kryer, nuk përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe/ose krime lufte. Çështja që ka rëndësi është nëse provat e paraqitura gjatë proceseve në DHS do të tregojnë se, për akuzat që kanë lidhje të mjaftueshme me Raportin e Këshillit të Evropës janë përmbushur elementet rrethore për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, si edhe elementet materiale dhe mendore të krimeve bazë.

129. Në përfundim, Raporti i Këshillit të Evropës nuk kufizohet vetëm në pretendime që kanë të bëjnë me veprimtari kriminale të organizuar, e as konstatimet e tij nuk mund të kufizohen vetëm në lidhje me këto pretendime nga pikëpamja ligjore. Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes duhen hedhur poshtë.²⁵⁸

²⁵⁵ *Shih për shembull*, ICTY, *Prosecutor v. Tadić* ("Tadić Appeal Judgment"), IT-94-1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 15 July 1999, para. 269; *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 February 2005, para. 106; ICTR, *Prosecutor v. Kanyarukiga*, ICTR-02-78-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 8 May 2012, para. 262.

²⁵⁶ *Shih për shembull*, [Tadić Appeal Judgement](#), para. 248-251.

²⁵⁷ *Shih për shembull*, ICTY, *Prosecutor v. Kunarac et al.* ("Kunarac Appeal Judgment"), IT-96-23 & IT-96-23/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 12 June 2002, para. 57-59; ICTR, *Prosecutor v. Rutaganda*, ICTR-96-3-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 26 May 2003, para. 569-570.

²⁵⁸ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 39-41; Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), para. 4; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para 60.

(b) Parametrat gjeografikë

130. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, sipas Raportit, bazat e UÇK-së në territorin e Shqipërisë, u përdorën me përkrahjen e elementëve të fuqishëm në aparatin e shërbimit të zbulimit shqiptar, në mbështetje të veprimtarisë së armatosur të UÇK-së në Kosovë dhe se shumica e viktimave, të cilët u shënjestruan për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe sepse konsideroheshin si “bashkëpunëtorë” ose “tradhtarë”, u morën nga Kosova dhe u çuan në Shqipëri.²⁵⁹

131. Në lidhje me këtë kujtohet se, lidhur me krimet kundër njerëzimit, krimet që kryhen jashtë sulmit kryesor kundër popullsisë civile, përfshirë edhe në një shtet tjetër, kur janë mjaftueshëm të lidhur me sulmin, mund të jenë pjesë e atij sulmi.²⁶⁰ Sa u takon krimeve të luftës, një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të përhapet edhe në një shtet fqinj, duke u bërë kështu shkas për zbatimin e rregullave përkatëse të DHN-së, përfshirë, Nenin e Përbashkët 3.²⁶¹ Sidoqoftë, personat e mbrojtur nga Neni i Përbashkët 3, si rrjedhojë e konfliktit të armatosur jondërkombëtar, kanë të drejtë të gëzojnë një mbrojtje të tillë edhe pasi të jenë zhvendosur në një shtet të tretë, duke pasur parasysh se një dispozitë e tillë parashikon që veprimet e renditura mbeten të ndaluara me ligj në çfarëdo vendi qoftë.²⁶² Në përputhje me të drejtën

²⁵⁹ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 36, 38, 72, 74, 103, 105, 106, 108, 111, 115, 129, 130, 137, 139, 144.

²⁶⁰ [Kunarac Appeal Judgement](#), para. 100; MICT, *Prosecutor v. Šešelj*, MICT-16-99-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 11 April 2018, para. 76; ICC, *Situation in the Republic of Burundi*, ICC-01/17-9-Red, Pre-Trial Chamber III, [Version i redaktuar publik of “Decision according to Article 15 of the Rome Statute on the Authorization of an Investigation into the Situation in the Republic of Burundi”](#), ICC-01/17-X-9-US-Exp, 25 Tetor 2017, 9 November 2017, para. 194.

²⁶¹ ICRC, [Commentary to GCIII](#), 2020 (“2020 ICRC Commentary GCIII”), para. 502, 508-510 (Neni i përbashkët 3).

²⁶² *Shih po ashtu*, ICC, *Situation in the Islamic Republic of Afghanistan*, ICC-02/17-138, Appeals Chamber, [Judgement on the Appeal against the decision on the authorisation of an investigation into the situation in the Islamic Republic of Afghanistan](#), 5 March 2020, para. 74-75.

materiale lidhur me krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, sipas neneve 8 dhe 9 të Ligjit,²⁶³ DHS-së i është dhënë juridiksion ndaj krimeve të tilla.²⁶⁴

132. Rrjedhimisht, krimet e përmendura që pretendohet se janë kryer në Shqipëri nuk mund të merren veças nga ngjarjet në Kosovë, sepse bëjnë pjesë në të njëjtën sulm kundër popullsisë civile dhe konfliktin e armatosur jondërkombëtar.

133. Gjithashtu, Raporti përmend disa krime që pretendohet se janë kryer në Kosovë pa ndonjë lidhje me Shqipërinë. Në veçanti, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës u bëri thirrje autoriteteve shqiptare dhe administratës së Kosovës që, veças nga pretendimet e lidhura me qendrat e ndalimit,²⁶⁵ të bashkëpunonin pa rezerva me EULEX-in dhe autoritetet serbe në kuadër të procedurave për zbulimin e së vërtetës lidhur me krimet e kryera në Kosovë.²⁶⁶ Gjithashtu, Raporti i Këshillit të Evropës diskuton konkretisht, ndër të tjera, se si : (i) zotërinjtë Haliti, Veseli, Sylja dhe Limaj, bashkë me zotin Thaçi dhe anëtarë të tjerë të rrethit të tij të brendshëm, janë implikuar në dhënien e urdhrave – dhe në disa raste, kanë mbikëqyrur personalisht – vrasje, ndalime, rrahje dhe marrje në pyetje në pjesë të ndryshme të Kosovës;²⁶⁷ (ii) fraksione dhe grupime të UÇK-së që kishin nën kontroll zona të caktuara të Kosovës ishin në gjendje të drejtonin ndërmarrje të organizuara kriminale pothuaj sipas dëshirës;²⁶⁸ dhe (iii) njësite të UÇK-së nga Shqipëria e Veriut u dërguan në Kosovë me objektivin e

²⁶³ Neni 8 i Ligjit në pjesën përkatëse parashikon se DHS-ja ka juridiksion ndaj krimeve brenda juridiksionit të vet lëndor, të cilat ose janë filluar ose kryer në Kosovë. (theksi i shtuar). Neni 9 i Ligjit parashikon në pjesën përkatëse se përveç juridiksionit të tyre territorial të paraparë në nenin 8, Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi personat e nënshtetësisë kosovare/RFJ-së, apo mbi personat që kanë kryer krime nën juridiksionin e tyre lëndor, kundër personave me nënshtetësi kosovare/RFJ-së kudo që janë kryer ato krime (theksi i shtuar).

²⁶⁴ *Shih gjithashtu, ICC, Request under Regulation 46(3) of the Regulations of the Court, ICC-RoC46(3)-01/18-37, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the "Prosecution's Request for a Ruling on Jurisdiction under Article 19\(3\) of the Statute"](#), 6 September 2018, para. 62-79; Situation in the People's Republic of Bangladesh/Republic of the Union of Myanmar, ICC-01/19-27, Pre-Trial Chamber III, [Decision Pursuant to Article 15 of the Rome Statute on the Authorisation of an Investigation into the Situation in the People's Republic of Bangladesh/Republic of the Union of Myanmar](#), 14 November 2019, para. 42-62.*

²⁶⁵ Raporti i Këshillit të Evropës, Projektrezolutë, para. 19.5.2, 19.5.3.

²⁶⁶ Raporti i Këshillit të Evropës, Projektrezolutë, para. 19.5.1.

²⁶⁷ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 72.

²⁶⁸ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 85.

deklaruar të “sigurimit të territorit”, por që ishin të nxitur nga një zemërim, madje hakmarrje e papërmbajtur ndaj çdokujt që ata besonin kishte kontribuar në shtypjen e popullsisë etnike shqiptare.²⁶⁹

134. Rrjedhimisht, krimet e pretenduara në Raportin e Këshillit të Evropës që kanë lidhje me Shqipërisë u kryen në kuadër të të njëjtit sulm kundër popullsisë civile dhe të konfliktit të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe gjithashtu Raporti diskuton edhe krimet e pretenduara pa lidhje të drejtpërdrejtë me Shqipërinë. Për këtë arsye, argumentet e Mbrojtjes rrëzohen.²⁷⁰

(c) Parametrat kohorë

135. Për Gjykatësin e Procedurës Paraprake është e qartë se fraza “për pjesën më të madhe” tregon se Raporti i Këshillit të Evropës përfshin gjithashtu veprime të cilat kanë ndodhur përpara verës së vitit 1999.²⁷¹ Faktikisht, në pajtim me këtë ide, Raporti diskuton shprehimisht krimet që pretendohet se kanë ndodhur në këtë periudhë.²⁷² Më konkretisht, raportohet se një grup anëtarësh të UÇK-së morën kontrollin e shumicës së ndërmarrjeve kriminale të paligjshme në të cilat u përfshinë shqiptarë kosovarë në Shqipëri, duke filluar më së paku në vitin 1998.²⁷³ Grupi i Drenicës, që pretendohet se udhëhiqej nga z. Thaçi, kishte krijuar një bazë të fuqishme pushteti në ndërmarrjet kriminale të organizuara në Kosovë dhe Shqipëri me mbështetjen e strukturave zyrtare të qeverisjes në Shqipëri, shërbimeve të fshehta shqiptare dhe mafies shqiptare dhe vepronte kryesisht nga Shqipëria gjatë gjithë luftimeve në Kosovë dhe më tej.²⁷⁴ Gjithashtu, Raporti jep hollësi për disa pjesëtarë të UÇK-së që

²⁶⁹ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 87.

²⁷⁰ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 34-36; Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), para. 4; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para 59.

²⁷¹ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 4.

²⁷² Raporti i Këshillit të Evropës, para. 36, 41-63.

²⁷³ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 56.

²⁷⁴ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 57-63.

janë përfshirë në dhënien e urdhrave – dhe në disa raste që kanë mbikëqyrur personalisht – kryerjen e krimeve të ndryshme në pjesë të ndryshme të Kosovës dhe në kuadër të operacioneve të udhëhequra nga UÇK-ja në territorin e Shqipërisë nga 1998 deri më 2000.²⁷⁵ Ai gjithashtu përshkruan se, me mbështetjen e elementëve me pushtet në aparatin e shërbimit të zbulimit shqiptar, kampet e UÇK-së në territorin shqiptar u përdorën për të mbështetur veprimtaritë e armatosura të UÇK-së në Kosovë dhe se mbajtja në ndalim e individëve në këto kampe u justifikua me domosdoshmëritë strategjike të zhvillimit të luftës në Kosovë nga prilli në qershor 1999.²⁷⁶

136. Rrjedhimisht, Raporti i Këshillit të Evropës trajton shprehimisht krimet e pretenduara dhe ngjarjet që lidhen me elemente kontekstuale të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, të cilat kanë ndodhur të paktën që nga viti 1998, sikurse pasqyrohen me të drejtë në juridiksionin kohor të DHS-së, në nenin 7 të Ligjit. Si rrjedhojë, çdo akuzë që lidhet me periudhën nga 1998 deri në verën e vitit 1999, e ngritur ndaj një individi gjatë ushtrimit të juridiksionit të DHS-së, është në pajtim të plotë me Raportin. Rrjedhimisht argumenti i Mbrojtjes duhet hedhur poshtë.²⁷⁷

(d) Parametrat e juridiksionit individual

137. Për mendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Raporti i Këshillit të Evropës i cili identifikon me emra disa persona si z. Thaçi dhe z. Veseli,²⁷⁸ përmend edhe kryes të tjerë të pretenduar me fjalë të papërcaktuara qartë. Për shembull, Raporti identifikon si kryes të pretenduar pjesëtarë të Grupit të Drenicës së z. Thaçi, pjesëtarë të rrethit të ngushtë të z. Thaçi, pjesëtarë të UÇK-së dhe persona të lidhur me të dhe

²⁷⁵ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 72.

²⁷⁶ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 102-114.

²⁷⁷ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 37-38; Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), para. 4; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para 58.

²⁷⁸ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, para. 58, 67, 68, 70, 72, 82, 84, 86, 104, 114.

orkestrues të ndërmarrjes kriminale pas konfliktit.²⁷⁹ Rrjedhimisht, ai nuk merr përsipër të përcaktojë një listë përfundimtare. Kjo konfirmohet më tej nga mungesa e mandatit të autorit të Raportit të Këshillit të Evropës për kryerjen e një hetimi penal.²⁸⁰ Po ashtu, mandati i TFHS-së, sikurse përcaktohet më lart, nuk kufizohej me individët e specifikuar në të.

138. Si përfundim, Raporti nuk kufizohet me kryesit e pretenduar të identifikuar me emër dhe, rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes nuk duhen marrë parasysht.²⁸¹

3. Përfundim

139. Parashtrimet e Mbrojtjes mbështeten në një vlerësim ligjor të gabuar dhe një interpretim të pasaktë të kuadrit të Raportit të Këshillit të Evropës. Kuptimi bazë i termave “në lidhje me” dhe “që kanë të bëjnë me” në nenin 162(1) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Ligjit, interpretuar në kuadër të dispozitave juridiksionale të Ligjit, kërkon një lidhje të mjaftueshme midis akuzave të ngritura kundër individëve në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së dhe Raportit të Këshillit të Evropës. Gjithashtu, po të vlerësohet me saktësi, Raporti i Këshillit të Evropës përfshin: (i) krime të pretenduara ndërkombëtare, përfshirë krime kundër njerëzimit dhe krime lufte të kryera kundër personave për shkak të përkatësisë së tyre etnike apo të konsiderimit të tyre si “bashkëpunëtorë” ose “tradhtarë”; (ii) krime të pretenduara në Kosovë me apo pa lidhje me Shqipërinë; (iii) krime të pretenduara të kryera nga 1998 e këtej; dhe (iv) kryes të pretenduar që ishin apo kishin qenë pjesëtarë të UÇK-së, apo të lidhur me UÇK-në, duke mos u kufizuar vetëm tek ata që ishin identifikuar shprehimisht si të tillë.

²⁷⁹ *Shih për shembull*, Raporti i Këshillit të Evropës, përmbledhje (para. 1, 2), para. 5, 7, 68, 70, 72, 95, 97, 98, 101, 102, 103, 129, 130.

²⁸⁰ Raporti i Këshillit të Evropës, para. 21, 175.

²⁸¹ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (Diskriminim), para. 4; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 68(c).

140. Në konfirmimin e Aktakuzës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndër të tjera përcaktoi se ekziston një dyshim i bazuar mirë sipas kuptimit të nenit 39(2) të Ligjit dhe rregullës 86(4) dhe (5) të Rregullores se: (i) të akuzuarit ishin ose kishin qenë pjesëtarë të UÇK-së dhe disa prej tyre më pas patën poste të tjera;²⁸² (ii) pretendohet se të akuzuarit i kryen krimet bashkë me persona të tjerë ose me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së;²⁸³ (iii) viktimat ishin individë që konsideroheshin bashkëpunëtorë apo të lidhur me forcat e RFJ-së apo zyrtarë të institucioneve shtetërore, ose që nuk përkrahnin qëllimet apo metodat e UÇK-së dhe më vonë të Qeverisë Provizore të Kosovës, përfshirë personat e lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe personat me përkatësi etnike serbe, rome dhe grupe të tjera etnike;²⁸⁴ (iv) veprimet u kryen në vende të ndryshme në Kosovë dhe Shqipëri;²⁸⁵ (v) veprimet u kryen të paktën nga marsi 1998 deri në shtator 1999;²⁸⁶ (vi) u kryen një gamë e gjerë veprimesh që përbënin krime të ndryshme sipas neneve 13 dhe 14 të Ligjit;²⁸⁷ (vii) veprimet u kryen me idenë e marrjes dhe ushtrimit të kontrollit mbi gjithë Kosovën;²⁸⁸ dhe (viii) veprimet u kryen në kuadër të një sulmi ndaj popullsisë civile dhe të konfliktit të armatosur jondërkombëtar.²⁸⁹

141. Këto përfundime trajtojnë faktorët përkatës për vlerësimin nëse, në ushtrimin e juridiksionit të DHS-së, çdo akuzë është e lidhur mjaftueshëm me Raportin e Këshillit të Evropës, pra, me kryesit,, viktimat, vendin (vendet), kohën, *modus operandi*, llojin e veprimeve si dhe synimin dhe kontekstin e kryerjes së këtyre veprimeve. Rrjedhimisht, edhe ndonëse tema në shqyrtim nuk ishte ngritur shprehimisht për marrje vendimi dhe nuk kishte ndonjë arsye që ta detyronte Gjykatësin e Procedurës Paraprake ta bënte këtë *proprio motu*, Vendimi i Konfirmimit, i mbështetur në bazë të

²⁸² Vendimi i Konfirmimit, para. 455, 460, 464, 468.

²⁸³ Vendimi i Konfirmimit, para. 452.

²⁸⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 124, 126.

²⁸⁵ Vendimi i Konfirmimit, para. 41, 42, 125, 127.

²⁸⁶ Vendimi i Konfirmimit, para. 39, 125, 134-136.

²⁸⁷ Vendimi i Konfirmimit, para. 32, 33, 139-444.

²⁸⁸ Vendimi i Konfirmimit, para. 453-454.

²⁸⁹ Vendimi i Konfirmimit, para. 125, 129, 131, 137, 446-450.

standardit ligjor të duhur dhe një vlerësimi të saktë të kuadrit të Raportit të Këshillit të Evropës, demonstroi mjaftueshëm ekzistencën e një lidhjeje të tillë.

142. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e hedh poshtë mocionin e Thaçit lidhur me Juridiksionin dhe Mocionin e Krasniqit lidhur me Juridiksionin lidhur me argumentimin se akuzat në Aktakuzë, në tërësi apo pjesërisht, nuk lidhen me pretendimet e Raportit të Këshillit të Evropës.

C. JURIDIKSIONI LËNDOR

1. Ndalimi arbitrar si krim lufte në konflikte të armatosura jondërkombëtare

(a) Fushëveprimi i nenit 14(1)(c) të Ligjit

143. Neni 14(1) i Ligjit rendit lloje të ndryshme sjelljeje të cilat përbëjnë krime lufte “sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor” të DHS-së. Për këtë arsye, Ligji paraqet një listë veprimesh të cilat ligjvënësit e Kosovës i kanë identifikuar si vepra penale në të drejtën zakonore ndërkombëtare nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimet e tij se, në gjykimin e krimeve sipas nenit 13 dhe 14 të Ligjit të kryera gjatë juridiksionit kohor të DHS-së, ajo zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe legjislacionin e Kosovës vetëm kur është i përfshirë shprehimisht në Ligj dhe nëse është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare.²⁹⁰ Në rast se Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtonte nëse ndalimi arbitrar përbënte apo jo krim lufte në konfliktin e armatosur jondërkombëtar gjatë kuadrit kohor të Aktakuzës, kjo do të binte ndesh me të drejtën zakonore ndërkombëtare.

144. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në renditjen e krimeve të ndryshme të luftës në juridiksionin e DHS-së, neni 14(1)(a) dhe (c) i Ligjit përdor formulimin “duke i përfshirë veprat në vijim”, ndërsa paragrafët (b) dhe (d) të së njëjtës dispozite

²⁹⁰ *Shih para.* 102 më lart.

përdorin po ashtu formulim të hapur “duke i përfshirë veprat e paraqitura në vijim, por jo vetëm ato”. Mbrojtja e Veselit ngre një mospërputhje midis versioneve shqip dhe anglisht të nenit 14(1)(c) të Ligjit, duke argumentuar se versioni shqip përdor një formulim shterues dhe se versioni anglisht është jo i saktë, prandaj nuk duhet të merret parasysh. Pas verifikimit të teksteve të nenit 14(1)(c) të Ligjit në versionet anglisht, shqip dhe serbisht (që të gjitha autentike sipas nenit 162(9) të Kushtetutës), Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk konstaton mospërputhje midis këtyre tre versioneve: në të tre versionet përdoret formulim i hapur në mënyrë të ngjashme dhe të njëtrajtshme.²⁹¹ Si rrjedhojë, në lidhje me nenin 14 të Ligjit nuk lind problemi i mospërputhjes gjuhësore dhe formulimet e përdorura nga kjo dispozitë në paragrafët (1)(a) dhe (c), nga njëra anë, dhe (1)(b) dhe (d), nga ana tjetër, edhe pse të ndryshëm si formulime, kanë kuptim të ngjashëm joshterues.

145. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se formulimet joshteruese në nenin 14 të Ligjit tregojnë se krimet e luftës që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, të kryera në konflikte të armatosura ndërkombëtare apo jondërkombëtare, nuk janë domosdoshmërisht vetëm ato të renditura shprehimisht në nenin 14 të Ligjit. Megjithatë, formulimi i hapur i nenit 14 të Ligjit nuk përkthehet në juridiksion të pakufizuar dhe të pacaktuar ndaj çdo krimi lufte, në varësi të gjykimit të Prokurorit të Specializuar. Për të pasur juridiksion ndaj një krimi lufte që nuk përfshihet shprehimisht në listën e nenit 14 të Ligjit, një krim i tillë duhet të ketë ekzistuar sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së tij të pretenduar në pajtim me nenet 3(2)(d) dhe 12 të Ligjit.

146. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se neni 14 i Ligjit, i lexuar së bashku me nenet 3(2)(d) dhe 12 të tij, ofron një bazë ligjore solide për ushtrimin e juridiksionit mbi krimet e luftës sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare,

²⁹¹ E njëjta gjë mund të thuhet për paragrafët (b) dhe (d) të nenit 14(1) të Ligjit. *Shih*, mesazhin elektronik nga Njësia e Përkthimit, 25 qershor 2021, në orën 09:30.

duke përfshirë edhe krime të tjera përveç krimeve të luftës sipas të drejtës zakonore, të renditur shprehimisht në Ligj.

147. Pasi ka vërtetuar se korniza ligjore e DHN-së parashikon – dhe në fakt bën të nevojshëm – ushtrimin e juridiksionit mbi krimet e luftës sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, do të përcaktojë nëse ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të DHN-së, përfshirë Nenin e Përbashkët 3 dhe nëse rezultoi në përgjegjësi penale individuale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë periudhës që mbulon Aktakuza.

(b) A është ndalimi arbitrar shkelje e rëndë e DHN-së

148. Së pari, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të përcaktojë nëse ndonjë apo disa forma të heqjes së lirisë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar përbëjnë shkelje të rëndë të DHN-së, në veçanti, të Nenit të Përbashkët 3.²⁹² Për këtë, është e nevojshme të përcaktohet nëse ekziston një bazë ligjore për heqjen e lirisë sipas DHN-së së zbatueshme për këto lloje konfliktesh të armatosura.

149. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, sipas DHN-së, në përgjithësi, heqja e lirisë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar mund të ketë të paktën dy lloj formash, me kusht që ato të jenë të lidhura me konfliktin e armatosur: (i) të jetë rrjedhojë e proceseve penale kundër një personi (ndalim penal); dhe (ii) të mbështetet në arsye sigurie (internim).²⁹³ Kjo sugjerohet qartë nga përmendja e fjalës “ndalim” në Nenin e Përbashkët 3²⁹⁴ dhe “ndalim” dhe “internim” në gjithë nenin 5 të

²⁹² Përmendja e dispozitave të PSHII bëhet vetëm për të interpretuar DHN-në në kontekst dhe në rast se dispozita të tilla pasqyrojnë DHN-në zakonore në atë kohë, dhe jo sepse Gjykatësi i Procedurës Paraprake beson se PSHII është i zbatueshëm si e drejtë traktati, edhe pse RSFJ-ja e ratifikoi PSHII më 1978. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka nxjerrë ndonjë konstatim se konflikti i armatosur jondërkombëtar në Aktakuzë plotëson standardin e përcaktuar në PSHII.

²⁹³ ICRC, *Commentary to APII*, 1987 (“1987 ICRC Commentary APII”), <https://ihl-databases.icrc.org/applic/ihl/ihl.nsf/INTRO/475> para. 4568 (Article 5).

²⁹⁴ *2020 ICRC Commentary GC III*, para. 754-755 (Common Article 3).

Protokollit Shtesë II (“PSHII”),²⁹⁵ si edhe nga garancitë e parashikuara nga neni 6 i PSHII në rastin e ndjekjes penale të individëve.

150. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon gjithashtu se cilido që bie në duart e palës kundërshtare ka të drejtë të gëzojë disa garanci (materiale dhe procedurale), në pajtim me Nenin e Përbashkët 3 dhe nenet 4-6 të PSHII, të pasqyruara në të drejtën zakonore ndërkombëtare.²⁹⁶ Këto garanci, të cilat kanë karakter absolut,²⁹⁷ duhet të zbatohen nga të gjitha palët në një konflikt të armatosur jondërkombëtar (përfshirë grupet e armatosura)²⁹⁸ dhe duhet t’u akordohen të gjithë personave liria e të cilëve është kufizuar, pavarësisht nëse ka një bazë ligjore për t’i ndaluar apo internuar ata dhe për arsyen (arsyet) për ta bërë këtë.²⁹⁹ Megjithatë, nga ana tjetër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh se në DHN-në e zbatueshme në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk përmenden arsyet dhe procedurat e heqjes së lirisë, në ndryshim nga sistemet më të hollësishme të internimit dhe ndalimit paraparë nga DHN-ja e zbatueshme për konfliktin e armatosur ndërkombëtar, veçanërisht në Konventën e Tretë dhe të Katërt të Gjenevës.³⁰⁰

²⁹⁵ APII, Article 5(1), 5(2) (që u referohet detyrimeve që kanë ata “që janë përgjegjës për internimin apo ndalimin”, 5(3) (që i referohet detyrimit për të trajtuar në mënyrë njerëzoore personat liria e të cilëve është kufizuar, përveç në internim apo ndalim por që, “gjithsesi, për arsye të lidhura me konfliktin e armatosur”).

²⁹⁶ Customary IHL Study, (Vol. I (Rules)), Rules 87, 100-102, pp 306-308, 352-374. *See also* Confirmation Decision, para. 34.

²⁹⁷ [2020 ICRC Commentary GC III](#), paras 538, 542 (Common Article 3); [1987 ICRC Commentary APII](#), para. 4528 (Article 4), para. 4567 (Article 5), para. 4599 (Article 6).

²⁹⁸ [2020 ICRC Commentary GC III](#), para. 542 (Common Article 3): “Është e padiskutueshme se dispozitat materiale të Nenit të Përbashkët 3 janë detyruese për grupet e armatosura kur ata janë palë në një konflikt të armatosur”. *Shih gjithashtu* [1987 ICRC Commentary PSHII](#), para. 4460, 4470 (Article 1). Ky shpjegues sqaron se shprehja “ata që janë përgjegjës për internimin apo ndalimin” u referohet “personave që janë përgjegjës de facto për kampet, burgjet apo për çdo vend tjetër ndalimi, pavarësisht nga ndonjë autoritet i njohur ligjor”, [1987 ICRC Commentary PSHII](#), para. 4582 (Neni 5).

²⁹⁹ [1987 ICRC Commentary PSHII](#), para. 4568 (Article 5). *Shih gjithashtu*, [2020 ICRC Commentary GC III](#), para. 542 (Common Article 3), para. 552, 573.

³⁰⁰ Geneva Convention Relative to the Treatment of Prisoners of War, 82 UNTS 251, 12 August 1949, Article 21; Geneva Convention Relative to the Protection of Civilian Persons in Time of War 75 UNTS 973, Articles 41-42, 78.

151. Në Vendimin e Konfirmimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konkludoi se heqja e lirisë pa bazë ligjore ose në shkelje të garancive bazë nuk është e pajtueshme me standardin e trajtimit njerëzor të të gjithë personave jashtë luftimit, ndër të cilët edhe personat e mbajtur në ndalim, dhe është shkelje e këtij standardi të mishëruar në Nenin e Përbashkët 3³⁰¹ Si rrjedhojë ka dy lloje situatash të ndryshme dhe të pavarura në të cilat heqja e lirisë mund të shkelë DHN-në dhe të bëhet arbitrare.³⁰² Situata e parë ndodh kur një palë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar i heq dikujt lirinë pa një bazë të vlefshme ligjore. Situata e dytë ndodh kur një person ndodhet ndërkohë në duart e palës ndaluese dhe nuk i akordohen garancitë bazë për të cilat ka të drejtë sipas DHN-së. Në situatën e dytë, pavarësisht nëse DHN-ja përmban një kompetencë apo arsye të vetvetishme për ndalim në një konflikt të armatosur jondërkombëtar “në të gjitha rastet duhet të garantohet një kompetencë shtesë lidhur me arsyet dhe procedurën për heqjen e lirisë [...]”, sepse këto garanci nuk janë shprehimisht të rregulluara në DHN-së e zbatueshme në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.³⁰³

152. Në lidhje me situatën e parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve të paraqitura në Aktakuzë, as DHN-ja e konventave as DHN-ja zakonore nuk ofronin bazë ligjore për heqjen e lirisë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar (në formën e ndalimit apo të internimit).³⁰⁴ Rrjedhimisht, çdo formë heqjeje e lirisë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar ka qenë arbitrare sipas DHN-së. Megjithatë, mungesa e një baze ligjore për ndalimin sipas DHN-së nuk e prek autoritetin e një shteti të përfshirë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar për t’u mbështetur në legjislacionin e vet si bazë ligjore për

³⁰¹ Vendimi i Konfirmimit, para. 35.

³⁰² Customary IHL Study (Vol. I (Rules)), Rule 99 (pp 347-349). The deprivation of liberty in international armed conflict is premised on exactly the same logic. See ICTY, *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 17 December 2004, para. 73; *Prosecutor v. Delalić et al.* (“Delalić et al. Appeals Judgment”), IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 February 2001, para. 322.

³⁰³ [2020 ICRC Commentary GCIII](#), para. 765 (Common Article 3).

³⁰⁴ *Shih gjithashtu*, United Kingdom, Supreme Court, *Abd Ali Hameed Waheed and Serdar Mohamed v. Ministry of Defence*, [2017] UKSC 2, [Judgement](#), 17 January 2017, para. 12, 234-276.

ndalimin. Megjithatë, parimi i barazisë së palëve ndërluftuese nuk mund të zgjerohet aq sa t'u akordojë autoritet të barabartë grupeve të armatosura për heqjen e lirisë së personave, sepse barazia e palëve ndërluftuese në këto lloje konfliktesh të armatosura (veçanërisht në çështje të tilla si heqja e lirisë) domosdoshmërisht dhe në mënyrë të natyrshme do të jetë asimetrike lidhur me shtetin.

153. Në lidhje me situatën e dytë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton parimin e trajtimit njerëzor, një tipar kyç i Nenit të Përbashkët 3 dhe një nga pesë parimet themelore të DHN-së.³⁰⁵ Parimi i trajtimit njerëzor kërkon që personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që kanë dalë jashtë luftimit për shkak të sëmundjeve, plagëve, ndalimit, apo ndonjë shkakut tjetër, në të gjitha rrethanat duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore. Në lidhje me interpretimin e këtij parimi themelor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizon se i njëjti parim mishërohet edhe në nenin 4(1) të PSHII, sipas të cilit të gjithë personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt apo që kanë pushuar së marri pjesë në luftime, pavarësisht nëse liria e tyre është kufizuar apo jo, në të gjitha rrethanat duhen trajtuar në mënyrë njerëzore. Është me rëndësi që parimi i trajtimit njerëzor i kristalizuar në një rregull të DHN-së zakonore, është njëlloj i zbatueshëm për konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe jondërkombëtare (Rregulla 87, Studimi i DHN-në Zakonore).³⁰⁶

154. Sikurse është konkluduar më herët,³⁰⁷ parimi i trajtimit njerëzor ka një fushëveprim shumë më të gjerë se sa veprimet e ndaluara, të renditura shprehimisht në Nenin e Përbashkët 3,³⁰⁸ të cilat thjesht ilustrojnë sjellje qartësisht në shkelje të kësaj

³⁰⁵ Bashkë me parimet e domosdoshmërisë ushtarake, proporcionalitetit dhe vuajtjeve të panevojshme.

³⁰⁶ *Shih*, Customary IHL Study, (Vol. I (Rules)), Rule 87 (p. 306). See also [Nicaragua Case](#), para. 218..

³⁰⁷ Vendimi i Konfirmimit, para. 34.

³⁰⁸ Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti, vrasjet e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura; marrja e pengjeve; dhunimi i dinjitetit personal, në veçanti, trajtimi poshtërues dhe degradues; dhënia e dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa ndonjë aktvendim të mëparshëm shpallur nga një gjykatë e ngritur në mënyrë të rregullt, e cila ofron të gjitha garancitë juridike që njihen si të domosdoshme nga njerëzit e qytetëruar.

dispozite.³⁰⁹ Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, pavarësisht nga mungesa e një baze ligjore për mbajtjen në ndalim të dikujt sipas DHN-së, kur grupe të armatosura që ushtrojnë kontroll territorial, qëllimisht u heqin lirinë individëve, gjithsesi DHN-ja parashikon që ata të zbatojnë, kur është praktikisht e mundshme, garanci bazë procedurale në lidhje me personat që janë në duart e tyre, qofshin të internuar apo të ndaluar.³¹⁰ Këto detyrime e kanë zanafillën në kriterin e trajtimit njerëzor të personave liria e të cilëve është kufizuar dhe ato shtohen kur grupet e armatosura, siç ishte rasti i UÇK-së që zotohen të zbatojnë DHN-në,³¹¹ kanë ushtruar një kontroll solid territorial,³¹² dhe kanë pasur (të disponueshëm) një sistem drejtësie, sado elementar.³¹³ Këto garanci bazë përfshijnë: (i) detyrimin për të informuar një person të arrestuar për arsyet e arrestimit; (ii) detyrimin për ta sjellë pa vonesë personin e arrestuar për një akuzë penale para një gjykatësi apo një autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) detyrimin për t'i dhënë personit që i është hequr liria një mundësi për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.³¹⁴

155. Rrjedh se heqja arbitrare e lirisë, e kristalizuar në rregullën 99 të Studimit të DHN-në Zakonore (që është njëloj e zbatueshme për konfliktin e armatosur ndërkombëtar dhe jondërkombëtar),³¹⁵ nuk është e pajtueshme me trajtimin njerëzor, të përcaktuar në Nenin e Përbashkët 3 dhe rregullën 87 të Studimit të DHN-së Zakonore.³¹⁶ Rrjedhimisht, mosdhënia e asnjë prej garancive të lartpërmendura bazë

³⁰⁹ [2020 ICRC Commentary GCIII](#), paras 588-589 (Common Article 3); ICTY, *Prosecutor v. Aleksovski* (“Aleksovski Trial Judgment”), IT-95-14/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 25 June 1999, para. 49.

³¹⁰ *Shih gjithashtu* Pejic, J., “Procedural Principles and Safeguards for Internment/Administrative Detention in Armed Conflict and Other Situations of Violence”, (2005) 87 *International Review of the Red Cross* 376.

³¹¹ 075993-076009, para. 23-27; 075552-075578, para. 91-100; SPOE40000792-SPOE40000792-ET Rishikuar; 043619-043620-ET, f. 3; U003-8586-U003-8590, f. U003-8589.

³¹² Vendimi i Konfirmimit, para. 132.

³¹³ 075552-075578, para. 91-100; SITF00016611-00016704, f. SITF00016646-00016647; 012450-TR-ET, Pjesa 1, f. 20; 043864-043864-ET, rishikuar; 025477-TR-ET, Pjesa 3 e rishikuar, f. 28-30; 058499-TR-ET Pjesa 6, f. 20-22.

³¹⁴ Customary IHL Study, (Vol. I (Rules)), Rule 99 (f. 349-350); Vendimi i Konfirmimit, para. 95.

³¹⁵ Customary IHL Study, (Vol. I (Rules)), Rule 99 (f. 344).

³¹⁶ Customary IHL Study, (Vol. I (Rules)), Rule (f. 344).

personave të cilëve u është hequr liria, e bën arbitrare heqjen e lirisë, në shkelje të kuadrit ligjor më sipër.³¹⁷

156. Duke marrë parasysh aspektet e mësipërme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se heqja arbitrare e lirisë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar përbën një shkelje të rëndë të DHN-së, përfshirë edhe Nenin e Përbashkët 3.

(c) A shkakton ndalimi arbitrar përgjegjësi penale individuale

157. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton kundërshtimet e ngritura nga Mbrojtja e Veselit në lidhje me besueshmërinë e Studimit të DHN-së Zakonore për përcaktimin e statusit të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaron se studimi i DHN-në Zakonore nuk është *shprehje* e të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe se KNKK-ja në vetvete nuk prodhon apo kristalizon praktika shtetërore, për arsyen e vetëkuptueshme se KNKK-ja nuk është as shtet e as gjykatë. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, bashkë me aktorë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë, KNKK-ja (dhe studimi i DHN-së Zakonore prej saj) është një burim autentik për praktikën shtetërore, të cilën Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka të drejtë ta shqyrtojë në mënyrë të pavarur për të përcaktuar nëse ekzistojnë praktika *opinio juris* të mjaftueshme në mbështetje të një zakoni të caktuar në një kohë të caktuar.³¹⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se qëndrimet e mbajtura nga KNKK-ja, qoftë në studimin e DHN-në Zakonore apo në

³¹⁷ Për një interpretim të ngjashëm të kuadrit ligjor të zbatueshëm për konfliktin e armatosur ndërkombëtar në lidhje me privimin e lirisë, *shih*, Office of the UN High Commissioner for Human Rights on Libya, [Investigation by the Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights on Libya: Detailed Findings](#), A/HRC/31/CRF.3, 15 February 2016, para. 128.

³¹⁸ *Shih gjithashtu*, International Law Commission, [Draft Conclusions on Identification of International Customary Law](#) ("ILC Draft Conclusions"), A/73/10, 10 August 2018, f. 132, para. 9 of commentary to Conclusion 4.

Shpjeguesit e Konventave të Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë janë përdorur më parë nga gjykata dhe tribunalë të tjerë, si udhëzues në marrjen e vendimeve të tyre.³¹⁹

158. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon gjithashtu se mbështetja në praktikën pas periudhës që mbulon Aktakuza mund të jetë e pranueshme në disa raste vetëm si një mjet dytësor, për të treguar zhvillimin e vazhdueshëm (përkundrejt praktikës së kundërt me të) të një rregulle zakonore që ndërkohë ekzistonte në kohën përkatëse. Në veçanti, në disa rrethana të caktuara, praktika e mëvonshme shtetërore mund të jetë një tregues i dobishëm i mungesës së praktikës që kundërshton krijimin e një zakoni (mosveprimi) dhe/ose i synimit të shteteve për të zbatuar në fakt një rregull zakonore tashmë ekzistuese, përderisa shtetet kanë mundur të reagonin ndaj një zakoni të tillë, nëse do të kishin pasur dëshirë. Rrjedhimisht, mbështetja në pak raste të praktikës pas periudhës së përfshirë në Aktakuzë, bëhet në përputhje me këto kritere të rrepta.³²⁰

159. Lidhur me ekzistencën e një rregulle zakonore që penalizon ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Shpjeguesi i KNKK-së lidhur me

³¹⁹ See for example ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Public Redacted Version of Judgement issued on 24 March 2016](#), 24 March 2016, para. 5949; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR72.5, Appeals Chamber, [Decision on Appeal of Trial Chamber's Decision on Preliminary Motion to Dismiss Count 11 of the Indictment](#), 9 July 2009, paras 24-25; *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 30 November 2006, para. 138; *Prosecutor v. Stakić* ("Stakić Appeal Judgment"), IT-97-24-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 22 March 2006, paras 296-297; *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-T, Trial Chamber I, Section A, [Judgement](#), 16 November 2005, para. 38 (footnote 88); *Prosecutor v. Aleksovski*, IT-95-14/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 24 March 2000, para. 22; *Prosecutor v. Mučić et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 16 November 1998, para. 208; ECCC, *Prosecutor v. Kaing* ("Duch Trial Judgment"), 001/18-07-2007/ECCC/TC, Trial Chamber, [Judgement](#), 26 July 2010, para. 441; SCSL, *Prosecutor v. Fofana et al.*, SCSL-04-14, Trial Chamber I, [Decision on motions for judgment of acquittal pursuant to Rule 98](#), 21 October 2005, para. 111; *Prosecutor v. Fofana and Kondewa*, SCSL-04-14-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 28 May 2008, paras 396, 398.

³²⁰ *Shih gjithashtu*, [ILC Draft Conclusions](#), conclusion 6(1) and its commentary . *Shih gjithashtu*, ICJ, *Dispute Regarding Navigational and Related Rights (Costa Rica v. Nicaragua)*, I.C.J. Reports 2009 (f. 213), [Judgement](#), 13 July 2009, para. 141 ("[...] mosmohimi nga Nikaragua i ekzistencës së një të drejte që rrjedh nga praktika që ka vazhduar e patrazuar dhe e pakundërshtuar për një kohë shumë të gjatë është veçanërisht i rëndësishëm [në përcaktimin e një rregulle zakonore]").

rregullën 99 të Studimit të DHN-së përmend një numër shtetesh që e kanë penalizuar heqjen arbitrare të lirisë, edhe gjatë një konflikti të armatosur jondërkombëtar.³²¹

160. Veçanërisht, neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së i penalizoi arrestimet dhe ndalimet e paligjshme, pa bërë dallim midis tyre apo pa kufizuar fushëveprimin e zbatimit të tyre në konflikte të armatosura ndërkombëtare apo jondërkombëtare, duke përdorur përkundrazi një formulim të trefishtë për përcaktimin e fushëveprimit: lufta, konflikti i armatosur dhe pushtimi, të cilat mund të përfshijnë situata konfliktesh të armatosura jondërkombëtare. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon gjithashtu se i njëjti tekst si ai i nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së është riprodhuar pak a shumë në dispozitat përkatëse për krimet e luftës të kodeve penale të tjerë të ish-Jugosllavisë: Kodi Penal i Sllovenisë i 1944;³²² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë i 1996;³²³ Kodi Penal i Kroacisë i 1997;³²⁴ Kodi Penal i Federatës së Bosnjë- Hercegovinës i 1998;³²⁵ dhe Kodi Penal i Republika Srpska i 2000.³²⁶ I gjithë ky legjislacion penal e përfshinte ndalimin arbitrar si krim lufte, pa bërë dallim midis konfliktit të armatosur ndërkombëtar dhe jondërkombëtar, ndryshe nga kodet penale në vende të tjera ku ligjvënësit, duke penalizuar të njëjtën sjellje, u referoheshin shprehimisht shkeljeve të rënda të Konventave të Gjenevës, duke kufizuar shprehimisht në këtë mënyrë fushëveprimin e zbatimit të tyre vetëm për konfliktet e armatosura ndërkombëtare.³²⁷

161. Jashtë ish-Jugosllavisë, kode të tjera penale po ashtu nuk kanë bërë dallim midis zbatueshmërisë së krimeve të luftës (përfshirë ndalimin arbitrar) në rastin e konfliktit

³²¹ Customary IHL Study, (Vol. II (Practice), f. 2331-2337 (Rule 99).

³²² Slloveni, Kodi Penal (Kazenski zakonik Republike Slovenije), 1994, neni 374(1).

³²³ Republika e Maqedonisë së Veriut, Kodi Penal (Кривичен законик на Република Северна Македонија), 1996, neni 404(1).

³²⁴ Kroaci, Kodi Penal (Kazneni zakon Republike Hrvatske), 1997, neni 158(1).

³²⁵ Federata e Bosnjë-Hercegovinës, Kodi Penal, (Krivični zakon Federacije Bosne i Hercegovine), 1998, neni 154(1).

³²⁶ Republika Srpska, Kodi Penal (Krivični zakon Republike Srpske), 2000, neni 433(1).

³²⁷ *Shih për shembull*, India, Geneva Conventions Act, 1960, Section 3(1); Cyprus, Geneva Conventions Act, 1966, Section 4(1); Botswana, Geneva Conventions Act, 1970, Section 3(1); Barbados, Geneva Conventions Act, 1980, Section 3(2); Canada, Geneva Conventions Act, 1985, Section 3(1); Luxembourg Law on the Punishment of Grave Breaches, 1985, Article 1(7).

të armatosur ndërkombëtar dhe jondërkombëtar,³²⁸ dhe disa prej tyre në fakt kanë përdorur të njëjtin formulim si kodet penale të vendeve të ish-Jugosllavisë.³²⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se disa instrumente legislative shpallin se një sjellje e tillë është krim lufte në konflikte të armatosura ndërkombëtare dhe jondërkombëtare,³³⁰ dhe se disa ligje kanë shkuar edhe më tej, duke penalizuar shkeljet e rënda edhe në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, duke bërë kështu të zbatueshëm sistemin e juridiksionit universal.³³¹

162. Krahas legjislacionit përkatës shtetëror si provë e praktikës shtetërore (si edhe e *opinio juris*), Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se praktika e organizatave ndërkombëtare, në formën e deklaratave dhe rezolutave, mund të mbështesë ekzistencën e një rregulle të së drejtës zakonore ndërkombëtare.³³² Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka shprehur dy herë shqetësimin e vet në lidhje me shkeljet e rënda të DHN-së në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe RSFJ gjatë viteve '90, duke iu referuar shprehimisht edhe praktikës së njëtrajtshme të ndalimeve të paligjshme ose arbitrare

³²⁸ *Shih për shembull*, Rumani, Kodi Penal (Codul penal al României), 1968, neni 358(d); Republika Demokratike e Kongos, Kodi i Drejtësisë Ushtarake (Code de justice militaire), 1972, neni 527; Armenia, Kodi Penal (ՀԱՅԱՍՏԱՆԻ ՀԱՆՐԱՊԵՏՈՒԹՅԱՆ ՔՐԵԱԿԱՆ ՕՐԵՆՍՊԻՐՔ / УГОЛОВНЫЙ КОДЕКС РЕСПУБЛИКИ АРМЕНИИ), 2003, neni 390.2(4).

³²⁹ *Shih për shembull*, Etiopi, Kodi Penal, 1957, neni 282(c); Parauai, Kodi Penal (Código Penal de Paraguai), 1997, neni 320(5); Poloni, Kodi Penal (Kodeks karny), 1997, neni 124; Portugali, Kodi Penal (Código penal), 1996, neni 241(1)(g).

³³⁰ *Shih për shembull*, Burundi, Ligji për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës (Loi N° 1/004 du 8 mai 2003 portant répression du crime de génocide, des crimes contre l'humanité et des crimes de guerre), 2001, neni 4(a)(d), (g); Zvicër, Kodi Penal (Code pénal Suisse/Codice penale svizzero/Strafgesetzbuch/Cudesch penal svizzer), 1937, neni 264(c)(2); Holandë, Akti mbi Të Drejtën Penale në kohë lufte (Wet oorlogsstrafrecht), 1952, neni 5(1) së bashku me nenin 1(3); Niger, Kodi Penal (Code Pénal du Niger), 1961, neni 208.3(6); Gjeorgji, Kodi Penal (საქართველოს სსრ-ის სამართლის კოდექსი), 1999, neni 411(2)(f); Nikaragua, Kodi Penal (Proyecto de Ley Nr. 641, Código Penal), 1999, neni 461.

³³¹ *Shih për shembull*, Belgjikë, Ligji që ka të bëjë me shtypjen e shkeljeve të rënda të Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve të tyre shtesë (Loi relative à la répression des violations graves de droit international humanitaire), 1993, neni 1(1)(6); Moldavi, Kodi Penal (Codul penal al Republicii Moldova), 2002, neni 391.

³³² ICJ, *Legal Consequences for States of the Continued Presence of South Africa in Namibia (South West Africa), Notwithstanding Security Council Resolution 276 (1970)*, I.C.J. Raporte 1971 (f. 16), [Advisory Opinion](#), 21 June 1971, para. 22.

nga të gjitha palët në konflikt.³³³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut shprehën të njëjtat shqetësime të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera edhe në lidhje me ndalimin arbitrar apo të paligjshëm.³³⁴ Në një rezolutë tjetër të prillit 1996 dhe në lidhje me konfliktin e armatosur jondërkombëtar në Sudan, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut u bëri thirrje të gjitha palëve në luftime³³⁵ të respektonin plotësisht Nenin e Përbashkët 3 dhe dy Protokollat Shtesë të vitit 1977 dhe “të mbrojnë të gjithë civilët [...] nga shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare, duke përfshirë [...] ndalimin arbitrar”.³³⁶

163. Së fundi, në Deklaratën Përmbyllëse të vitit 2002, delegacionet e Konferencës së Parë Parlamentare mbi të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Civilëve gjatë Konflikteve të Armatosura, shprehën shqetësimet e tyre lidhur me “numrin dhe zgjerimin e konflikteve në Afrikë dhe [...] përhapjen e [...] ndalimeve arbitrare”.³³⁷

164. Nga vetë karakteri praktikës së mësipërme shtetërore, e cila përfshin legjislacion shtetëror dhe shprehje të qëndrimeve sovrane përmes organizatave ndërkombëtare, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është gjithashtu i bindur se pranimi i nevojshëm i asaj praktike si ligj (*opinio juris*) ka ekzistuar në lidhje me konsolidimin e rregullës zakonore për ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar në kohën përkatëse.

³³³ UN Security Council, [Resolution 1019 \(1995\)](#), S/RES/1019, 9 November 1995; [Resolution 1034 \(1995\)](#), S/RES/1034, 21 dhjetor 1995.

³³⁴ UN General Assembly, [Resolution 50/193 \(1996\)](#), A/RES/50/193, 11 mars 1996; UN Commission on Human Rights, *Situation of Human Rights in the Republic of Bosnia and Herzegovina, the State of Bosnia and Herzegovina, the Republic of Croatia and the Federal Republic of Yugoslavia (Serbia and Montenegro)*, E/CN.4/RES/1996/71, 23 April 1996.

³³⁵ The Government of the Sudan, the South Sudan Independence Movement and the Sudan People's Liberation Movement-Bahr al Ghazal Group, para. 14 i Rezolutës.

³³⁶ UN Commission on Human Rights, *Situation of Human Rights in the Sudan*, E/CN.4/RES/1996/73, 23 April 1996, para. 15.

³³⁷ African Parliamentary Conference on International Humanitarian Law for the Protection of Civilians during Armed Conflict, [Final Declaration](#), Niamey, 18-20 February 2002, preamble.

165. Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet gjithashtu konstatimeve të tij se, në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve të paraqitura në akuza, të gjithë të akuzuarit mbanin poste të larta në UÇK, me një numër të madh përgjegjësish dhe kompetencash, të cilat u mundësonin informacion dhe njohuri publike të larmishme dhe se, rrjedhimisht e drejta zakonore ndërkombëtare ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për ta.³³⁸ Për të njëjtat arsye dhe duke marrë parasysh në veçanti penalizimin e heqjes arbitrare të lirisë në nivel rajonal në vendet e ish-Jugosllavisë (dhe më gjerë), si edhe dënimin e një sjelljeje të tillë nga Kombet e Bashkuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në kohën në fjalë për të akuzuarit ishte e disponueshme dhe e parashikueshme dijenia se përfshirja në veprime të heqjes arbitrare të lirisë mund të rezultonte në përgjegjësi penale individuale.

166. Duke u bazuar në praktikën e mësipërme shtetërore dhe *opinio juris*³³⁹ që rrjedh nga kombinimi i legjislacionit (penal) vendor dhe praktikës së shteteve që veprojnë në organizata ndërkombëtare dhe përmes këtyre organizatave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në kohën që lidhet me akuzat e ngritura në Aktakuzë, ekzistonte një rregull zakonore e cila e penalizonte ndalimin arbitrar si krim lufte në një konflikt të armatosur jondërkombëtar. Statusi i ligjit në nivelin vendor, rajonal dhe ndërkombëtar ishte mjaftueshëm i disponueshëm, i qartë dhe i parashikueshëm për të akuzuarit që të parashikonin pasojat penale të çdo veprimi të tillë.

2. Zhdukja me forcë e personave si krim kundër njerëzimit

167. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimet e tij se në gjykimin e krimeve sipas neneve 13 dhe 14 të Ligjit, që pretendohet të jenë kryer brenda juridiksionit kohor të saj, DHS-ja zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare.³⁴⁰

³³⁸ *Shih*, para. 103-104 më lart.

³³⁹ *Shih për shembull*, ICJ, [Asylum Case](#), f. 14-15; [Fisheries Case](#), f. 131; [North Sea Continental Shelf Case](#), para. 77; [Continental Shelf Case](#), para. 27; [Nicaragua Case](#), para. 183; [Jurisdictional Immunities Case](#), para. 55.

³⁴⁰ *Shih para*. 102 më lart.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton gjithashtu se zhdukja me forcë e personave si krim kundër njerëzimit përfshihet shprehimisht në nenin 13 të Ligjit, ku ligjvënësit kosovarë kanë synuar të pasqyrojnë krimet kundër njerëzimit që konsiderohen të tilla sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të DHS-së, sikurse vihet në dukje nga përmbajtja e kësaj dispozite.

168. Megjithatë, përfshirja tekstuale e zhdukjes me forcë të personave në nenin 13 të Ligjit nuk e cenon të drejtën e Mbrojtjes për të kundërshtuar statusin zakonor të këtij krimi në 1998-1999, në përputhje me detyrimin e DHS-së për të verifikuar që çdo krim i paraqitur si akuzë të përmbushë parimin e ligjshmërisë në kontekstin e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Për mendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, praktika shtetërore tregon njëtrajtshmëri si në rajon, po edhe në botë të ndalimit zakonor të zhdukjes me forcë të personave, si krim më vete kundër njerëzimit më së voni nga viti 1998. Nuk është bindës argumenti i Mbrojtjes se përpara vitit 1998 ekzistonin vetëm dy instrumente, konkretisht Deklarata e vitit 1992 e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë dhe Konventa Panamerikane e vitit 1994 për zhdukjen me forcë të personave (“Konventa Panamerikane”), për të cilat supozohet se nuk mjaftojnë për të mbështetur ekzistencën e një rregulle zakonore. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se qasja selektive e Mbrojtjes nuk merr parasysh demonstrimin e praktikës shtetërore dhe *opinio juris* gjatë dekadave dhe se si ato përforcojnë njëra-tjetrën në përcaktimin e ekzistencës së një rregulle zakonore në kohën e krimeve të pretenduara.

169. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se një numër shtetesh e kishin penalizuar ndërkohë zhdukjen me forcë të personave në legjislacionin e tyre vendor (ushtarak dhe civil) në kohën që lidhet me Aktakuzën.³⁴¹ Gjithashtu, shtetet kanë marrë qëndrim

³⁴¹ Colombia, Basic Military Manual (Básico para las Personerías y las Fuerzas Armadas de Colombia), 1995, f. 30; Commander of the Regional Military Command of Irian Jaya and Maluku, Directive Concerning Human Rights, 1995, para. 8; Peru, Human Rights Charter of the Security Forces (Derechos Humanos: El Decálogo de las Fuerzas del Orden), 1991, f. 19; Azerbaixhan, Kodi Penal (Azərbaycan Respublikasının Cinayət Məcəlləsi), 1999, Neni 110; Belarus, Kodi Penal (Уголовный кодекс

(shumë) më herët se 1998 mbi ndalimin me ligj të zhdukjes me forcë të personave si në nivel rajonal³⁴² ashtu edhe botëror, përmes raporteve zyrtare dhe rezolutave të OKB-së.³⁴³ Ky proces i hershëm ka evoluar në kodifikimin e njëkohshëm të zhdukjes me forcë të personave në nivel rajonal, përmes Konventës Panamerikane,³⁴⁴ dhe në nivel botëror nga Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare.³⁴⁵ Sa i takon këtij të fundit, pretendimi i Mbrojtjes se Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare nuk e kishte përfshirë zhdukjen me forcë të personave në projektin e tij për Krimet kundër Paqes dhe Sigurisë së Njerëzimit të vitit 1991 është pa lidhje, sepse një sjellje e tillë ishte përfshirë në versionin e vitit 1996,³⁴⁶ në pajtim me krijimin e një rregulle zakonore për këtë çështje brenda vitit 1998. Pavarësisht nga kjo tendencë tashmë e qartë, këto përpjekje për kodifikim shkuan më tej me miratimin e Statutit të GJPN-së më

Республики Беларусь), 1999, Neni 128; Belgium, Kodi Penal (Strafwetboek / Code Pénal), 1867 (i ndryshuar në 2003), Neni 136 *ter*; Belgium, Ligji Relating to the Repression of Grave Breaches of International Humanitarian Ligji (Loi relative à la répression des violations graves de droit international humanitaire), 1993 (i ndryshuar në 2003) Neni 1 *bis*; Congo, Genocide, War crimes and Crimes Against Humanity Act (Loi Nr. 8-98 du 31 octobre 1998 portant définition et répression du génocide, des crimes de guerre et des crimes contre l'humanité), 1998, Neni 6; Croatia, Kodi Penal (Kazneni zakon Republike Hrvatske), 1997, neni 157(a); Danimarkë, Military Kodi Penal (Militær straffelov), 1973 (i ndryshuar në 1978), Seksioni 25(1); El Salvador, Kodi Penal (Código Penal), 1997, Neni 364; France, Kodi Penal (Code Pénal), 1992, neni 212(1); Niger, Kodi Penal (Code Pénal du Niger), 1961 (i ndryshuar në 2003), Neni 208(2); Paraguaj, Kodi Penal (Código Penal de Paraguay), 1997, Neni 236; Senegal, Kodi Penal (Code Pénal), 1965 (i ndryshuar në 2007), neni 431-2(6); Zvicër, Kodi Penal Ushtarak, 1927 (i ndryshuar deri në 2011), nenet 5(1)(1)(d), (5) dhe 109(1)(e).

³⁴² Organisation of American States, *Resolution AG/RES. 666 (XIII-O/83)*, 18 November 1983, f. 69; Parliamentary Assembly of the Council of Europe, *Resolution 828*, 1984, para. 12.

³⁴³ UN General Assembly, *Resolution 33/173 ("Disappeared Persons")*, A/RES/33/173, 20 December 1978; UN Economic and Social Council, *Report of the Sub-Commission on Prevention of Discrimination and Protection of Minorities on its 36th Session*, E/CN.4/1986/5, EC/CN.4/Sub.2/1985/57, 4 November 1985; UN Economic and Social Council, *Report of the Sub-Commission on Prevention of Discrimination and Protection of Minorities on its 36th Session*, E/CN.4/1984/3, E/CN.4/Sub.2/1983/43, 20 October 1983, para. 283; UN General Assembly, *Declaration on the Protection of All Persons from Enforced Disappearance*, A/RES/47/133, 18 December 1992, f. 1.

³⁴⁴ Inter-American Convention, *AG/RES. 1256 (XXIV-O/94)*, 6 September 1994, preamble, Article 1(b).

³⁴⁵ International Law Commission, *Yearbook of the International Law Commission 1991, Vëllimi II, Pjesa e dytë, Report of the Commission to the General Assembly on the work of its forty-third session*, A/46/10, 19 July 1991, f. 104; International Law Commission, *Yearbook of the International Law Commission 1996, Volume II, Part Two, Report of the Commission to the General Assembly on the work of its forty-eighth session*, A/51/10, 26 July 1996, f. 47, 50.

³⁴⁶ International Law Commission, *Yearbook of the International Law Commission 1996, Volume II, Part Two, Report of the Commission to the General Assembly on the work of its forty-eighth session*, A/51/10, 26 July 1996, f. 47, 50.

1 korrik 1998 nga një shumicë prej 120 shtetesh. Rrjedhimisht, penalizimi në Statutin e GJPN-së i zhdukjes me forcë të personave është me rëndësi, edhe pse jo një tregues përcaktues i karakterit zakonor të këtij krimi.³⁴⁷ Argumenti i Mbrojtjes se gjatë negociatave lidhur me përcaktimin e zhdukjes me forcë të personave si krim kundër njerëzimit pati debate të konsiderueshme midis delegacioneve³⁴⁸ përsëri bie, përderisa një krim i tillë kundër njerëzimit përfundimisht u përfshi në Statutin e GJPN-së.

170. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të rëndësishëm faktin që dy tribunalë me juridiksion³⁴⁹ ndaj zhdukjes me forcë si krim kundër njerëzimit, veçanërisht Dhomat e Jashtëzakonshme të Afrikës (“EAC”) dhe Panelet Speciale për Krime të Rënda (“SPSC”) në Gjykatën e Qarkut në Dili, proceduan penalisht persona për krime të tilla, të lidhura me fakte që ndodhën përkatësisht nga 1982-1990 dhe deri në prill 1999.³⁵⁰ Statusi zakonor i zhdukjes me forcë të personave, si një krim më vete kundër njerëzimit më 1998, mbështetet më tej nga konstatimet e Gjykatës Supreme të DHJGJK-së, e cila arrit në përfundimin se një kristalizim i tillë kishte ndodhur në kohën që kjo sjellje u përfshi si kategori e dallueshme e krimeve kundër njerëzimit në Statutin e GJPN-së.³⁵¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se Gjykata Shtetërore e Bosnjë-Hercegovinës arriti në përfundimin se zhdukja me forcë e personave ishte bërë krim zakonor lidhur me faktet e ndodhura më 1992.³⁵²

³⁴⁷ Statuti i TPNJ-së, neni 7(1)(i).

³⁴⁸ Nga puna përgatitore, del se vetëm delegacionet indiane dhe ruse kundërshtuan përfshirjen e zhdukjes me forcë të personave në Statutin e GJPN-së, ndërsa delegacionet e tjera thjesht mbështetën idenë e një përkufizimi më të hollësishëm të këtij krimi, pa e kundërshtuar atë si të tillë (*shih*, United Nations Diplomatic Conference of Plenipotentiaries on the Establishment of an International Criminal Court Rome, 15 June - 17 July 1998, Official Records, Volume II, Summary records of the plenary meetings and of the meetings of the Committee of the Whole, A/CONF.183/13 (Vol.11).

³⁴⁹ UN Transitional Administration in East Timor, *Regulation 2000/15 on the Establishment of Panels with Exclusive Jurisdiction over Serious Criminal Offences*, UNTAET/REG/2000/15, 6 June 2000, Section 5.1(i); EAC Statute, Articles 3 and 11, 52 ILM (2013), f. 1020–1036, artikl 6(f).

³⁵⁰ SPSC, *Maubere*, 23/2003, Judgement, 11 September 2003, f. 7; EAC, *Habré*, Judgement, 30 May 2016, para. 1457-1466.

³⁵¹ ECCC, *Prosecutor v. Nuon Chea and Khieu Samphan*, 002/19-09-2007-ECCC/SC, Supreme Court Chamber, [Appeal Judgement](#) (“Case 002 Appeal Judgement”), 23 November 2016, para. 589.

³⁵² Bosnia-Herzegovina *Boban Šimšić*, State Court, Panel of the Appellate Division, [Verdict](#), X-KRŽ-05/04, 7 August 2007, f. 47.

171. Krahas praktikës së përgjithshme dhe të njëtrajtshme të analizuar më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën me dije se mund ta marrë parasysh dhe praktikën e mëvonshme vetëm si një mjet dytësor, që provon konsolidimin e rregullës zakonore që ekzistonte në kohën në fjalë.³⁵³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren në këtë drejtim se procesi i penalizimit të zhdukjes me forcë të personave vazhdoi si rrjedhojë e miratimit të Statutit të GJPN-së,³⁵⁴ duke dëshmuar kështu pranimin në vijimësi të ndalimit detyrues të këtij krimi dhe duke i dhënë fuqi ligjore ekzistencës së tij të rrënjësuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare.

172. Nga vetë karakteri i praktikës shtetërore të mësipërme, e cila përfshin kodifikimin e legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar, mbështetur nga jurisprudenca dhe shprehjet e qëndrimeve sovrane përmes organizatave ndërkombëtare, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur gjithashtu se pranimi i nevojshëm i asaj praktike si ligj (*opinio juris*) ekzistonte lidhur me konsolidimin e një rregulle zakonore për zhdukjen me forcë të personave përpara vitit 1998.

173. Lidhur me kriteret e disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimet e tij se, në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve të akuzuara, të gjithë të akuzuarit mbanin poste të larta në UÇK, kishin një numër të madh përgjegjësish dhe kompetencash të cilat u mundësonin informacion dhe njohuri publike të larmishme dhe se, rrjedhimisht e drejta zakonore ndërkombëtare ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për ta.³⁵⁵ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh se praktika e zhdukjes me forcë të personave gjatë konflikteve të armatosura në ish-Jugosllavi ishte dënuar vazhdimisht

³⁵³ *Shih*, para. 158 më lart.

³⁵⁴ *Shih për shembull*, Germany, Code of Crimes against International Law, Section 7(1); Belgium, Criminal Code, Article 136ter; France, Criminal Code, Article 212-1; Bosnia and Herzegovina, Criminal Code, Article 172(1)(i); Australia, ICC Consequential Amendments Act, 2002, Section 268.21; Canada, Crimes Against Humanity and War Crimes Act, 2000, Section 4(1), (4); New Zealand, International Crimes and ICC Act, 2000, Section 10(2). *See also further references in* Hall, C., van den Herik, L., "Article 7", in Triffterer, O. and Ambos K. (eds), *Rome Statute of the International Criminal Court: A Commentary*, C.H. Beck, Hart, Nomos 2016 (third edition), p. 231, footnote 525.

³⁵⁵ *Shih*, para. 103-104 above.

nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara,³⁵⁶ duke u dhënë kështu mundësi të tjera informimi të akuzuarve për pasojat e përfshirjes në një sjellje të tillë. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në kohën në fjalë për të akuzuarit ishte e disponueshme dhe e parashikueshme dijenia se përfshirja në veprime që kishin të bënin me zhdukjen me forcë të personave mund të rezultonte në përgjegjësi penale individuale.

174. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, gjatë periudhës kohore të akuzave të ngritura në Aktakuzë, ekzistonte një rregull zakonore e cila e penalizonte zhdukjen me forcë të personave si krim kundër njerëzimit. Statusi i Ligjit, në nivel vendor dhe ndërkombëtar, ishte mjaftueshëm i disponueshëm, i qartë dhe i parashikueshëm që të akuzuarit të mund të parashikonin se kryerja e një krimi të tillë mund të rezultonte në përgjegjësi penale individuale.

175. Së fundi, në lidhje me argumentet e Mbrojtjes se për të provuar krimin e zhdukjes me forcë të personave kërkohet ekzistenca e një synimi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këto argumente prekin elementet përbërëse të këtij krimi. Këto aspekte nuk janë me karakter juridiksional, sepse nuk lidhen me aspektin nëse zhdukja me forcë është e zbatueshme në DHS. Përkundrazi, ato kanë të bëjnë me përkufizimin e krimit, i cili mund të diskutohet gjatë gjykimit. Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes për këtë aspekt duhen hedhur poshtë.

³⁵⁶ UN Security Council, [Resolution 1034 \(1995\)](#), S/RES/1034, 21 December 1995, f. 1-2; UN Commission on Human Rights, *Situation of Human Rights in the Republic of Bosnia and Herzegovina, the State of Bosnia and Herzegovina, the Republic of Croatia and the Federal Republic of Yugoslavia (Serbia and Montenegro)*, E/CN.4/RES/1996/71, 23 April 1996, f. 4-5; UN General Assembly, [Resolution 50/193 \(1996\)](#), A/RES/50/193, 11 March 1996, para. 2, 4.

D. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

1. Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët

(a) Neni 16(1)(a) i Ligjit dhe zbatueshmëria e legjislacionit të Kosovës

176. Mbrojtja pretendon se (i) mospërfshirja e NKP-së në tekstin e nenit 16(1)(a) të Ligjit duket se është një zgjedhje e qëllimshme për ta refuzuar si formë përgjegjësie në DHS;³⁵⁷ dhe (ii) duke qenë se asnjë nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal të RSFJ-së nuk parashikon një formë përgjegjësie të ngjashme me NKP-në dhe duke pasur parasysh aktgjykimin e GJK-së serbe të vitit 2020, termi “kryerje” duhet përdorur sipas legjislacionit të Kosovës.³⁵⁸

177. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes lidhur me mungesën e NKP-së në tekstin e nenit 16(1)(a) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo dispozitë rendit planifikimin, hetimin, urdhërimin, kryerjen dhe ndihmën dhe inkurajimin si forma përgjegjësie penale të zbatueshme për krime sipas nenit 13-14 të Ligjit. Ndryshe nga paragrafët (2) dhe (3) të së njëjtës dispozitë të cilët i referohen të drejtës penale të Kosovës, paragrafi (1) nuk i referohet ndonjë burimi ligjor të zbatueshëm. Rrjedhimisht, neni 16(1) i Ligjit parashikon një sistem autonom të formave të përgjegjësisë penale që duhen zbatuar për krime sipas neneve 13-14 të Ligjit. Gjithsesi, ky sistem autonom duhet të interpretohet në përputhje me kornizën ligjore të DHS-dhe në kontekstin e kësaj kornize ligjore. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake formulon konstatimet e mëposhtme. Së pari, sikurse konstatohet më lart, nëpërmjet neneve 3(2)(c)-(d), (4) dhe 12 të Ligjit, DHS-ja zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare si burimin kryesor të saj dhe të drejtën materiale penale të Kosovës ku kjo e fundit është përfshirë konkretisht në Ligj dhe nëse është në pajtim me të drejtën

³⁵⁷ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 22, 26-27; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 61; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 17-18, 21; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 95.

³⁵⁸ Kundërpërgjigja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 24-32; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 62; Kundërpërgjigja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 5g.

zakonore ndërkombëtare.³⁵⁹ Së dyti, nenet 13-14 të Ligjit i referohen konkretisht të drejtës zakonore ndërkombëtare si e drejta e zbatueshme për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte gjatë juridiksionit kohor të DHS-së. Së treti, terminologjia e përdorur në nenin 16(1)(a) të Ligjit është praktikisht e njëjtë me dispozitat që rregullojnë format e përgjegjesisë penale në statutet e TPNJ-së dhe TPNR-së, të cilët kanë zbatuar forma të përgjegjesisë penale nga e drejta zakonore ndërkombëtare.³⁶⁰ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se neni 16(1) i Ligjit, duke përfshirë edhe kuptimin që i ka dhënë “kryerjes”, duhet interpretuar në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara. Pyetja nëse NKP-ja ishte një formë kryerjeje sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse trajtohet më poshtë.³⁶¹

178. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes në lidhje me zbatimin e formave vendore të përgjegjesisë penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se neni 16(1) i Ligjit, në ndryshim nga paragrafët (2) dhe (3) të tij, nuk përfshin shprehimisht dispozitat e legjislacionit të Kosovës.³⁶² Për më tepër, format e përgjegjesisë penale të zbatueshme në të drejtën penale materiale të Kosovës në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara, ndonëse veç e veç janë të ngjashme me ato në nenin 16(1)(a) të Ligjit, ofrojnë një sistem përgjegjësie penale të ndryshëm nga pikëpamja strukturore.³⁶³ Për më tepër, sa u takon argumenteve të Mbrojtjes lidhur me zbatueshmërinë e Aktgjykimit të GJK-së serbe të vitit 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të tij në paragrafin 100. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se dispozitat e të drejtës penale materiale të Kosovës që rregullojnë format

³⁵⁹ *Shih*, para. 99, 102 më lart.

³⁶⁰ *Shih*, Statuti i TPNJ-së, neni 7(1); Statuti i TPNR-së, neni 6(1). *Shih gjithashtu*, Statuti i GJSSL-së, neni 6(1); Statuti i MPNTP-së, neni 1(1).

³⁶¹ *Shih*, para. 180-190 më poshtë.

³⁶² *Shih para*. 99, 102 më lart.

³⁶³ Kodi Penal i RSFJ-së, nenet 11-32 (në Kapitullin Dy – Sjellja Kriminale dhe Përgjegjësia Penale).

e përgjegjesisë penale nuk janë të zbatueshme në interpretimin e sistemit autonom të nenit 16(1) të Ligjit.

179. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në lidhje me krimet sipas neneve 13-14 të Ligjit, DHS-ja mund të zbatojë vetëm forma të përgjegjesisë penale që kanë qenë pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara.

(b) NKP-ja dhe e drejta zakonore ndërkombëtare

180. Mbrojtja e kundërshton karakterin zakonor të NKP-së si në formën e saj bazë ("NKP I"), ashtu edhe në formën e saj të zgjeruar ("NKP III"),³⁶⁴ dhe parashtron se ajo nuk duhet përdorur nga DHS-ja si formë kryerjeje sipas nenit 16(1) të Ligjit.³⁶⁵ Mbrojtja pretendon se: (i) Karta e Nurembergut dhe CCL10 u miratuan pas kryerjes së krimeve dhe nuk e mbështesin NKP I dhe III;³⁶⁶ (ii) jurisprudenca pas Luftës së Dytë Botërore e cituar nuk e mbështet as NKP I,³⁶⁷ as NKP III,³⁶⁸ dhe marrë së bashku me jurisprudencën pas juridiksionit të DHS-së, nuk është e mjaftueshme për të përcaktuar

³⁶⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se NKP-ja është një formë përgjegjësie që përfshin tri forma apo kategori (bazë, sistimore dhe e zgjeruar). Në formën bazë të saj ("NKP I"), disa kryes veprojnë në bazë të një qëllimi të përbashkët; në formën sistimore ("NKP II"), një variant i formës së parë, krimet kryhen brenda një sistemi të organizuar keqtrajtimi, nga pjesëtarët e njësiteve ushtarake apo administrative, si për shembull në kampe përqendrimi apo ndalimi; në formën e zgjeruar ("NKP III"), një bashkëkryes mban përgjegjësi penale për akte që dalin jashtë kuadrit të planit të përbashkët, por që ishin pasojë e parashikueshme e realizimit të planit. *Shih* Vendimi i Konfirmimit, para. 105.

³⁶⁵ Për NKP I: Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 36-43, 44-55; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 63; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24. Për NKP III: Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 56-68; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 67-71; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24-49; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 98-105, 115-119.

³⁶⁶ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 52; Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 49-52; Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 14.

³⁶⁷ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 36-55; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24; Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 53-59.

³⁶⁸ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 58-62, 64-67; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 68; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24, 28, 31, 33, 34, 36-37; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 100-101; Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 18; Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 18.

të drejtën zakonore ndërkombëtare;³⁶⁹ (iii) duke pasur parasysh kundërshtinë aktuale midis NKP-së dhe bashkëkryerjes, parashikuar në Statutin e GJPN-së si forma konkurruese të përgjegjësisë penale, e para nuk mund të ketë marrë karakter zakonor;³⁷⁰ (iv) (ish) gjykatësit e tribunalëve ndërkombëtarë, literatura akademike dhe jurisprudenca shtetërore e kohëve të fundit kanë hedhur dyshime serioze mbi karakterin zakonor të NKP III,³⁷¹ dhe (v) NKP III nuk mbështetet nga traktatet ndërkombëtare dhe nuk përbën një parim të përgjithshëm të së drejtës.³⁷²

181. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se karakteri zakonor i NKP-së është shqyrtuar gjerësisht dhe është konfirmuar vazhdimisht nga të gjithë tribunalët ndërkombëtarë bashkëkohorë që kanë zbatuar NKP-në,³⁷³ përveç nga DHJGJK-së në lidhje me NKP III.³⁷⁴ Duke u bazuar në nenin 3(3) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të marrë parasysh këtë jurisprudencë përputhëse dhe t'i trajtojë pikat e mësipërme vetëm për të përcaktuar nëse Mbrojtja ka paraqitur arsye bindëse që përlligjin konstatime të ndryshme ligjore për çështjen në diskutim.

182. Përpara trajtimit të pikave të mësipërme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake formulon konstatimet e mëposhtme lidhur me identifikimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Së pari, e drejta zakonore ndërkombëtare ka dy elemente përbërëse: praktikën e përgjithshme dhe pranimin e saj si ligj (*opinio juris*).³⁷⁵ Në lidhje me përcaktimin nëse praktika është e përgjithshme, duhet gjithashtu të merret parasysh shpeshtësia e krijimit të rrethanave që kërkojnë të veprohet, bashkë me praktikën e

³⁶⁹ Kundërpërgjigjja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 60-67.

³⁷⁰ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 63-66; Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 24-25.

³⁷¹ Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 69-70; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 25; Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 39-40;

³⁷² Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 39-48; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 102.

³⁷³ *Shih*, poshtëshënimet 391-396, 399-403 më poshtë.

³⁷⁴ *Shih*, poshtëshënimi 405 më poshtë.

³⁷⁵ [ILC Draft Conclusions](#), conclusion 2; ICJ, [Nicaragua Case](#), para. 183, 186; [North Sea Continental Shelf Case](#), para. 74, 77.

shteteve më të prekura.³⁷⁶ Për t'u pranuar si ligj, praktika përkatëse duhet ndërmarrë me idenë e një të drejte apo detyrimi ligjor;³⁷⁷ kjo kërkon pranim të gjerë dhe përfaqësues, si dhe moskundërshtim apo pak kundërshtim.³⁷⁸ Dëshmitë e praktikës shtetërore mund të kenë një mori formash,³⁷⁹ duke përfshirë vendime të gjykatave ndërkombëtare dhe vendore.³⁸⁰ Së dyti, të dy elementet përbërëse duhet të përcaktohen duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm, karakterin e rregullës dhe rrethanat e veçanta ku duhen gjetur provat në fjalë.³⁸¹ Marrja parasysh e kontekstit të përgjithshëm do të thotë se duhen marrë parasysh siç duhet lënda që rregullon rregulla e pretenduar dhe parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare që mund të jenë të zbatueshme për atë lëndë.³⁸²

183. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes se Karta e Nurembergut dhe CCL10 u miratuan pas kryerjes së krimeve dhe nuk mbështesin NKP I dhe III, fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ndonëse asnjëri prej dy instrumenteve nuk pretendon të mishërojë një kodifikim shterues të së drejtës zakonore ndërkombëtare, të dy pasqyrojnë të drejtën e mëhershme. Në veçanti, dokumentet themelore që rezultuan në miratimin e Kartës së Nurembergut dhe CCL10 shprehin qartë se e drejta e zbatuar ishte e njëkohshme me krimet.³⁸³ Për më tepër, të dy instrumentet

³⁷⁶ [ILC Draft Conclusions](#), commentaries (3)-(4) to conclusion 8.

³⁷⁷ [ILC Draft Conclusions](#), commentary (2) to conclusion 9; ICJ, [North Sea Continental Shelf Case](#), para. 77; [Asylum Case](#), f. 276.

³⁷⁸ [ILC Draft Conclusions](#), commentary (5) to conclusion 9; ICJ, [Nicaragua Case](#), para. 186; *Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons*, I.C.J. Reports 1996 (f. 226), [Advisory Opinion](#), 8 July 1996, para. 67.

³⁷⁹ [ILC Draft Conclusions](#), conclusion 10(1).

³⁸⁰ [ILC Draft Conclusions](#), conclusion 13; ICJ, [Jurisdictional Immunities Case](#), para. 55; *Case Concerning the Arrest Warrant of 11 April 2000 (Democratic Republic of the Congo v. Belgium)*, [Judgement](#), 14 Shkurt 2002, para. 58; PCIJ, *The Case of the S.S. "Lotus" (France v. Turkey)*, Series A, Nr. 10, [Judgement](#), 7 September 1927, f. 28.

³⁸¹ [ILC Draft Conclusions](#), conclusion 3.

³⁸² [ILC Draft Conclusions](#), commentary (3) to conclusion 3.

³⁸³ *Shih për shembull International Conference on Military Trials: London, 1945, American Memorandum Presented at San Francisco, 30 April 1945*, ku parashtrohet se, "Udhëheqësit gjermanë dhe ndihmësit e tyre" duhet të akuzohen për "pjesëmarrje të përbashkët në një ndërmarrje kriminale të gjerë" dhe "duhet të përdoret rregulla e përgjegjësisë penale, e përbashkët për shumicën e sistemeve penale dhe e përfshirë në doktrinën e përgjithshme të ligjeve të luftës, se ata që marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e një plani kriminal që përfshin krime të shumta janë bashkërisht përgjegjës për secilën nga veprat penale të kryera dhe bashkërisht përgjegjës për veprimet e njëri tjetrit" (Pjesa III.B). I njëjti

përcaktojnë qartë përgjegjësinë penale për pjesëmarrje në një plan apo ndërmarrje të përbashkët.³⁸⁴ Gjithashtu, disa çështje penale pas Luftës së Dytë Botërore konfirmojnë se e drejta e zbatuar prej tyre ishte e drejta ndërkombëtare e mëhershme.³⁸⁵ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se argumenti i Mbrojtjes është i pathemeltë.

184. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes se jurisprudenca e cituar pas Luftës së Dytë Botërore nuk mbështet NKP I,³⁸⁶ apo NKP III,³⁸⁷ dhe se shoqëruar me jurisprudencën pas juridiksionit të DHS-së, është e pamjaftueshme për të përcaktuar të drejtën zakonore ndërkombëtare, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se si formë përgjegjësie penale, NKP-ja u sistematizua në aktgjykimin e apelit në çështjen *Tadić* më 1999 nga TPNJ-ja, ku Dhoma e Apelit shpalli tri format e kësaj përgjegjësie penale.³⁸⁸

memorandum po ashtu i referohet “ndërmarrjes së madhe naziste, ku krimet dhe mizoritë që tronditën botën, ishin pjesë përbërëse apo të paktën pasojë e natyrshme dhe e mundshme” (Pjesa V). *Shih gjithashtu*, Memorandumi i Jaltës /Yalta Memorandum/, i cili ishte pararendës i Memorandumit të San Franciskos /San Francisco Memorandum/ dhe i cili përfshin një gjuhë të ngjashme në Pjesën V. International Conference on Military Trials: London, 1945, [Memorandum to President Roosevelt from the Secretaries of State and War and the Attorney General](#), 22 January 1945.

³⁸⁴ Karta e Nurenbergut/ Nuremberg Charter, neni 6: “Udhëheqësit, organizatorët, nxitësit dhe ndihmësit që marrin pjesë në hartimin apo realizimin e një plani apo konspiracioni të përbashkët për kryerjen e ndonjërit prej krimeve të mësipërme janë përgjegjës për të gjitha veprimet e kryera çdo person në realizimin e një plani të tillë”. *Shih gjithashtu*, Charter of the International Military Tribunal for the Far East, 19 January 1946, neni 5(c) me tekst të njëjtë; CCL10, Neni II(2)(d): “Çdo person [...] gjykohet se ka kryer një krim sikundër përkufizohet në paragrafin 1 të këtij neni, nëse ai [...] (d) lidhet me planet apo ndërmarrjen që përfshin kryerjen e tij [...]”.

³⁸⁵ [US v. Goering et al.](#) (“IMT Judgement”), International Military Tribunal, Judgement, 1 tetor 1946, tek *Trial of the Major War Criminals*, Vëllimi I, 1947, f. 444; [US v List et al.](#) (“Hostages”), Military Tribunal, Judgement, 19 February 1948, in CCL10 Military Tribunals, US Government Printing Office, Volume XI, 1951, f. 53; [Einsatzgruppen](#), f. 457-458.

³⁸⁶ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 36-55; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24; Kundërpërgjigja e Selimit lidhur me NKP-në, para. 53-59.

³⁸⁷ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 58-62, 64-67; Mocioni i Thaçit lidhur me Juridiksionin, para. 68; Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 24, 28, 31, 33, 34, 36-37; Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 100-101; Kundërpërgjigja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 18; Kundërpërgjigja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 18.

³⁸⁸ [Tadić Appeal Judgement](#), para. 195-226. Në Aktgjykimin *Furundžija* të TPNJ-së të dhjetorit 1998, për herë të parë u bë dallimi i NKP-së si një formë bashkëkryerje nga format e tjera të përgjegjësisë penale. *Shih, Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Furundžija Trial Judgement”), 10 December 1998, para. 214-215, 250-257.

185. Lidhur me NKP I, Dhoma e Apelit e TPNJ-së u mbështet në çështjen *Sandroek et al.* (“*Almelo*”), *Hoelzer et al.*, *Jepsen and others*, *Schonfeld and others*, *Feurstein and others* (“*Ponzano*”) dhe *Ohlendorf et al.* (“*Einsatzgruppen*”) dhe erdhi në përfundimin se kjo ishte e përcaktuar qartë në të drejtën zakonore ndërkombëtare.³⁸⁹ Gjithashtu, Dhoma e Apelit e TPNR-së në vendimin e saj të tetorit 2004 për çështjen *Rwamakuba* dhe Dhoma e Apelit e TPNJ-së, në aktgjykimin e saj në prill 2007 për çështjen *Brđanin* identifikoi çështjet *Alstoetter et al.* (“*Justice*”) dhe *Greifelt et al.* (“*RuSHA*”) si prova shtesë për karakterin zakonor të NKP-së.³⁹⁰ Këto përfundime janë konfirmuar

³⁸⁹ [Tadić Appeal Judgement](#), para. 196-201, që i referohet: [Trial of Sandroek et al.](#) (“*Almelo*”), British Military Court for the Trial of War Criminals, Almelo, Holland, 24-26 November 1945, in *United Nations War Crimes Commission – Law Reports of Trials of War Criminals* (“UNWCC Law Reports”), Vëllimi I; [Holzer et al.](#), Canadian Military Court, 25 March – 6 April 1946, në *Record of Proceedings at Aurich, Germany*, Volume I; [Trial of Gustav Alfred Jepsen et al.](#), Proceedings of a War Crimes Trial held at Luneberg, Germany 13-23 August 1946, Judgement, 24 August 1946; [Trial of Franz Schonfeld et al.](#), British Military Court, Essen, 11-26 June 1946, në UNWCC Law Reports, Volume XI; [Trial of Feurstein and others](#) (“*Ponzano*”), Proceedings of a War Crimes Trial held at Hamburg, Germany, 4-24 August 1948; [US v. Ohlendorf et al.](#) (“*Einsatzgruf.en*”), US Military Tribunal, *Proceedings and Judgement*, 8 July 1947 – 10 April 1948, në *Trials of War Criminals before the Nuremberg Military Tribunals under Control Council, Law No. 10* (“CCL10 Military Tribunals”), US Government Printing Office, Volume IV, 1951.

³⁹⁰ ICTR, *Prosecutor v. Rwamakuba*, ICTR-98-44-AR72.4, Appeals Chamber, [Decision on Interlocutory Appeal Regarding Application of Joint Criminal Enterprise to the Crime of Genocide](#) (“*Rwamakuba Appeals Chamber Decision*”), 22 October 2004, para. 13-31; ICTY, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 3 April 2007, para. 431. Të dy vendimet i referoheshin: [US v. Alstoetter et al.](#) (“*Justice*”), US Military Tribunal, Judgment, 3-4 December 1947, in CCL10 Military Tribunals, US Government Printing Office, Volume III, 1951, 1951; [US v. Greifelt et al.](#) (“*RuSHA*”), US Military Tribunal, Judgment, 10 March 1948, in CCL10 Military Tribunals, US Government Printing Office, Volumes IV-V 1951. The [Rwamakuba Appeals Chamber Decision](#) (para. 23) gjithashtu identifikoi një pjesë që ka lidhje me këtë në [IMT Judgement](#). Shih gjithashtu, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Đorđević*, IT-05-87/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“*Đorđević Appeal Judgement*”), 27 January 2014, para. 32-34.

vazhdimisht nga TPNJ-ja,³⁹¹ TPNR-ja,³⁹² GJSSL-ja,³⁹³ TSL-ja³⁹⁴, DHJGJK-ja³⁹⁵ dhe MPNTP-ja.³⁹⁶ Duke u bazuar në konfirmimin e përsëritur të çështjeve të lartpërmendura pas Luftës së Dytë Botërore si dëshmi të karakterit zakonor të NKP I, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja nuk ka paraqitur ndonjë argument që nuk është shqyrtuar më parë dhe që do të kërkonte rishqyrtimin e çështjeve të lartpërmendura.³⁹⁷ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk

³⁹¹ ICTY, *Prosecutor v. Ojdanić et al.*, IT-99-37-AR72, Appeals Chamber, [Decision on Dragoljub Ojdanić's Motion Challenging Jurisdiction – Joint Criminal Enterprise](#) (“Ojdanić Appeals Chamber Decision”), 21 May 2003, para. 30; *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Krnojelac Appeal Judgement”), 17 September 2003, para. 29; *Prosecutor v. Vasiljević*, IT-98-32-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Vasiljević Appeal Judgement”), 25 February 2004, para. 95; *Prosecutor v. Babić*, IT-03-72-S, Trial Chamber I, [Sentencing Judgement](#), 29 June 2004, para. 32-33; [Stakić Appeal Judgement](#), para. 62, 64; *Prosecutor v. Martić*, IT-95-11-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Martić Appeal Judgement”), 8 October 2008, para. 80-81; *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 17 March 2009, para. 657-659; [Dorđević Appeal Judgement](#), para. 40-45; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Popović et al. Appeal Judgement”), 30 January 2015, para. 1672-1674; *Prosecutor v. Tolimir*, IT-05-88/2-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Tolimir Appeal Judgement”), 8 April 2015, para. 281-282.

³⁹² ICTR, *Prosecutor v. Ntakirutimana and Ntakirutimana*, ICTR-96-10-A dhe ICTR-96-17-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Ntakirutimana Appeal Judgement”), 13 December 2004, para. 463-465; *Prosecutor v. Ngirabatware*, ICTR-99-54-T, Trial Chamber II, [Judgement and Sentence](#) (“Ngirabatware Trial Judgement”), 20 December 2012, para. 1299; *Prosecutor v. Karemera and Ngirumpatse*, ICTR-98-44-A, Appeals Chamber, [Decision on Jurisdictional Appeals: Joint Criminal Enterprise](#) (“Karemera and Ngirumpatse Appeals Chamber Decision”), 12 April 2006, para. 15-16; *Prosecutor v. Karemera and Ngirumpatse*, ICTR-98-44-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Karemera and Ngirumpatse Appeal Judgement”) 29 September 2014, para. 110.

³⁹³ SCSL, *Prosecutor v. Brima et al.*, SCSL-04-16-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (“Brima et al. Trial Judgement”), 20 June 2007, para. 61; *Prosecutor v. Fofana and Kondewa*, SCSL-04-14-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (“Fofana and Kondewa Trial Judgement”), 2 August 2007, para. 209-210; *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Sesay et al. Appeal Judgement”), 26 October 2009, para. 398-400; *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-01-T, Trial Chamber II, [Judgement](#), 18 May 2012, para. 457-458.

³⁹⁴ STL, STL-11-01/I, Appeals Chamber, [Interlocutory Decision on Applicable Law: Terrorism, Conspiracy, Homicide, Perpetration, Cumulative Charging](#) (“2011 Appeals Chamber Decision”) 16 February 2011, para. 256. Dhoma e Apelit e TSL-së renditi raste të tjera në mbështetje të NKP I (poshtëshënimi 355).

³⁹⁵ ECCC, *Prosecutor v. Ieng et al.*, 002/19-09-2007-ECCC/OCIJ, Pre-Trial Chamber, [Decision on Appeals against the Co-Investigating Judges' Order on Joint Criminal Enterprise](#) (“Case 002 Pre-Trial Decision”), 20 May 2010, para. 69; [Duch Trial Judgement](#), para. 504-510; *Prosecutor v. Nuon and Khieu*, 002/19-09-2007/ECCC/TC, Trial Chamber, [Judgement](#), 7 August 2014, para. 691; [Case 002 Appeal Judgement](#), para. 773-789.

³⁹⁶ IRMCT, *Prosecutor v. Karadžić*, MICT-13-55-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Karadžić Appeal Judgement”), 20 March 2019, para. 435.

³⁹⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizon se argumente të ngjashme me ato të parashtruara nga Mbrojtja në lidhje me NKP I janë shqyrtuar me hollësi nga DHJGJK-ja, [Case 002 Appeal Judgement](#), para. 775-789.

gjen asnjë arsye për të vënë në diskutim vlefshmërinë e interpretimit të dhënë dhe të përfundimeve të nxjerra nga juridiksionet ndërkombëtare të lartpërmendura lidhur me karakterin zakonor të NKP I. Përkundrazi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se precedentët e renditur nga këto juridiksione ofrojnë një bazë të qartë dhe të mjaftueshme për të ardhur në përfundimin se NKP I ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara dhe mbetet e tillë edhe sot.

186. Lidhur me NKP III, Dhoma e Apelit e TPNJ-së u mbështet në çështjet *Erich Heyer and six others* ("Essen Lynching"), *Kurt Goebell et al.* ("Borkum Island"), si edhe në çështjen *D'Ottavio et al.*, dhe në çështje të tjera gjyqësore italiane duke ardhur në përfundimin se kjo ishte përcaktuar qartë në të drejtën zakonore ndërkombëtare.³⁹⁸ Këto përfundime janë konfirmuar vazhdimisht nga TPNJ-ja,³⁹⁹ TPNR-ja,⁴⁰⁰ GJSSL-ja,⁴⁰¹ TSL-ja⁴⁰² dhe MPNTP-ja.⁴⁰³ DHJGJK-ja devijoi nga këto përfundime; pas shqyrtimit të disa çështjeve, përfshirë ato mbi të cilat mbështetet ZPS-ja (pra, *Essen Lynching*, *Borkum Island*, *Hartgen et al.* (*Rüsselsheim Case*), *Ishiyama et al.*, *D'Ottavio et al.*, *Ikeda* dhe *Tashiro et al.*),⁴⁰⁴ Dhoma e Gjykatës Supreme të DHJGJK-së konstatoi se nuk kishte prova të

³⁹⁸ [Tadić Appeal Judgement](#), para. 207-219, që i referohet, ndër të tjera: [Trial of Erich Heyer et al.](#) ("Essen Lynching"), British Military Court for the Trial of War Criminals, Essen, 18-19 dhe 21-22 December 1945, tek UNWCC Law Reports, Volume I; [US v. Kurt Goebell et al.](#) ("Borkum Island"), Lënda nr. 12-489, Review and Recommendations, 1 August 1947; [D'Ottavio et al.](#), Italian Court of Cassation, Criminal Section I, Judgement no. 270 of 12 March 1947, *Journal of International Criminal Justice* 5 (2007). Në paragrafin 219 Dhoma e Apelit konstaton se e njëjta qasje është ndjekur në çështje të tjera gjyqësore italiane.

³⁹⁹ ICTY, [Ojdanić Appeals Chamber Decision](#), para. 30; [Krnojelac Appeal Judgement](#), para. 29-32; [Vasiljević Appeal Judgement](#), para. 95, 99; [Stakić Appeal Judgement](#), para. 100-103; [Martić Appeal Judgement](#), para. 80-81; [Đorđević Appeal Judgement](#), para. 48-53; [Popović et al. Appeal Judgement](#), para. 1672-1674; [Tolimir Appeal Judgement](#), para. 281-282.

⁴⁰⁰ ICTR, [Ntakirutimana Appeal Judgement](#), para. 463-465; [Ngirabatware Trial Judgement](#), para. 1299; [Karemera and Ngirumpatse Appeals Chamber Decision](#), para. 15-16; [Karemera and Ngirumpatse Appeal Judgement](#), para. 110.

⁴⁰¹ SCSL, [Brima et al. Trial Judgement](#), para. 61; [Fofana and Kondewa Trial Judgement](#), para. 209-210; [Sesay et al. Appeal Judgement](#), para. 398-400; [Taylor Trial Judgement](#), para. 458, 466.

⁴⁰² STL, [2011 Appeals Chamber Decision](#), para. 256. Dhoma e Apelit e TSL-së përmendet në një poshtëshënim për çështje të tjera në mbështetje të NKP III (poshtëshënimi 355).

⁴⁰³ IRMCT, [Karadžić Appeal Judgement](#), para. 435-437.

⁴⁰⁴ [US v. Hartgen et al.](#) ("Rüsselsheim"), Case No. 12-1497, United States Military Commission, Review and Recommendation, 29 September 1945; [Prosecutor v. Ishiyama et al.](#) ("Ishiyama et al."), Australian

mjaftueshme se NKP III ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare.⁴⁰⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se DHJGJK-ja i hodhi poshtë (dhe Mbrojtja e kundërshton) këto çështje në bazë të faktit se nuk ishte shqiptuar ndonjë dënim në bazë të përgjegjësisë penale të ngjashme me NKP III,⁴⁰⁶ se arsyetimi ligjor mungonte apo ishte jobindës,⁴⁰⁷ se shqyrtimi i mëvonshëm ligjor nuk kishte rëndësi,⁴⁰⁸ ose se këto çështje ishin gjykuar sipas juridiksionit vendor.⁴⁰⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se këto kundërshtime nuk janë bindëse për arsyet e mëposhtme. Praktika shtetërore nuk është gjithmonë tërësisht përputhëse, e as treguesit e *opinio juris* nuk janë gjithmonë të padiskutueshëm. Mund të ketë dhe shpesh ka mosmarrëveshje të arsyeshme për ekzistencën e një rregulle të së drejtës zakonore ndërkombëtare apo për përmbajtjen e saj. Mosmarrëveshje të tilla mund të burojnë ndër të tjera nga mospërputhje terminologjike⁴¹⁰ ose nga shpeshtësia dhe lloji i praktikës përkatëse.⁴¹¹ Megjithatë, me rëndësi për identifikimin e një rregulle zakonore është zbulimi i elementeve të përbashkëta të praktikës të cilat tregojnë se një rregull e tillë është

Military Court, 8-9 April 1946; *Queen v. Ikeda* ("Ikeda"), Case No. 72A/1947, Temporary Court Martial, Batavia, Germany, Judgement, 8 September 1948; *US v. Tashiro et al.* ("Tashiro et al."), US Military Commission, Review of the Staff Judge Advocate, 7 January 1949;

⁴⁰⁵ ECCC, [Case 002 Appeal Judgement](#), para. 791-807.

⁴⁰⁶ ECCC, [Case 002 Appeal Judgement](#), para. 795 (*D'Ottavio et al.*), 804 (*Ishiyama et al.*); Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 30-32 (*Ishiyama et al.*).

⁴⁰⁷ ECCC, [Case 002 Appeal Judgement](#), para. 791 (*Essen Lynching, Borkum Island*), 793 (*Ikeda*), 800 (*Rüsselsheim*), 801 (*Tashiro et al.*); Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 58-64 (*Essen Lynching*), 66 (*Rüsselsheim, Tashiro et al.*); Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 30-31 (*Essen Lynching*), 32-33 (*Borkum Island*), 34 (*Ikeda*); Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 18-19 (*Rüsselsheim*), 25-29 (*Ikeda*), 33-34 (*Essen Lynching*), 39-40 (*Tashiro et al.*); Kundërpërgjigjja e Thaçit lidhur me NKP-në, para. 18 (*Essen Lynching*), 19 (*Ikeda, Tashiro et al.*), 20-22 (*Ishiyama et al.*); Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 37, f. 16-17 (*Essen Lynching, Ishiyama et al., Ikeda, Tashiro et al.*)

⁴⁰⁸ Mocioni i Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP), para. 58-64 (*Borkum Island*); Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 34 (*Rüsselsheim*); Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 17 (*Rüsselsheim*), 21 (*Borkum Island*); Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 37, f. 16 (*Rüsselsheim*),

⁴⁰⁹ Mocioni i Krasniqit lidhur me Juridiksionin, para. 36-37 (*D'Ottavio et al.*); Kundërpërgjigjja e Krasniqit lidhur me NKP-në, para. 19 (*Rüsselsheim*), 36 (*D'Ottavio et al.*); Kundërpërgjigjja e Veselit lidhur me NKP-në, para. 37, f. 16 (*D'Ottavio et al.*)

⁴¹⁰ *Po ashtu* ICTR, [Rwamakuba Appeals Chamber Decision](#), para. 24; ECCC, [Case 002 Appeal Judgement](#), para. 775-776.

⁴¹¹ *Po ashtu*, ECCC, *Prosecutor v. Kaing Guek Eav ("Duch")*, 001/18-07-2007-ECCC/SC, Supreme Court Chamber, [Appeals Judgement](#), 3 February 2012, para 93.

zbatuar me idenë e një të drejte ligjore. Në rastin konkret, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se të gjithë tribunalët ndërkombëtarë me përjashtim të njërit e kanë interpretuar praktikën shtetërore dhe *opinio juris* njëlloj, domethënë, duke pranuar se NKP III bën pjesë në të drejtën zakonore ndërkombëtare. Vetëm një juridiksion ka miratuar një interpretim të ndryshëm. Pasi ka shqyrtuar përkatësisht qëndrimin e mbajtur nga DHJGJK-ja dhe argumentet e Mbrojtjes që lidhen me të, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gjen arsye bindëse për të vënë në diskutim vlefshmërinë e interpretimit të dhënë dhe të përfundimeve të nxjerra nga juridiksionet ndërkombëtare të lartpërmendura lidhur me karakterin zakonor të NKP III. Përkundrazi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se precedentët e renditur nga këto juridiksione ofrojnë një bazë të qartë dhe të mjaftueshme për të ardhur në përfundimin se NKP III ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara dhe vazhdon të mbetet e tillë edhe sot.

187. Për sa i përket argumentit të Mbrojtjes se kundërthënia aktuale midis NKP-së dhe bashkëkryerjes së paraqitur në Statutin e GJPN-së tregon se NKP-ja nuk mund të kishte marrë karakter zakonor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën konstatimet e mëposhtme. Statuti i GJPN-së është traktat; shtetet palë nuk kërkuan të kodifikonin të drejtën zakonore ndërkombëtare lidhur me, ndër të tjera, format e përgjegjësisë penale; përkundrazi, ata vendosën se cila prej tyre duhej përfshirë në juridiksionin e GJPNJ-së. Kjo pasqyrohet në nenin 21 të Statutit të GJPN-së, ku parashtrohet se burimi parësor i ligjit të zbatueshëm është Statuti, Elementet e Krimeve dhe Rregullorja e Procedurës dhe Provave, ndërsa “parimet apo rregullat e të drejtës ndërkombëtare” përbëjnë një burim dytësor të zbatueshëm vetëm kur materiali ligjor nuk arrin të japë një zgjidhje ligjore.⁴¹² Si rrjedhojë, përfshirja e njëres formë përgjegjësie penale apo një tjetre në Statutin e GJPN-së mund të jetë me rëndësi, por jo përcaktues, lidhur me

⁴¹² *Shih gjithashtu, ICC, Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Confirmation of Charges](#) (“Katanga and Ngudjolo Chui Confirmation Decision”), ICC-01/04-01/07-717, 30 September 2008, para. 508.*

karakterin zakonor të atij nocioni.⁴¹³ Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se përfshirja e bashkëkryerjes në Statutin e GJPN-së nuk ka lidhje me çështjen nëse NKP-ja është formë përgjegjësie penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të pathemeltë argumentin e Mbrojtjes.

188. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes se deklaratat e (ish) gjykatësve të tribunalëve ndërkombëtarë, literatura akademike dhe jurisprudenca shtetërore e kohëve të fundit hedhin dyshime serioze mbi karakterin zakonor të NKP III, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, bazuar në konstatimet e mësipërme, gjykime të tilla nuk janë bindëse. Në veçanti, publikimet e (ish) gjykatësve dhe akademikëve që mbështetin zhvillime të ndryshme të Ligjit apo që paraqesin opinionet e tyre personale për tema të ndryshme nuk mund të hedhin poshtë jurisprudencën e dalë prej vendimeve të tribunalëve ndërkombëtarë.⁴¹⁴ Për më tepër, vendimi në çështjen *Jogee* nga Gjykata e Lartë e Britanisë së Madhe ka të bëjë me një vepër penale të juridiksionit vendor e përfshirë në akuzë sipas një përgjegjësie penale dytësore në bazë të së drejtës vendore.⁴¹⁵ Ai nuk përmban ndonjë element ndërkombëtar dhe nuk ka lidhje me përcaktimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare për krime ndërkombëtare. Gjithashtu, veçantia e tij nuk lejon të nxirret ndonjë përfundim lidhur me ekzistencën e praktikës shtetërore. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të pathemeltë argumentin e Mbrojtjes.

189. Për argumentin e Mbrojtjes se NKP III nuk mbështetet nga traktate ndërkombëtare dhe nuk përbën një parim të përgjithshëm të së drejtës, Gjykatësi i

⁴¹³ *Shih* ICC, *Prosecutor v Lubanga*, Pre-Trial Chamber I, Decision on the confirmation of charges, ICC-01/04-01/06-803-tEN, para. 333-338; [Katanga and Ngudjolo Chui Confirmation Decision](#), para. 508; *Prosecutor v Katanga*, Trial Chamber II, [Judgement](#) (“Katanga Trial [Judgement](#)”), ICC-01/04-01/07-3436-tENG, 7 March 2014, para. 1395.

⁴¹⁴ ICTY, [Dorđević Appeal Judgement](#), para. 33; [ILC Draft Conclusions](#), commentary (3) to conclusion 14.

⁴¹⁵ *Po ashtu*, MPNTP/IRMCT, [Karadžić Appeal Judgement](#), para. 434-437, që i referohet *R v. Jogee* [2016] UKSC 8.

Procedurës Paraprake mendon se, bazuar në konstatimet e mësipërme lidhur me karakterin zakonor të NKP III, faktorë të tillë nuk kanë nevojë të trajtohen më tej.

190. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, gjatë juridiksionit kohor të DHS-së, NKP I dhe NKP III ishin pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe vazhdojnë të mbeten të tilla edhe sot.

(c) Parashikueshmëria dhe disponueshmëria e NKP-së

191. Mbrojtja pretendon se në interpretimin e parashikueshmërisë, nuk duhet të ketë fleksibilitet në terminologji, siç sugjeron ZPS-ja. Mbrojtja pretendon më tej se përgjegjësia lidhur me NKP-në nuk ishte e parashikueshme për të akuzuarit në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara, sepse (i) aktgjykimi i apelit në çështjen *Tadiq* u lëshua në korrik të 1999 dhe jurisprudenca e mëvonshme ishte jopërputhëse lidhur me nocionin e NKP-së; dhe (ii) koncepti i NKP-së nuk ishte i njohur në legjislacionin e Kosovës duke qenë se as neni 22 dhe as neni 26 i Kodit Penal të RSFJ-së nuk e pasqyronin këtë koncept, sidomos në formën e tij të zgjeruar.

192. Para së gjithash, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të trajtojë argumentin e ZPS-së se pesha e veprave penale mund të rrëzojë pretendimin mbi mungesën e dijenisë për karakterin e tyre kriminal. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se faktikisht, mizoria e një krimi të përfshirë në akuza mund të luajë një rol në përcaktimin nëse i akuzuar kishte dijeni për natyrën kriminale të sjelljes së vet.⁴¹⁶ Megjithatë, një faktor i tillë nuk mund të zbatohet për të përcaktuar nëse i akuzuari kishte dijeni se njëra apo tjetra formë përgjegjësie penale nëpërmjet së cilës pretendohet se është kryer një krim luftime, mund të rezultonte në përgjegjësi penale. Një interpretim kaq i gjerë do ta bënte çdo formë përgjegjësie penale automatikisht të parashikueshme dhe të disponueshme thjesht për faktin se krimi që pretendohet se është kryer përmes saj ishte mizor apo i tmerrshëm. Rrjedhimisht, Gjykatësi i

⁴¹⁶ ICTY, [Ojdanić Appeals Chamber Decision](#), para. 42.

Procedurës Paraprake e gjykon të pathemeltë argumentin e ZPS-së lidhur me NKP-në.

193. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes se në interpretimin e parashikueshmërisë, nuk duhet të ketë fleksibilitet në terminologji, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se parimi i ligjshmërisë, i mishëruar në nenin 7(1) të KEDNJ-së, nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 12 të Ligjit, përfshin, ndër të tjera, kushtin që një krim të jetë i përkufizuar qartë në Ligj.⁴¹⁷ Ky kusht përmbushet kur një individ mund ta dijë nga formulimi i një dispozite përkatëse dhe, nëse është nevoja, me ndihmën e interpretimit të gjykatave dhe me këshilla juridike profesionale, se cilat veprime dhe mosveprime e bëjnë atë përgjegjës penalisht.⁴¹⁸ Koncepti i “ligjit” në këtë drejtim përfshin të drejtën e brendshme ose ndërkombëtare, të drejtën e kodifikuar (si ligj apo jurisprudencë) apo të pakodifikuar.⁴¹⁹ E drejta zakonore mund të përfaqësohet në të drejtën e pakodifikuar dhe në jurisprudencë.⁴²⁰ Për më tepër, fushëveprimi i konceptit të parashikueshmërisë varet në një masë të madhe nga përmbajtja e instrumentit në diskutim, fusha që synon të mbulojë dhe numri dhe statusi i atyre që u drejtohet.⁴²¹ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, për çështjen aktuale, përgjegjësia penale lidhur me NKP-në, në formën e saj bazë dhe të zgjeruar, ishte e parashikueshme për të akuzuarit nëse, në kohën e krimeve të pretenduara, ata mund të merrnin njohuri me ndihmën e interpretimit të gjykatave dhe me këshilla juridike profesionale se e drejta zakonore ndërkombëtare ose legjislacioni i Kosovës e bënin pjesëmarrjen e tyre të qëllimshme në një plan apo ndërmarrje kriminale të përbashkët penalisht të dënueshme, jo vetëm lidhur me krimet që janë pjesë e një plani të tillë, por

⁴¹⁷ ECtHR, *S.W. v. the United Kingdom* (“S.W. v. the United Kingdom”), nr. 20166/92, [Judgement](#), 22 November 1995, para. 35; ECtHR, *Cantoni v. France* (“Cantoni v. France”), nr. 17862/91, [Judgement](#), 11 November 1996, para. 29

⁴¹⁸ ECtHR, [S.W. v. the United Kingdom](#), para. 35; [Cantoni v. France](#), para. 29; [Vasiliasukas v. Lithuania \[GC\]](#), para. 154.

⁴¹⁹ [Vasiliasukas v. Lithuania \[GC\]](#), para. 154; [S.W. v. the United Kingdom](#), para. 35; [Cantoni v. France](#), para. 29.

⁴²⁰ [Ojdanić Appeals Chamber Decision](#), para. 41.

⁴²¹ ECtHR, [Kononov v. Latvia \[GC\]](#), para. 235; [Ojdanić Appeals Chamber Decision](#), para. 39.

edhe për krimet që ishin pasoja të parashikueshme të tij. Thënë thjesht, të akuzuarit duhet të kenë qenë në gjendje të vlerësonin se sjellja e tyre ishte kriminale në kuptimin e ditur përgjithësisht, pa iu referuar asnjë dispozite konkrete.⁴²² Si pasojë, nuk ekziston ndonjë kusht që për vërtetimin e parashikueshmërisë së përgjegjesisë penale lidhur me NKP-në, duhen identifikuar dispozitat me terminologji të njëjtë. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se argumenti i Mbrojtjes është i pathemeltë.

194. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes se aktgjykimi i apelit në çështjen *Tadiq* u lëshua vetëm në korrik të 1999 dhe jurisprudenca e mëvonshme lidhur me nocionin e NKP-së nuk është përputhëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme se NKP-ja, si në formën e saj bazë dhe të zgjeruar, ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit të DHS-së.⁴²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se aktgjykimi i parë i TPNJ-së që mori parasysh përgjegjësinë penale për pjesëmarrje në NKP ishte ai i dhjetorit 1998 në aktgjykimin e çështjes *Furundžija*.⁴²⁴ Gjithsesi, mbi bazën e konstatimeve të mësipërme në lidhje me postet e larta të të akuzuarve në UÇK dhe, duke marrë parasysh ndër të tjera, kuadrin ligjor të përgjithshëm pas Luftës së Dytë Botërore dhe ndjekjet penale të atëhershme prej TPNJ-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se ishte e parashikueshme për të akuzuarit që pjesëmarrja në një plan të përbashkët mund të shkaktojë përgjegjësi penale individuale.⁴²⁵

195. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes se koncepti i NKP-së nuk njihet në të drejtën e Kosovës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se e drejta zakonore nuk është e kodifikuar; si rrjedhojë nuk duhet pritur që të gjendet e kristalizuar në një veprim të

⁴²² ICTY, *Prosecutor v. Hadžihasanović et al.*, IT-01-47-AR72, Appeals Chamber, *Decision on Interlocutory Appeal Challenging Jurisdiction in Relation to Command Responsibility*, 16 July 2003, para. 34; ECCC, [Duch Trial Judgement](#), para. 31.

⁴²³ *Shih*, para. 190 më lart.

⁴²⁴ ICTY, [Furundžija Trial Judgement](#), para. 216, 249, 250-257.

⁴²⁵ *Shih*, para. 103-104 above. *Shih gjithashtu*, [Ojdanić Appeals Chamber Decision](#), para. 41.

ndaluar me ligj. Megjithatë, është fakt se sistemet ligjore shtetërore dhe ndërkombëtare ndonjëherë përfshijnë veprime të ndaluara me ligj që efektivisht pasqyrojnë në mënyrë efikase veprimin bazë të ndaluar prej të drejtës zakonore. Nëse ekzistojnë, dispozita të tillë të ngjashme janë me rëndësi për vlerësimin nëse veprimi i ndaluar në fjalë ka qenë vërtet i parashikueshëm dhe i mundshëm për t'u ditur.⁴²⁶ Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, gjatë juridiksionit kohor të DHS-së, përgjegjësia penale në Kosovë mbulohej nga nenet 11-32 të Kodit Penal të RSFJ-së. Ndër këto dispozita, nenet 22 dhe 26 që të dy pasqyrojnë konceptin e përgjegjësisë penale të përbashkët.

196. Në veçanti, megjithëse është vendosur nën titullin "Bashkëkryerja", neni 22 i Kodit Penal të RSFJ-së parashikon se

nëse disa persona së bashku kryejnë një vepër penale përmes pjesëmarrjes në kryerje ose në ndonjë formë tjetër, secili prej tyre dënohet sikurse parashikohet për atë vepër.⁴²⁷

197. Kjo dispozitë përcakton qartazi përgjegjësinë penale të një individi në rastin e pjesëmarrjes apo kontributit të tij në një veprim kriminal të përbashkët. Gjykatat e Kosovës, përfshirë Gjykatën Supreme kanë konstatuar se neni 22 i Kodit Penal të RSFJ-së pasqyron elementët e NKP I (nuk është e domosdoshme që para kryerjes së krimeve të ekzistojë një plan apo marrëveshjeje e përbashkët, apo që personi të ketë dhënë kontribut fizik në qoftë se merr pjesë apo kontribuon në njëfarë mënyre në kryerjen e tyre to dhe ka të njëjtin synim të përbashkët).⁴²⁸

⁴²⁶ *Po ashtu* ECCC, [Case 002 Pre-Trial Decision](#), para. 45.

⁴²⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se një dispozitë me formulim të ngjashëm mban titullin "Bashkëkryerja" në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, UNMIK/REG/2003/25, 6 korrik 2003 (Neni 23), Kodi nr. 04/L-082, 20 prill 2012 (Neni 31) dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, 23 nëntor 2018 (Neni 31).

⁴²⁸ Gjykata Themelore e Mitrovicës, [Aktvendim](#), 12 shtator 2013, Nr. 14/2013, f. 37; Gjykata e Apelit e Kosovës, [Aktvendim](#), 11 shtator 2013, PAKR 966/2012, para. 74; Gjykata e Apelit e Kosovës, [Aktvendim](#), 30 janar 2014, PAKR 271/2013, para. 36-39; Gjykata Supreme e Kosovës, [Aktvendim](#), 7 gusht 2014, PAII 3/2014, para. xli-xlii.

198. Një dispozitë tjetër që ka ngjashmëri me NKP I është neni 26 i Kodit Penal të RSFJ-së, i cili parashikon se,

Kushdo që krijon apo përdor një organizatë, bandë, grupazh, grup apo çdo shoqatë tjetër me qëllim kryerjen e veprimeve kriminale është penalisht përgjegjës për të gjitha veprimet kriminale që burojnë nga qëllimi kriminal i këtyre shoqatave dhe dënohet sikur ai vetë t'i ketë kryer ato, pavarësisht nëse ai vetë ka marrë pjesë dhe nga mënyra se si ka marrë pjesë në kryerjen e çdo veprimi të tillë.

199. Kjo dispozitë pasqyron NKP I duke qenë se përcakton përgjegjësi penale për personat që marrin pjesë në një organizatë apo shoqatë e cila synon të kryejë veprime kriminale. Gjykata Supreme e Kosovës dhe TPNJ-ja kanë arritur në përfundimin se neni 26 i Kodit Penal të RSFJ-së pasqyron NKP I.⁴²⁹

200. Gjithashtu, një lexim i kombinuar i neneve 11 dhe 13 të Kodit Penal të RSFJ-së tregon se përgjegjësia penale parashikohej jo vetëm për një person që “është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe dëshiron kryerjen e saj”, por edhe për një individ i cili “është i vetëdijshëm se nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të lindë një pasojë e ndaluar dhe pranon kryerjen e saj”. Së bashku me nenin 22 ose 26 të Kodit Penal të RSFJ-së, këto dispozita pasqyrojnë elementet e NKP III: pjesëmarrje në një plan të përbashkët me synim dhe përgjegjësi të përbashkët jo vetëm për krimet e synuara, por edhe për pasojat e parashikueshme. Një interpretim i tillë është konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.⁴³⁰ Fakti që disa gjykata të Kosovës kanë pasur një mendim të ndryshëm për këtë aspekt nuk rezulton në përfundimin se forma e përgjegjësisë penale që pasqyron NKP III nuk parashikohej në legjislacionin e Kosovës.⁴³¹

⁴²⁹ Gjykata Supreme e Kosovës, [Aktvendim](#), 10 prill 2009, Af.-Kz No 371/2008, f. 14-16, 63-64; ICTY, [Ojdanić Appeals Chamber Decision](#), para. 40.

⁴³⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, [Aktvendim](#), 29 maj 2012, Ap-Kz 67/2011, f. 7-9.

⁴³¹ Gjykata Themelore e Mitrovicës, [Aktvendim](#), 8 gusht 2016, P184/15, para. 86-88; Gjykata e Apelit e Kosovës, [Aktvendim](#), 15 shtator 2016, PAKR 455/2015, f. 45; të dyja përmenden në Kundërpërgjigjen e Selimit lidhur me NKP-në, para. 34-35.

201. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se si NKP I edhe NKP III ishin të parashikueshme dhe të disponueshme për të akuzuarit në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara.

(d) Kundërshtime lidhur me zbatimin e NKP-së

202. Mbrojtja ngre një numër kundërshtimesh të tjera lidhur me zbatimin e NKP-së. Në veçanti, Mbrojtja pretendon se: (i) në përputhje me parimin *in dubio pro reo*, neni 16(1)(a) i Ligjit duhet interpretuar në favor të të akuzuarve dhe nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të tyre duke përfshirë përgjegjësinë penale për NKP-në; (ii) në përputhje me parimin *lex mitior*, edhe nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se NKP III ekzistonte në të drejtën zakonore ndërkombëtare gjatë periudhës së mbuluar nga Aktakuza, ai duhet të marrë parasysh evoluimin e ligjit që prodhon një rezultat thelbësisht më të favorshëm për të akuzuarit; (iii) NKP III është një formë përgjegjësie penale që rrezikon parimin e fajësisë duke përdorur një formë përgjegjësie apo fajësie penale kolektive për shkak të anëtarësisë; dhe (iv) NKP III nuk lidhet me krime me synim konkret.

203. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në kuptimin e ngushtë të fjalës, asnjë nga këto kundërshtime nuk është krejtësisht me karakter juridiksional. Gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'i trajtojë këto kundërshtime vetëm nëse dhe për aq sa ato kanë të bëjnë me zbatimin e NKP-së në DHS.

204. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes në lidhje me parimin *in dubio pro reo*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, duke supozuar se ky parim është i zbatueshëm në këtë moment, duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme se neni 16(1)(a) i Ligjit e përfshin përkufizimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare të "kryerjes" dhe se NKP-ja ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara, nuk mbetet ndonjë dyshim i arsyeshëm që të përlligjë zbatimin e këtij

parimi.⁴³² Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron argumentin e Mbrojtjes të pathemeltë.

205. Për sa i përket argumentit të Mbrojtjes lidhur me parimin *lex mitior*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme në shtjellimin e zbatimit të këtij parimi.⁴³³ Gjithashtu pasi ka konstatuar se NKP III ka qenë dhe mbetet pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare,⁴³⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim i të drejtës së zbatueshme që të përlligjë një vlerësim sipas këtij parimi. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron argumentin e Mbrojtjes të pathemeltë.

206. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes lidhur me parimin e fajësisë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se NKP III mbështetet në disa kushte.⁴³⁵ Së pari, personi duhet të marrë pjesë dhe të kontribuojë në mënyrë të qëllimshme në qëllimin e përbashkët. Një pjesëmarrje e tillë duhet të përbëjë një kontribut të qenësishëm nga ai person në realizimin e qëllimit të përbashkët. Së dyti, duhet të ketë qenë e parashikueshme për atë person se në realizimin e qëllimit të përbashkët mund të kryhet një krim jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët. Së treti, personi duhet të ketë marrë parasysh me vullnet të lirë rrezikun që duke marrë pjesë në qëllimin e përbashkët, mund të ndodhë një krim jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët. Vetëm anëtarësia në një NKP nuk mund të çojë në përgjegjësi penale sipas asnjërës nga tri format e NKP-së, kështu që asnjëra prej tyre nuk mund të përdoret për fajësi penale për shkak të anëtarësisë.⁴³⁶ Në përgjegjësi penale çojnë pjesëmarrja apo kontributi individual i personit, së bashku me kushte të tjera dhe vërtetuar prej provave përkatëse. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron argumentin e Mbrojtjes të pathemeltë.

⁴³² [Ojdanić Appeals Chamber Decision](#), para. 28.

⁴³³ *Shih*, para. 105-106 më lart.

⁴³⁴ *Shih*, para. 186, 190 më lart.

⁴³⁵ Vendimi i Konfirmimit, para. 106-110, 114-115.

⁴³⁶ *Po ashtu* STL, [2011 Appeals Chamber Decision](#), para. 245.

207. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes në lidhje me zbatimin e NKP III për krime me synim konkret, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fillimisht konstaton se jurisprudenca për këtë është kundërthënëse. TPNJ-ja zakonisht ka dhënë dënime për shkak të NKP III për krime me synim konkret, të tillë si gjenocidi dhe përndjekja.⁴³⁷ Dhoma e Apelit e TSL-së dhe Dhoma Gjyqësore në çështjen *Charles Taylor* e GJSSL-së ndoqën një qasje të ndryshme dhe i ndaluan dënimet sipas NKP III për krime me synim të konkret të tillë si terrorizmi.⁴³⁸ Jurisprudenca e mëvonshme e TPNJ-së nuk devijoi nga precedenti i vet.⁴³⁹

208. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kur kërkohet synim konkret për realizimin e disa krimeve, kryesi duhet të përmbushë jo vetëm elementet subjektive të krimeve të lidhura, sipas rastit, me njërin prej elementeve materiale, por edhe një element mendor shtesë (*dolus specialis*),⁴⁴⁰ i cili kërkon që i akuzuari synonte të arrinte qëllimin konkret në fjalë.⁴⁴¹ Nga ana tjetër, për përgjegjësi penale sipas NKP III, nuk është e domosdoshme që një i akuzuar të ketë synim të njëjtë me personin që kryen krimin jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët; ai duhet vetëm të parashikojë se gjatë realizimit të qëllimit të përbashkët mund të kryhet krim jashtë kuadrit të këtij qëllimi e të marrë me vullnet të lirë rrezikun se një krim i tillë mund të ndodhë.⁴⁴² Rrjedhimisht, në lidhje me çështjen aktuale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se do të ishte anomali juridike të dënohej ndonjëri prej të akuzuarve si pjesëmarrës në një NKP (për shembull, që përfshin ndalimin arbitrar dhe trajtimin mizor) vetëm sepse ka parashikuar mundësinë që krimet në kuadër të qëllimit të përbashkët përfundimisht do të rezultonin në kryerjen e krimeve me synim konkret

⁴³⁷ *Shih*, ICTY, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, Appeals Chamber, [Decision on Interlocutory Appeal](#), 19 Mars 2004, para. 5-10; [Stakić Appeal Judgement](#), para. 38.

⁴³⁸ *Shih*, STL/TSL, [2011 Appeals Chamber Decision](#), para. 248-249; SCSL, [Taylor Trial Judgement](#), para. 468.

⁴³⁹ *Shih*, ICTY, [Dorđević Appeal Judgement](#), para. 81; *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 30 June 2016, para. 597; [Karadžić Appeal Judgement](#), para. 422-437.

⁴⁴⁰ ICC, [Katanga Trial Judgement](#), para. 772.

⁴⁴¹ *Gjithashtu*, STL, [2011 Appeals Chamber Decision](#), para 248.

⁴⁴² Vendimi i Konfirmimit, para. 114.

të përndjekjes apo torturës.⁴⁴³ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se argumenti i Mbrojtjes është i bazuar dhe e urdhëron ZPS-në të ndryshojë Aktakuzën duke përjashtuar përgjegjësinë penale sipas NKP III për krimet me synim konkret.⁴⁴⁴

209. Duke u bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë argumentet e Mbrojtjes lidhur me parimet *in dubio pro reo*, *lex mitior* dhe të fajësisë. Më tej, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se argumenti i Mbrojtjes lidhur me zbatimin e NKP III për krimet me synim konkret është i bazuar dhe e urdhëron ZPS-në të ndryshojë Aktakuzën, sikurse parashtrohet në paragrafin 208.

2. Përgjegjësia eprore

210. Mbrojtja pretendon se (i) DHS-ja nuk ka juridiksion për përgjegjësi eprore sepse kjo formë përgjegjësie penale nuk njihet në legjislacionin e Kosovës në fuqi në kohën e krimeve të pretenduara; dhe (ii) edhe nëse do të konstatohet se e drejta zakonore ndërkombëtare ishte e zbatueshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë nëse e drejta ndërkombëtare apo vendore prodhon një rezultat shumë më të favorshëm për të akuzuarit dhe të zbatojë një standard më të butë. Mbrojtja parashton më tej se, si rrjedhojë e zhvillimeve ligjore dhe jurisprudencës së kohëve të fundit, nocioni i përgjegjësive eprore është zhvilluar drejt një koncepti që është më në përputhje me parimin e ligjshmërisë.⁴⁴⁵

211. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes se DHS-ja nuk ka juridiksion mbi përgjegjësinë eprore sepse kjo formë përgjegjësie nuk njihet në legjislacionin e Kosovës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se neni 16(1)(c) i Ligjit përcakton elementet e

⁴⁴³ STL, [2011 Appeals Chamber Decision](#), para 248: Dhoma e Apelit e TSL-së vendosi që kombinimi i synimit konkret me NKP III rezultoi në “një anomali të rëndë ligjore: Nëse do të zbatohet përgjegjësia penale për NKP III, një person do të mund të dënohet si (bashkë)kryes për një krim *dolus specialis* pa pasur kushtin e nevojshëm të *dolus specialis*”.

⁴⁴⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 69, 82, 102.

⁴⁴⁵ Mocioni i Veselit lidhur me Juridiksionin, para. 125-130.

përgjegjesisë eprore që duhen zbatuar për krimet sipas neneve 13-14 të Ligjit. Pasi më herët ka konstatuar se neni 16(1) i Ligjit duhet të interpretohet në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare të zbatueshme në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara dhe se dispozitat e të drejtës penale të Kosovës që rregullojnë format e përgjegjesisë nuk zbatohen në lidhje me atë dispozitë,⁴⁴⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk sheh ndonjë arsye për të trajtuar më tej argumentin e Mbrojtjes.

212. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë nëse e drejta ndërkombëtare apo vendore prodhon një rezultat materialisht shumë më të favorshëm për të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme që shtjellojnë zbatimin e parimit *lex mitior*.⁴⁴⁷ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se koncepti i përgjegjesisë eprore është njohur dhe zbatuar të paktën që në Luftën e Dytë Botërore,⁴⁴⁸ u kodifikua në Protokollin I Shtesë të Konventave të Gjenevës,⁴⁴⁹ është përdorur gjerësisht nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja dhe karakteri zakonor i saj praktikisht nuk është kundërshtuar.⁴⁵⁰ Bazuar në nenin 3(3) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të marrë parasysh këtë jurisprudencë përputhëse dhe të trajtojë aspektet e mësipërme vetëm për të përcaktuar nëse Mbrojtja ka paraqitur arsye bindëse që përligjin konstatime të ndryshme ligjore për çështjen në fjalë. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës

⁴⁴⁶ *Shih*, para. 177-178 më lart.

⁴⁴⁷ *Shih*, para. 105-106 më lart.

⁴⁴⁸ *Shih*, *In Re Yamashita*, US Supreme Court, 4 February 1946, 327 U.S. 1; *US v. Pohl et al.*, 3 November 1947, në CCL10 Military Tribunals, Volume V; *US v. Karl Brandt et al.*, tek CCL10 Military Tribunals, Volume II, 1950; *Hostages; US v. von Leeb et al.*, in CCL10 Military Tribunals, Volume XI, 1950; *US v. Araki et al.*, International Military Tribunal for the Far East, Judgment, 4 November 1948, in J. Pritchard and S. M. Zaide (red.), *The Tokyo War Crimes Trial*, 1981, Vol. 22.

⁴⁴⁹ *Shih*, Protocol Additional to the Geneva Conventions of 12 Gusht 1949, and Relating to the Protection of Victims of International Armed Conflicts/ (Additional Protocol I), 1125 UNTS 17512, 8 June 1977, nenet 86-87.

⁴⁵⁰ ICTY, *Aleksovski Trial Judgment*, para.70; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-T, Trial Chamber, *Judgment*, 3 mars 2000, para.290; *Delalić et al. Appeal Judgment*, para.195; *Prosecutor v. Hadžihasanović*, IT-01-47-PT, Trial Chamber, *Decision on Joint Challenge to Jurisdiction*, 12 Novemner 2002, para. 93(v), 167; ICTR, *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-T, Trial Chamber II, *Judgment*, 21 May 1999, para. 220, 492; *Prosecutor v. Musema*, ICTR-96-13-T, Trial Chamber I, *Judgment and Sentence*, 27 January 2000, para. 128-148. *Shih gjithashtu*, SCSL, *Prosecutor v. Brima et al.*, SCSL-2004-16-T, Trial Chamber II, *Judgment*, 20 June 2007, para. 782.

Paraprake vëren se përmendja nga Mbrojtja e Statutit dhe jurisprudencës së GJPN-së si tregues të fortë të një devijimi të mundshëm nga koncepti i përgjegjesisë eprore në të drejtën zakonore ndërkombëtare janë të papërshtatshme sepse asnjë prej tyre nuk është përcaktues i të drejtës zakonore ndërkombëtare.⁴⁵¹ Meqenëse Mbrojtja nuk ka paraqitur argumente të tjera që tregojnë një ndryshim të mundshëm në ligjin e zbatueshëm që do të përlligite një vlerësim sipas parimit *lex mitior*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk sheh ndonjë arsye për ta trajtuar më tej këtë argument.

213. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë argumentet e Mbrojtjes në lidhje me përgjegjësinë eprore.

V. VENDIM

214. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **RRËZON** Mocionin e Selimit lidhur me Juridiksionin (NKP);
- (b) **RRËZON** Mocionin e Thaçit lidhur me Juridiksionin, për sa i takon kundërshtimit të juridiksionit të DHS-së lidhur me NKP-në dhe akuzat kundër z. Thaçi me arsyetimin se këto akuza e tejkalojnë Raportin e Këshillit të Evropës;
- (c) **RRËZON** Mocionin e Krasniqit lidhur me Juridiksionin ;
- (d) **MIRATON** pjesërisht Mocionin e Veselit lidhur me Juridiksionin dhe **URDHËRON** ZPS-në të paraqesë një aktakuzë të ndryshuar ku të përjashtojë përgjegjësinë për NKP III për krimet me synim konkret; dhe
- (e) **RRËZON** pjesën tjetër të Mocionit të Veselit lidhur me Juridiksionin .

/nënshkrimi/

⁴⁵¹ *Shih*, para. 187 më lart.

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte 22 korrik 2021

Hagë, Holandë.